

KISHA E JEZU KRISHTIT E SHENJTORËVE TË DITËVE TË MËVONSHME • PRILL 2019

Liahona

**Mesazhi i Shpresës
dhe i Shpëtimit prej
Shpëtimtarit, faqe 18**

Kur Ndiheni të Harruar,
Kujtoni të Venë e Nainit,
faqe 12

Muzika e Pashkës: "Në një
Kopsht, Vend i Shenjti",
faqe 24

Si të Gjejmë Paqe dhe të
Shmangim Mashtrimin,
faqe 26



KISHA
ËSHTE
KËTU

Rejkjavik

Islandë





Me malin Esja të mbuluar me dëborë në sfond, Rejkjaviku, kryeqyteti plot ngjyra i Islandës, i jep mirëseardhjen një kombi në ishull, më shumë se 1 609 km larg nga kontinenti evropian. I themeluar fillimisht nga vikingët në vitin 874 ps.K., Rejkjaviku është zemra e veprimtarive kulturore, ekonomike dhe qeveritare të Islandës, si dhe një nga qytetet më të pastra, më të gjelbra dhe më të sigurta në botë.

Dy islandezët e parë u pagëzuan në Danimarkë në vitin 1851. Ata shpejt u kthyen në Islandë dhe në vitin 1853 u organizua dega e parë. Sot, në Islandë, ka pothuajse 300 anëtarë në tri degë, në Rejkjavik, Akurejri dhe Sellfoss. Tempulli më i afërt është në Londër, në Angli, 1 894 km nga Rejkjaviku.

Megjithëse numri i anëtarëve është i vogël, Kisha vazhdon të rritet. Pavarësisht nga sfidat e izolimit, përkthimit të materialeve të Kishës, motit të pafavorshëm dhe pengesave kulturore, udhëheqësit e Kishës kanë premtuar se një ditë Islanda do të jetë një fener për vendet e tjera. Presidenti Gordon B. Hinkli (1910–2008) e vizitoi Islandën dhe u kujtoi anëtarëve se ata janë “popull i forcës, fuqisë dhe aftësisë” për të bërë gjëra të mëdha” (“Wonderful to Have Sweet, Good Land”, *Church News*, 21 shtator 2002, f. 10).

- Misioni Islandez u organizua në vitin 1894, por predikimi u ndërpre në vitin 1914. Islanda u bë pjesë e Misionit të Kopenhagës në Danimarkë në vitin 1975.
- Në vitin 1977, Plaku Jozef B. Uirthlin (1917–2008), atëherë anëtar i Kuorumit të Parë të Të Shtatëdhjetëve, e përkushtoi zyrtarisht Islandën për predikimin e ungjillit.
- Në vitin 1981, Libri i Mormonit u botua në islandisht – një gjuhë që nuk flitet në asnjë vend tjetër të botës.



Në Kohë Shkurajimi,
Kujtoni të Venë e Nainit

Kith J. Uilson

12



Mirëbesoni në Shpëtimin
e Shpëtimtarit

Presidenti Henri B. Ajring

18



Ta Bësh të
Gëzueshme
Dhënien e
Shërbesës

8



Tri Mësime mbi
Dashurinë, Gëzimin
dhe Paqen

Brajën K. Ashton

26

Kur Jeni të Shkurajuar

Jeta ka pjesën e vet të uljeve dhe ngritjeve. Ndonjëherë kur jemi keq, pyetim veten se çfarë po bën Perëndia – pse një Atë i dashur po e lejon këtë të ndodhë? Kjo pasiguri mund të na bëjë që të pyetim: “A shqetësohet me të vërtetë Perëndia për mua personalisht?”








Në situata si kjo, unë kam gjetur që këto shkrime të shenjta janë të dobishme:


- **Psalmeve 8:4-5:** “Çfarë është njeriu, që ta mbash mend? . . . Megjithatë ti e bërë pak më të ulët se Perëndia, dhe e kurorëzove me lavdi dhe me nder.”
- **Gjoni 10:14:** Gjatë jetës së Tij këtu në tokë, Jezusi e përshkroi Vetën e Tij si “bariu i mirë” dhe shtoi: “I njoh delet e mia”.
- **Moisiu 1:39:** Ky është një nga vargjet e mia të parapëlqyera, ku Zoti i zbuloi qëllimin e Tij Profetit Jozef Smith: “Sepse, vër re, kjo është vepra ime dhe lavdia ime – të bëj të ndodhë pavdekësia dhe jeta e përjetshme e njeriut” – pra, duke nxjerrë në pah interesin e Tij për ne si individë.
- **Luka 7:11-16:** Jo vetëm që ky rrëfim na mëson për fuqinë e Shpëtimtarit mbi vdekjen – një kujtesë në kohë në këtë stinë Pashke – por për mua ai përfaqëson shembullin më të mirë të njohurisë së Tij të mprehtë për ne individualisht. Nga të gjitha mrekullitë e Jezusit, pak janë aq të ndjeshme dhe të dhembshura sa shërbesa e Tij ndaj të vesë së Nainit. Ashtu siç e tregoj në artikullin tim (shih faqja 12), ky rrëfim tregon interesin dhe dashurinë e Shpëtimtarit për secilin prej nesh.

Kith Uilson

Profesor i Asociuar, Universiteti “Brigam Jang”



- 5 Ai Është Ngritur!** 
"U mposht vdekja, jemi t' lir". Fitoren solli Krishti!"
- 6 Portrete Besimi:** Bobi dhe Lori Thërston – Misioni i Pnom-Penit në Kamboxha 
Misioni i tyre nuk ishte ashtu siç e kishin pritur, por gjithashtu i bekoj ata në mënyra të papritura.
- 8 Parimet e Dhënies së Shërbesës:** Ta Bësh të Gëzueshme Dhënien e Shërbesës
Një nga burimet më të mëdha të gëzimit të vërtetë gjendet te shërbimi.
- 12 Në Kohë Shkurajimi, Kujtoni të Venë e Nainit**
Nga Kith J. Uilson
Ashtu siç bëri për të venë e Nainit, Shpëtimtari do të vijë te ne në kohët tona më të vështira të nevojës.
- 18 Mirëbesoni në Shpëtimin e Shpëtimtarit**
Nga Presidenti Henri B. Ajring
Zoti do të na udhëheqë drejt shpëtimit nga sprovat tona ndërsa bëhemi më të drejtë.
- 24 Muzika:** Në një Kopsht, Vend i Shenjti 
Nga Tammy Simister Robinson
Shpëtimtari jetoi dhe vdiq për ne.
- 26 Tri Mësime mbi Dashurinë, Gëzimin dhe Paqen**
Nga Brajën K. Ashton
Ju mund të gjeni lumturi pavarësisht nga rrethanat tuaja.
- 32 Zëra të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme:** 
Një uragan që prish planet e martesës; çfarë është në të vërtetë jeta në vdekshmëri; një këngë që dha shpresë; një ftesë e pranuar.
- 36 Bekimet e Mbështetjes te Vetja:** Biznesi po Lulëzon 
Nga Xhoshua J. Perkei
Një avokat humbet punën, por gjen frymëzim në klasat e Kishës për mbështetjen te vetja.
- 38 Shtëpitë Tona, Familjet Tona:** Djali Ynë Është Bir i Atit Qiellor 
Nga Xherlin Mërfi
Pavarësisht se sa shumë i duam fëmijët tanë, Perëndia i do ata më tepër.
- 40 Dhënia Mësim Adoleshentëve dhe Fëmijëve Më të Vegjël:** 
Përballja me Tragjedinë
Këshilla për t'i ndihmuar fëmijët tuaj të ndiejnë paqe.

 Lexime të Shpejta



Në Kapak
Rruga për në Emaus,
nga Wendy Keller.

Seksione

Të Rinjtë në Moshë Madhore 42

Me gjithë zgjedhjet me të cilat përballlemi dhe **vendimet jetëndryshuese** që ne marrim, si mund ta dimë nëse jemi duke **ndjekur planin e Perëndisë** për ne? Lexojini artikujt e këtij muaji rreth **marrjes së zbulësës**.



Rinia 50

Mësoni se si ta përdorni bekimin tuaj patriarkal, jini të frymëzuar për të filluar **traditat e reja të Pashkës** dhe **gjeni paqe** për veten dhe të tjerët kur t'i lexoni artikujt e këtij muaji.




Fëmijët

Mëso më shumë rreth arsyes se **përse e kremtojmë Pashkën** duke lexuar për Jezu Krishtin, Shlyerjen dhe Ringjalljen e Tij dhe se çfarë domethënie kanë ato për ne.



ARTIKUJT E PARAQITUR VETËM NË FORMATIN ELEKTRONIK



Ushtrimi i Muskujve Tuaj Shpirtërorë

Nga Aspen Stander

Për të parandaluar atrofinë e dëshmisë sonë, ne duhet t'i ndërtojmë vazhdimisht muskujt tanë shpirtërorë.



A po e Jetoni Ungjillin me Gjysmë Zemrë?

Nga Çejkëll Uordlei

Cili është me të vërtetë ndryshimi midis të qenit i zënë me punë në Kishë dhe të qenit aktiv në ungjill?

PRILL 2019 VËLLIMI 21 NR. 2 LIAHONA 18604 101

Revista ndërkombëtare zyrtare e Kishës së Jezut Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme

Presidencia e Parë: Rasëll M. Nelson, Dallin H. Ouks, Henri B. Ajring

Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve: M. Rasëll Ballard, Xhefri R. Holland, Diter F. Uhtdorf, Dejvid A. Bednar, Kuentin L. Kuk, D. Tod Kristoferson, Nil L. Andersen, Ronald A. Rasband, Geri E. Stivenson, Dejll G. Renland, Gerit W. Gong, Ulises Soares

Kryeredaktor: Randy D. Funk

Këshilltarë: Brian K. Ashton, Randall K. Bennett, Becky Craven, Sharon Eubank, Cristina B. Franco, Donald L. Hallstrom, Larry S. Kacher, Eric W. Kopischke, Lynn G. Robbins

Drejtor Përgjegjës: Richard I. Heaton

Drejtor i Revistave të Kishës:

Allan R. Loyborg

Përgjegjës i Punëve: Garff Cannon

Redaktor Përgjegjës: Adam C. Olson

Ndihmësredaktor Përgjegjës:

Ryan Carr

Ndihmëse e Botimit: Camila Castrillón

Grupi i Shkrimit dhe i Redaktimit:

Maryssa Dennis, David Dickson, David A. Edwards, Matthew D. Flitton, Garrett H. Garff, Jon Ryan Jensen, Charlotte Larcabal, Michael R. Morris, Eric B. Murdock, Sally Johnson Odekirik, Joshua J. Perkey, Jan Pinborough, Richard M. Romney, Mindy Selu, Lori Fuller Sosa, Chakell Wardleigh, Marissa Widdison

Drejtor Përgjegjës i Artit:

J. Scott Knudsen

Drejtor Arti: Tadd R. Peterson

Grupi i Faqosjes: Jeanette Andrews, Fay P. Andrus, Mandie Bentley, C. Kimball Bott, Thomas Child, Joshua Dennis, David Green, Colleen Hincley, Eric P. Johnsen, Susan Lofgren, Scott M. Mooy, Emily Chieko Remington, Mark W. Robison, Brad Teare, K. Nicole Walkenhorst

Bashkërenduese për Pronësinë Intelektuale:

Collette Nebeker Aune

Përgjegjëse e Prodhimit:

Jane Ann Peters

Grupi i Prodhimit: Ira Glen Adair, Julie Burdett, Thomas G. Cronin, Bryan W.

Gygi, Ginny J. Nilson, Marrissa M. Smith

Përgatitja për Shtyp: Joshua Dennis, Ammon Harris

Drejtor Shtypi: Steven T. Lewis

Drejtor i Shpërndarjes: Troy R. Barker

Mbikëqyrës i Përkthimit Shqip: Sparti Kashari

Për pajtimet dhe për çmimet jashtë Shteteve të Bashkuara dhe Kanadasë, shkoni në store.lds.org ose kontaktoni me qendrën tuaj vendore të Kishës për shpërndarjen me ose udhëheqësin e lagjes apo degës.

Paraqitni dorëshkrimet dhe pyetjet në internet në liahona.lds.org: nëpërmjet postës elektronike liahona@ldschurch.org; ose nëpërmjet postës në Liahona, Rm. 2420, 50 E. North Temple St., Salt Lake City, UT 84150-0024, USA.

Liahona (një term nga Libri i Mormonit, që do të thotë "busull" apo "drejtues") botohet në anglisht, armenisht, bislamisht, bullgarisht, çekisht, danisht, estonisht, fihisht, finlandisht, frëngjisht, greqisht, gjermanisht, holandisht, hungarisht, indonezisht, islandisht, italisht, japonisht, kamboxhianisht,

kinezisht, kiribatisht, koreanisht, kroatisht, letonisht, lituanisht, malagasisht, marshallisht, mongolisht, norvegjisht, polonisht, portugalisht, rumanisht, rusisht, samoaisht, sebuanisht, sillovenisht, spanjisht, suahilisht, suedisht, shqip, tagalogisht, tahitisht, taisht, tongaisht, ukrainisht, urduisht dhe vietnamisht. (Periodicitet ndryshon sipas gjuhës.)

© 2019 nga Intellectual Reserve, Inc. All rights reserved. Shtypur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Informacion për të drejtën e autorit:

Përveç nëse sugjerohet ndryshe, individët mund të kopjojnë material nga Liahona për përdorimin e tyre vetjak, jo për tregti (përfshirë për thirrjet në Kishë). Kjo e drejtë mund të anulohet në çdo kohë. Lënda figurative nuk lejohet të kopjohet nëse ajo shoqërohet me kufizime të shënimit i meritave për punën artistike. Çështjet e së drejtës së autorit duhet të drejtohen tek Intellectual Property Office, 50 E. North Temple St., FL 13, Salt Lake City, UT 84150, USA; adresa elektronike: cor-intellectualproperty@ldschurch.org.

For Readers in the United States and Canada:

April 2019 Vol. 21 No. 2. LIAHONA (USPS 311-480) Albanian (ISSN 1521-4753) is published six times a year (January, April, May, July, October, and November) by The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints, 50 E. North Temple St., Salt Lake City, UT 84150, USA. USA subscription price is \$5.00 per year; Canada, \$6.50 plus applicable taxes. Periodicals Postage Paid at Salt Lake City, Utah. Sixty days' notice required for change of address. Include address label from a recent issue; old and new address must be included. Send USA and Canadian subscriptions to Salt Lake Distribution Center at address below. Subscription help line: 1-800-537-5971. Credit card orders (Visa, MasterCard, American Express) may be taken by phone or at store.lds.org. (Canada Post Information: Publication Agreement #40017431)

POSTMASTER: Send all UAA to CFS (see DMM 507.1.5.2). NONPOSTAL AND MILITARY FACILITIES: Send address changes to Distribution Services, Church Magazines, P.O. Box 26368, Salt Lake City, UT 84126-0368, USA.

GJENI MË SHUMË

Në programin kompjuterik Gospel Library [Biblioteka e Ungjillit] dhe te liahona.lds.org, ju mund:

- Të gjeni botimin e tanishëm.
- Të zbuloni përmbajtje që janë vetëm në formatin elektronik.
- Të kërkonti botime të mëparshme.
- Të dorëzoni historitë dhe përshtypjet tuaja.
- Të abonoheni ose të bëni abonim për dhuratë.
- Të përmirësoni studimin me anë të mjeteve elektronike.
- Të shpërndani artikujt dhe materiale filmike të parapëlqyera.
- Të shkarkoni ose shtypni artikujt.
- Të dëgjoni artikujt tuaj të parapëlqyer.

KOMUNIKONI ME NE

Dërgojini me postë elektronike pyetjet dhe përshtypjet tuaja te liahona@ldschurch.org.


Dorëzoni historitë tuaja besimnxitëse te liahona.lds.org ose postojini te:

Liahona, flr. 23

50 E. North Temple Street

Salt Lake City, UT 84150-0023, USA

A i është ngritur!
Ai është ngritur!
Thoni me zë plot hare.
Ai shpërtheu tri dit' t e burgut;
Gjith' toka le të g'zohet'.
U mposht vdekja, jemi t' lir'.
Fitoren solli Krishti.
(“Ai Ësht' Ngritur!” Himne, nr. 118.)



Ndërsa e kujtoni Shpëtimtarin këtë Pashkë, ju mund të vizitoni lds.org/go/4195 për të parë vepra arti të bukura dhe dëshmitë e Apostujve për cilësitë e Shpëtimtarit, të cilat bënë të mundur Shlyerjen dhe Ringjalljen e Tij.



Bobi dhe Lori Thërston

Shërbyen në Misionin e Pnom-Penit në Kamboxha.



Në misionin e tyre të parë së bashku, Bob dhe Lori Thërston mësuan se dhënia e shërbesës kuptimplotë mund të ndodhë pavarësisht nga pengesat gjuhësore dhe dallimet kulturore, pasi të gjithë ne jemi fëmijë të Perëndisë.

LESLI NILSON, FOTOGRAFE

Bobi:

Një ditë ne mund të dëgjonim muzikë që gjëmonte, dhe vumë re se po ngrihej një tendë. Në Kamboxhë, kjo nënkupton se dikush është duke u martuar ose dikush ka vdekur.

Lori:

Zbuluam se një nënë e pesë ose gjashtë fëmijëve sapo kishte vdekur. Bashkëshorti nuk ishte atje. Fëmijët sapo ishin zgjuar dhe kuptuan se nëna e tyre kishte vdekur.

Njëra nga vajzat thjesht qante me ngashërim. Përmes një përkthyesi, ajo tha: "Jam më e madhja. Kam gjithë këta vëllezër e motra. Nuk di se çfarë do të bëj."

E përqafova fort pas vetes. Si të mos e bëja? Kjo vajzë sapo humbi nënën. I foli në anglisht dhe i thashë: "E di që ti nuk më kupton, por të premtoj se do ta shohësh nënën tënde përsëri. Çdo gjë do të jetë mirë. Nuk do të ngelesh vetëm."

Përvoja të shumta si kjo na kanë dhënë një lidhje të veçantë me njerëzit në Kamboxhë.

ZBULONI MË SHUMË

Gjeni më shumë Portrete Besimi të lds.org/go/18.



Parimet e Dhënies së Shërbesës

TA BËSH TË

Gëzueshme DHËNIEN E SHËRBESËS

Të shërbyerit me dashuri i sjell gëzim si dhuruesit ashtu edhe marrësit.

Ndonjëherë kërkimi ynë për lumturinë në këtë jetë mund të duket si vrapimi në një tapet vrapimi. Vrapojmë e vrapojmë dhe prapë ndiejmë se nuk kemi vajtur gjëkund. Për disa, mendimi i dhënies së shërbesës ndaj të tjerëve thjesht të bën të ndihesh sikur po të shtohen më shumë gjëra për të bërë.

Por Ati ynë Qjellor do që ne të përjetojmë gëzim dhe na ka thënë se “njerëzit janë, që ata të mund të kenë gëzim” (2 Nefi 2:25). Dhe Shpëtimtari dha mësim se t’u japësh shërbesë të tjerëve është një pjesë themelore e mënyrës se si ne sjellim gëzim në jetën tonë dhe në jetën e të tjerëve.

Çfarë Është Gëzimi?

Gëzimi është përkufizuar si “një ndjenjë kënaqësie dhe lumturie”¹. Profetët e ditëve të mëvonshme kanë dhënë sqarim se nga vjen gëzimi dhe se si gjendet ai. “Gëzimi që ndiejmë, ka të bëjë pak me rrethanat e jetës sonë dhe ka të bëjë plotësisht me përqendrimin e jetës sonë”, tha Presidenti Rasëll M. Nelson. “. . . Gëzimi vjen prej [Jezu Krishtit] dhe për shkak të Tij. Ai është burimi i të gjithë gëzimit.”²



Dhënia e Shërbesës Sjell Gëzim

Kur Lehi mori nga fruti i pemës së jetës, shpirti i tij u mbush “me gëzim jashtëzakonisht të madh” (1 Nefi 8:12). Dëshira e tij e parë ishte që ta ndante këtë frut me ata njerëz që ai i donte.

Gatishmëria jonë për t’u dhënë shërbesë të tjerëve mund të na e sjellë këtë lloj gëzimi neve dhe atyre. Shpëtimtari u mësoi dishepujve të Tij se fruti që japim kur jemi të lidhur me Të, ndihmon për të na sjellë një plotësi gëzimi (shih Gjoni 15:1–11). Ta bësh punën e Tij duke shërbyer dhe duke kërkuar t’i sjellësh të tjerët tek Ai mund të jetë një përvojë e gëzueshme (shih Lluka 15:7; Alma 29:9; Doktrina e

Besëlidhje 18:16; 50:22). Ne mund ta përjetojmë këtë gëzim edhe kur përballemi me kundërshtimin dhe vuajtjen (shih 2 Korintasve 7:4; Kolosianëve 1:11).

Shpëtimtari na tregoi shembullin e përsosur se një nga burimet më të mëdha të gëzimit të vërtetë në jetën në vdekshmëri gjendet te shërbimi. Kur u shërbejmë vëllezërve dhe motrave tona ashtu siç bëri Shpëtimtari, me dashuri hyjnore dhe dashuri në zemrat tona, mund të përjetojmë gëzimin që kalon përtej lumturisë së thjeshtë.

“Ndërsa [e] pranojmë [dhënien e shërbesës] me zemra të gathme, ne do të jemi më afër bërjes një popull i Sionit dhe do të ndiejmë gëzim të jashtëzakonshëm me ata që kemi

BURIM I KËNAQËSISË SË VËRTETË

Shpëtimtari na tregoi shembullin e përsosur, se gëzimi i vërtetë në jetën në vdekshmëri mund të gjendet nëpërmjet shërbimit.



ndihmuar përgjatë shtegut të dishepullimit”, dha mësim Motra Xhin B. Bingham, Presidente e Përgjithshme e Shoqatës së Ndihmës.³

Si Mund ta Bëjmë Dhënien e Shërbesës më të Gëzueshme?

Ka shumë mënyra për të sjellë gëzim më të madh në dhënien e shërbesës sonë. Ja disa ide:

- 1. Kuptoni qëllimin tuaj në dhënien e shërbesës.** Ka shumë arsye për të dhënë shërbesë. Përfundimisht, përpjekjet tona duhet të përputhen me qëllimet e Perëndisë që “të bëj[ë] të ndodhë pavdekësia dhe jeta e përjetshme e njeriut” (Moisiu 1:39). Ndërsa e pranojmë ftesën e Presidentit Rasëll M. Nelson për t’i ndihmuar të tjerët përgjatë shtegut të besëlidhjes, ne mund të gjejmë gëzim te pjesëmarrja në punën e Perëndisë.⁴ (Për më shumë [informacion] mbi qëllimin e dhënies së shërbesës, shih “Ministering Principles: The Purpose That Will Change Our Ministering”, në revistën *Liahona*, janar 2019.)
- 2. Bëjeni dhënien e shërbesës një çështje njerëzish, jo detyrash.** Presidenti Tomas S. Monson shpesh na kujtonte: “Mos lejoni kurrë që zgjidhja e një problemi, të bëhet më e rëndësishme se një person që ka nevojë ta doni”⁵. Dhënia e shërbesës ka të bëjë me dashurinë për njerëzit, jo me gjërat

që duhet të bëjmë. Kur arrijmë të duam ashtu siç deshi Shpëtimtari, ne do të jemi më të hapur ndaj gëzimit që vjen duke u shërbyer të tjerëve.

- 3. Thjeshtojeni dhënien e shërbesës.** Presidenti M. Rasëll Ballard, Presidenti Veprues i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, na thotë: “Gjëra të mëdha bëhen përmes gjërave të vogla e të thjeshta. . . Veprat tona të vogla e të thjeshta të mirësisë dhe shërbimit do të mblidhen në një jetë mbushur me dashuri për Atin Qjellor, përkushtim ndaj punës së Zotit Jezu Krisht dhe një ndjesi paqeje dhe gëzimi çdo herë që ne zgjasim duart për të dashur njëri-tjetrin.”⁶
- 4. Hiqeni stresin nga dhënia e shërbesës.** Nuk është përgjegjësia juaj të punoni për shpëtimin e dikujt. Kjo është mes

Mos e Vononi Gëzimin e të Shërbyerit

Ndonjëherë njerëzit hezitojnë të kërkojnë ndihmën që u nevojitet, kështu që ofrimi i shërbimit tonë mund të jetë pikërisht ajo që u nevojitet. Por as t’u imponohemi të tjerëve nuk është zgjidhja. Të kërkonit leje para se të jepni shërbesë është një ide e mirë.

Plaku Diter F. Uhtdorf, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, tregoi për një nënë të vetme që e zuri lija e dhenve – dhe pastaj u sëmuren edhe fëmijët e saj. Shtëpia që normalisht ishte e pastër u bë rrëmujë dhe e çrregullt. Enët dhe rrobat e palara u bënë dëng.

Në një çast kur ndihej plotësisht e dërrmuar, motrat e Shoqatës së Ndihmës trokitën në derën e saj. Ato nuk thanë: “Na thuaj nëse mund të të ndihmojmë”. Kur e panë situatën, ato u hodhën në veprim.

“E pastruan kaosin, sollën dritë e qartësi në shtëpi dhe morën në telefon një mikeshë për të sjellë disa ushqime tepër të nevojshme. Kur më së fundi e mbaruan punën e tyre dhe i thanë mirupafshim, ato e lanë nënën e re duke derdhur lot – lot mirënjohjeje dhe dashurie.”⁷

Edhe dhurueset edhe marrësja ndien ngrohtësinë e gëzimit.

individit dhe Zotit. Përgjegjësia jonë është t'i duam ata dhe t'i ndihmojmë të kthehen te Jezu Krishti, i cili është Shpëtimtari i tyre.

Kultivoni Gëzim në Jetën Tuaj

Sa më shumë gëzim, paqe dhe kënaqësi që mund të kultivojmë në jetën tonë, aq më shumë do të jemi në gjendje të ndajmë me të tjerët ndërsa japim shërbesë. Gëzimi vjen nëpërmjet Frymës së Shenjtë (shih Galatasve 5:22 dhe Doktrina e Besëlidhje 11:13). Është diçka për të cilën ne mund të lutemi (shih Doktrina e Besëlidhje 136:29) dhe ta ftojme në jetën tonë. Ja disa ide që ta kultivojmë gëzimin në vetë jetën tonë:

- 1. Numëroni bekimet tuaja.** Ndërsa e merrni në shqyrtim jetën tuaj, shkruani në ditarin tuaj gjërat me të cilat ju ka bekuar Perëndia.⁸ Vërejeni gjithë të mirën përreth jush.⁹ Kushtojini vëmendje asaj që mund t'ju pengojë për ta ndier gëzimin dhe shkruani mënyra për t'i zgjidhur ose kuptuar më mirë ato. Gjatë kësaj stine Pashke, gjeni kohë për të kërkuar një lidhje më të madhe me Shpëtimtarin (shih Doktrina e Besëlidhje 101:36).
- 2. Ushtroni maturi.** Gëzimi mund t'ju gjejë më lehtë në çaste meditim të qeta.¹⁰ Dëgjojeni me kujdes se çfarë ju sjell gëzim (shih 1 Kronikave 16:15). Koha larg mediave shoqërore ndonjëherë mund të jetë e nevojshme për të ushtruar maturi.¹¹
- 3. Shmangeni krahasimin e vetes.** Është thënë se krahasimi është hajduti i gëzimit. Pali paralajmëroi se njerëzit e “duke matur veten e tyre dhe duke u krahasuar me veten e tyre, nuk kanë mend” (2 Korintasve 10:12).
- 4. Kërkoni zbulësë vetjake.** Shpëtimtari dha mësim: “Në qoftë se do të kërkosh, ti do të marrësh zbulësë pas zbulësë, dituri pas diturie, që të mund të dish misteret dhe gjërat paqësore – ato që sjellin gëzim, ato që sjellin jetë të përjetshme” (Doktrina e Besëlidhje 42:61).

Ftesë për të Vepruar

Si mund ta shtoni gëzimin që gjeni në jetën tuaj nga dhënia e shërbesës? ■

Parimet në këtë artikull mund të zbatohen në ndërveprimet tona të përditshme, por kanë për qëllim t'i ndihmojnë vëllezërit dhe motrat shërbestare në përpjekjet e tyre për t'i bekuar individët dhe familjet që u janë caktuar atyre.

SHËNIME

1. “Joy”, en.oxforddictionaries.com
2. Rasëll M. Nelson, “Gëzimi dhe Mbijetesa Shpirtërore”, *Liahona*, nëntor 2016, f. 82.
3. Xhin B. Bingham, “Dhënia e Shërbesës Ashtu siç e Jep Shpëtimtari”, *Liahona*, maj 2018, f. 107.
4. Shih Rasëll M. Nelson, “Teksa Ecim Përpara së Bashku”, *Liahona*, prill 2018, f. 4–7.
5. Tomas S. Monson, “Të Gjejmë Gëzim në Udhëtim”, *Liahona*, nëntor 2008, f. 86.
6. M. Rasëll Ballard, “Duke Gjetur Gëzim përmes Shërbimit të Përzemërt”, *Liahona*, maj 2011, f. 49.
7. Shih Diter F. Uhtdorf, “Të Jetuarit e Ungjillit Plot Gëzim”, *Liahona*, nëntor 2014, f. 122–123.
8. Shih Henri B. Ajring, “O, Kujtoni, Kujtoni”, *Liahona*, nëntor 2007, f. 67.
9. Shih Xhin B. Bingham, “Që Gëzimi Juaj të Jetë i Plotë”, *Liahona*, nëntor 2017, f. 87.
10. Shih Diter F. Uhtdorf, “Për Gjërat që Kanë më Shumë Rëndësi”, *Liahona*, nëntor 2010, f. 21.
11. Shih Geri E. Stevenson, “Eklipsi Shpirtëror”, *Liahona*, nëntor 2017, f. 46.





Në Kohë Shkurajimi, Kujtoni të *Venë e Nainit*

Kur ndihemi veçanërisht të harruar apo të shpërfillur, ne duhet të kujtojmë: Jezusi i erdhi në ndihmë të vesë pikërisht në kohën e saj të nevojës, dhe Ai do të vijë edhe te ne.

Nga Kith Uilson

Profesor i Asociuar i Shkrimeve të Shenjta të Lashta, Universiteti "Brigam Jang"

Ndonjëherë në uljet dhe ngritjet e jetës, ne mund të mendojmë sikur Perëndia nuk është shumë aktiv në jetën tonë të përditshme. Jeta jonë duket mjaft e lodhshme dhe monotone. Jo shumë ndryshime, dhe ndonjëherë është e vështirë të tregohet një aspekt ku Perëndia ka ndërhyrë drejtpërdrejt në rrethanat tona. Sa herë që marr goditje nga këto ndjenja të parëndësishme në vetë jetën time, shpesh mendoj për një grua në Dhiatën e Re që mund të jetë ndier në këtë mënyrë. Ajo nuk përmendet në shkrimet e shenjta, por thjesht njihet nga emri i fshatit të saj dhe nga statusi i saj martesor.

Gruaja është e veja e Nainit, dhe vetëm ungjilltari Lluka e shënon historinë e saj të mahnitshme. Për mua ajo përfaqëson thelbin e shërbesës së personalizuar të Shpëtimtarit dhe mënyrën se si Ai ia shtriu dorën e ndihmës njerëzve të shkurajuar e të zakonshëm të shoqërisë së Tij. Ky rrëfim e zgjidh qartësisht çështjen nëse Perëndia na njeh dhe kujdeset për ne.

Një përmbledhje e shkurtër e mrekullisë të Lluka kapitulli 7 përshkruan Jezusin kur arrin një kortezh varrimi dhe risjell në jetë e në mënyrë mrekullibërëse një të ri që kishte vdekur. Por ka shumë më tepër për të kuptuar rreth mjedisit. Si me të gjitha mrekullitë, por veçanërisht me këtë, konteksti është jetik për ta kuptuar këtë ndodhi. Ngaqë kam dhënë mësim në Qendrën e Universitetit "Brigam Jang" në Jerusalem,


unë do t'ju tregoj disa njohuri vetjake për këtë mrekulli.

Në kohën e Jezusit, Naini ishte një fshat i vogël bujqësor, që ndodhej pranë malit Morehu, i cili kufizonte anën lindore të luginës së Jezreelit. Vetë qyteti ishte jashtë shtegut të rrahur. Në qytet mund të hyje vetëm nga një rrugë. Gjatë kohës së Jezusit, ky vendbanim duhet të ketë qenë i vogël dhe relativisht i varfër, dhe ka mbetur kështu që nga ajo kohë. Herë pas here në historinë e tij, ky qytet ka përfshirë gati 34 shtëpi dhe vetëm 189 njerëz.¹ Sot ai është shtëpia e rreth 1 500 banorëve.

Lluka e fillon rrëfimin e tij duke vënë në dukje se Jezusi ishte në Kapernaumi një ditë më parë dhe kishte shëruar shërbëtorin e centurionit (shih Lluka 7:1–10). Më pas ne mësojmë që “*të nesërmen*” (vargu 11; theksimi i shtuar), Shpëtimtari u fut në një qytet të quajtur Nain, i shoqëruar nga një grup i madh dishepujsh. Ky rend ngjarjesh është shumë i rëndësishëm. Kapernaumi ndodhet në bregun verior të Detit të Galileesë, 183 m nën nivelin e detit. Naini është rreth 48 km në jugperëndim të Kapernaumit, 213 m mbi nivelin e detit, duke kërkuar në këtë mënyrë një ngjitje të lodhshme dhe të përpjetë në Nain. Që të ecni nga Kapernaumi në Nain, do të kërkonte të paktën një ose dy ditë. Kohët e fundit, një grupi studentësh të rinj nga Qendra e UBJ-së në Jerusalem, iu deshën 10 orë për ta bërë në këmbë këtë itinerar në rrugë të shtruar. Kjo do të thotë se Jezusit ndoshta iu desh të ngrihej shumë herët ose madje të ecte gjatë natës në mënyrë që “*të nesërmen*” të arrinte kortezhin e varrimit².

Ndërsa Krishti iu afrua qytetit pas një udhëtimi shumë të lodhshëm, një i ri ndoshta në të 20-at³, po mbartej në një rrasë varri. Lluka na tregon se ky i ri ishte bir i vetëm i një të veje, dhe disa studiues e interpretojnë tekstin grek që nënkupton se ajo nuk kishte asnjë pasardhës tjetër.⁴ Një grup i madh fshatarësh e shoqëruan atë në këtë tragjedi familjare kaq fatkeq.

Natyrisht, vdekja e një djali do të ishte





tragjedi për këdo, por merrni në shqyrtim ndërlikimet për këtë të ve. Çfarë domethënie do të ketë pasur në pikëpamjen shoqërore, shpirtërore dhe financiare të ishe e ve, pa trashëgimtar, në Izraelin e lashtë? Në kulturën e Dhiatës së Vjetër, besohej se kur një bashkëshort vdiste para pleqërisë, kjo ishte një shenjë e gjykimit të Perëndisë për mëkatin. Pra, disa besonin se Perëndia po e ndëshkonte këtë të ve të mbijetuar. Në librin e Ruthit, kur Naomi ishte e ve në moshë të hershme, ajo vajtoi: “Mbi të gjitha, Zoti është kundër meje dhe i Plotfuqishmi më ka shkatërruar” (Ruthit 1:21, Varianti Standard Ndërkombëtar).⁵

Jo vetëm që kishte dhembje shpirtërore dhe emocionale, por kjo e ve nga Naini po përballlej edhe me rrënim financiar – madje po përballlej me vdekjen nga uria.⁶ Në martesë, një grua i caktohej familjes së bashkëshortit të saj për mbrojtje financiare. Nëse ai vdiste, atëherë kujdesi për të i delegohej djalit të saj të parëlindur. Tani që djali i parëlindur dhe i vetëm i së vesë kishte vdekur, ajo nuk kishte asnjë mbrojtje financiare. Nëse djali i saj ishte në të 20-at, ajo ndoshta ishte një grua në moshë të mesme, që jetonte në një qytet bujqësor të vogël e të veçuar, dhe tani e pa veten në skamje nga pikëpamja shpirtërore, shoqërore dhe financiare.

Pikërisht gjatë kohës së shkurtër kur fshatarët po e çonin birin e kësaj gruaje për t’u varrosur, Jezusi u takua me kortezhin dhe pati “dhembshuri për të” (Lluka 7:13). Në të vërtetë,





ky mund të jetë minimizimi më i madh që bën Lluka. Jezusi e ndjeu disi situatën krejt të dëshpëruar të kësaj të veje. Ndoshta ajo e kishte kaluar natën e plandosur në dyshe-menë prej dheu, duke iu përgjëruar Atit Qjellor që të dinte arsyen. Ndoshta, ajo mund ta ketë pyetur haptazi se pse Ai po kërkonte që ajo të jetonte më gjatë në këtë tokë. Ose ndoshta ajo ishte e tmerruar nga vetmia e pritshme me të cilën do të përballej. Ne nuk e dimë. Por ne e dimë se Shpëtimtari zgjodhi të largohej menjëherë nga Kapernaumi, gjë e cila mund t'i ketë kërkuar Atij që të ecte natën, në mënyrë që të kapte kortezhin e varrimit pikërisht përpara se ta futnin trupin në dhe.

Po, kur Ai e pa fytyrën e saj të lagur nga lotët tekta ecte pas kortezhit, Jezusi ndjeu dhembshuri të madhe për këtë grua – por duket se dhembshuria e Tij buronte nga ndjenja që Ai i përjetoi shumë kohë përpara se të “rastiste” ta arrinte atë shpurrë varrimi. Ai mbërriti atje pikërisht në çastin e saj të nevojës.

Jezusi më pas i tha të vesë të “mos qa[nte]” (vargu 13). I pafrikësuar nga papastërtia rituale, Ai e “preku arkivolin” dhe kortezhi “u ndal”. Atëherë, Ai urdhëroi: “Djalosh, unë të them, çohu!”.

Dhe i vdekuri u çua ndenjor dhe filloi të flasë. Dhe Jezusi ia dha së ëmës” (vargjet 14–15). Natyrisht, turma e fshatarëve dhe e pasuesve të Jezusit ishin të habitur, sepse brenga e tyre e përbashkët u kthye në gëzim të vërtetë. Ata të gjithë “e lëvd[uan] Perëndinë duke thënë: ‘Midis nesh doli një profet i madh’” (vargu 16). Por kjo mrekulli ishte gjithashtu për shpëtimin e një shpirti të dëshpëruar. Jezusi ishte i vetëdijshëm se kishte diçka shumë të gabuar ndaj kësaj gruaje – një person që përçmohej në kulturën e tyre. Situata e saj kërkonte vëmendjen e Tij të menjëhershme, edhe nëse Atij do t'i duhej të udhëtonte larg për të qenë atje pikërisht në çastin e duhur. Ai e dinte situatën e saj të dëshpëruar dhe Ai erdhi shpejt. Presidenti Tomas S. Monson (1927–2018) foli për të vërtetën e pamohueshme kur tha: “Një ditë, kur ta hedhim vështrimin prapa, te rastësitë në dukje në jetën tonë, ne do të kuptojmë se ndoshta, tek e fundit, ato nuk ishin kaq të rastësishme”⁷.

Tani, aq lartësuese sa ç’është kjo ndodhi, ajo duhet të bëhet shumë më tepër sesa një histori Bible e kënaqshme për ne. Ajo vërteton në mënyrë të pagabueshme se Jezusi e njihte këtë të ve të varfër, të harruar dhe në skamje. Kur

ndihemi veçanërisht të harruar, të shpërfillur ose të parëndësishëm, ne duhet të kujtojmë: Jezusi erdhi tek e veja në një kohë nevojë të dëshpëruar, dhe Ai do të vijë edhe tek ne. Përveç kësaj, një mësim i dytë që mund të marrim nga shembulli i Shpëtimtarit tonë është rëndësia e të ndihmuarit për t'i bekuar të tjerët rreth jush. Shumë njerëz brenda rrethit tuaj do të shkurajohen herë pas here. Nëse mund t'u tregoni për “Motrën Nain” dhe mënyrën se si Zoti e kuptonte saktësisht shkurajimin e saj dhe krizën e madhe vetjake, kjo mund ta kthejë natën në ditë. Sillni ndër mend vëzhgimin prekës të Presidentit Spenser W. Kimball (1895–1985): “Perëndia na vë re dhe kujdeset për ne. Por zakonisht është nëpërmjet një personi tjetër që ai i plotëson nevojat tona.”⁸

Nga të gjitha mrekullitë e Jezusit gjatë jetës së Tij këtu në tokë, për mua, pak janë aq të ndjeshme dhe të dhembshura sa shërbimi i Tij ndaj të vesë së Nainit. Kjo na kujton se ne kemi rëndësi për Të dhe se Ai nuk do të na harrojë kurrë. Ne nuk mund ta harrojmë këtë. ■

SHËNIME

1. Shih E. Mills, *Census of Palestine 1931: Population of Villages, Towns, and Administrative Areas* (1932), f. 75.
2. Shih S. Kent Brown, *The Testimony of Luke* (2015), f. 364.
3. Shih Brown, *The Testimony of Luke*, f. 365.
4. Shih Brown, *The Testimony of Luke*, f. 365.
5. Tek Isaia 54:4, Zoti i thotë Izraelit të ve se ajo “nuk do ta kujtojë më turpin e braktisjes së [saj]” (Përkthim i Ri në Anglisht).
6. Shih Brown, *The Testimony of Luke*, f. 365.
7. Thomas S. Monson, në Joseph B. Wirthlin, “Lessons Learned in the Journey of Life”, *Liahona*, maj 2001, f. 38.
8. *Teachings of Presidents of the Church: Spencer W. Kimball* (2006), f. 82.



Për të parë materialin filmik nga Bibla “Widow of Nain” [“E Veja e Nainit”], vizitoni [lds.org/go/ 041917](https://lds.org/go/041917).



MIRËBESONI NË Shpëtimin E SHPËTIMTARIT



Nga Presidenti
Henri B. Ajring,
Këshilltar i Dytë në
Presidencën e Parë

Shlyerja dhe Ringjallja e Shpëtimtarit i japin Atij fuqinë për të na forcuar në sprovat tona ose për të na shpëtuar prej tyre.

Për ata prej nesh që kanë humbur njerëz të dashur, rruga përpara mund të jetë e trishtuar dhe e vetmuar – madje edhe më shumë për ata që nuk kanë njohuri dhe dëshmi për Shlyerjen dhe Ringjalljen e Shpëtimtarit Jezu Krisht. Ju kujtohen dy dishepujt e Tij dyshues rrugës për në Emaus. Zoti i ringjallur u afrua pranë tyre dhe i pyeti pse ishin të trishtuar. Lluka na jep përgjigjen:

“Ata i thanë: ‘Çështjen e Jezusit nga Nazareti, që ishte një profet i fuqishëm në vepra dhe në fjalë përpara Perëndisë dhe përpara gjithë popullit.

Dhe se si krerët e priftërinjve dhe kryetarët tanë e kanë dorëzuar për ta dënuar me vdekje dhe e kanë kryqëzuar.

Por ne kishim shpresë se ai do të ishte ky që do ta çlironte Izraelin” (Lluka 24:19–21).

Ne ngushëlohem nga njohuria dhe dëshmia jonë se *ishte* Ai që e çliroi Izraelin. *Ishte* Ai që i “[këputi] lidhjet e vdekjes” (Mosia 15:23). *Ishte* Ai që u bë “fryti i parë i atyre që kanë fjetur” (1 Korintasve 15:20). *Ishte* Ai që i bëri të mundura besëlidhjet e tempullit, që na lidhin përgjithmonë me ata që i kemi “dashur prej kohësh pak t’humbura!”¹

Në këtë stinë Pashke, do të doja të tregoja një pjesë të një mesazhi nga një takim shpirtëror që dhashë pak vite më parë lidhur me fuqinë shpëtuese të Shpëtimtarit. Ky mesazh më forcoi teksa e përgatita dhe e dhashë. Lutem që t’ju forcojë [edhe ju] teksa do ta lexoni.

Shpëtimtari i Njeh Brengat Tona

Jeta përfundon më herët për disa dhe në fund të fundit do të përfundojë për të gjithë ne. Secili prej nesh do të vihet në provë duke u përballur me vdekjen e dikujt që e duam.

Një ditë takova një njeri që nuk e kisha parë që kur bashkëshortja e tij vdiq. Ishte një takim i rastësishëm në një situatë të këndshme pushimesh si shoqëri. Ai po buzëqeshte teksa m'u afrova. Duke e mbajtur mend vdekjen e gruas së tij, e formulova me shumë kujdes përshëndetjen time: "Si po ia kalon?"

Buzëqeshja u zhduk, sytë iu njomën dhe ai

tha qetësisht e me seriozitet të madh: "Po ia kaloj mirë. Por është shumë e vështirë".

Është shumë e vështirë, ashtu siç ju të gjithë e keni mësuar dhe që të gjithë ne një ditë do ta dimë. Pjesa më e vështirë e asaj prove është të dimë se çfarë të bëjmë me pikëllimin, vetminë dhe humbjen që mund të ndiejmë, sikur një pjesë e jona të ketë humbur. Brenga mund të vazhdojë si një dhembje kronike. Dhe për disa njerëz, mund të ketë ndjenja zemërimi ose padrejtësie.

Shlyerja dhe Ringjallja e Shpëtimtarit i japin Atij fuqinë për të na shpëtuar në një sprovë të tillë. Nëpërmes përvojës së Tij, Ai arriti t'i njohë



*Shpëtimtari mund t'i kishte njohur
bregat tona me anë të frymëzimit të
Shpirtit, por në vend të kësaj Ai zgjodhi
t'i njihnte ato duke i përjetuar Vetë.*

të gjitha bregat tona. Ai mund t'i kishte njohur ato me anë të frymëzimit të Shpirtit, por në vend të kësaj Ai zgjodhi t'i njihnte ato duke i përjetuar Vetë. Ky është rrëfimi:

“Dhe vini re, ai do të lindet nga Maria në Jeruzalem, që është toka e stërgjyshërve tanë, ajo duke qenë virgjëreshë, një enë e çmueshme dhe e zgjedhur, që do të jetë e mbuluar nga hija dhe do të mbetet shtatzënë nga fuqia e Frymës së Shenjtë dhe do të lindë një djalë, po, madje Birin e Perëndisë.

Dhe ai do të shkojë përpara, duke vuajtur dhimbje dhe hidhërimi dhe tundime të çdo lloji; dhe kjo, që të plotësohet fjala që thotë se ai do të marrë përsipër dhembjet dhe sëmundjet e popullit të tij.

Dhe ai do të marrë përsipër vdekjen që ai të mund të zgjidhë rripat e vdekjes, që e lidhin popullin e tij; dhe ai do të marrë përsipër dobësitë e tyre, që zemra e tij të mund të mbushet me mëshirë, sipas mishit, që ai të mund të dijë, sipas mishit, se si të ndihmojë popullin e tij sipas dobësive të tyre” (Alma 7:10–12).

Njerëz të mirë përreth jush do të përpiqen ta kuptojnë brengën tuaj për vdekjen e një njeriu të dashur. Ata vetë mund ta ndiejnë brengën. Shpëtimtari jo vetëm që e kupton dhe ndien brengën, por Ai gjithashtu ndien brengën *tuaj* vetjake që vetëm ju e ndieni. Dhe Ai ju njeh në mënyrë të përsosur. Ai e njeh zemrën tuaj.

Ftojeni Frymën e Shenjtë

Shpëtimtari mund ta dijë se cilën prej shumë gjërave mund të bëni që do të ishte më e mira për ju, teksa e ftoni Frymën e Shenjtë t'ju ngushëllojë e t'ju bekojë. Ai do ta dijë se ku është vendi më i mirë për të filluar. Ndonjëherë do të jetë që të luteni. Ndonjëherë do të jetë që të shkoni e ngushëlloni dikë tjetër. Njoh një të ve me një sëmundje ligështuese, e cila u frymëzua për të vizituar një të ve tjetër. Nuk isha aty, por jam i bindur se Zoti e frymëzoi një

ndjekëse besnike që t'i afrohej një tjetre, dhe kështu ishte në gjendje që t'i ndihmonte të dyja.

Ka shumë mënyra se si Shpëtimtari mund t'i ndihmojë ata që vajtojnë, secila mënyrë e përshtatur për ta. Por mund të jeni të sigurt se Ai mund dhe do ta bëjë atë në mënyrën që është më e mira për ata që vajtojnë dhe për ata përreth tyre. Një gjë e pandryshueshme që ndodh kur Perëndia i shpëton njerëzit nga brenga, është se ata ndiejnë përlësi fëmijërore para Tij. Një shembull i madh i fuqisë së përlësisë besnike vjen nga jeta e Jobit (shih Jobit 1:20–22). Një tjetër gjë e pandryshueshme, që Jobi gjithashtu kishte, është besimi i qëndrueshëm në fuqinë e Ringjalljes së Shpëtimtarit (shih Jobit 19:26).

Të gjithë do të ringjallemi, përfshirë njerëzit tuaj të dashur që vdesin. Bashkimi që do të kemi me ta nuk do të jetë i lehtë, por do të jetë me trupa që nuk do të vdesin, as nuk do të plaken apo nuk do të sëmuren kurrë.

Kur Shpëtimtari iu shfaq Apostujve të Tij pas Ringjalljes, Ai jo vetëm që i qetësoi ata në pikëllimin e tyre, por edhe të gjithë ne që mund të vajtojmë ndonjëherë. Ai i qetësoi ata dhe ne në këtë mënyrë:

“Paqja qoftë me ju. . .

Shikoni duart e mia dhe këmbët e mia, sepse unë jam. Më prekni dhe shikoni, sepse një frymë nuk ka mish e eshtra, si po shihni se unë kam!” (Lluka 24:36, 39).

Zoti mund të na frymëzojë që të marrim nga fuqia për të shpëtuar nga brenga jonë në mënyrën më të përshtatshme për ne. Ne mund të zgjedhim t'u shërbejmë të tjerëve për Zotin. Ne mund të dëshmojmë për Shpëtimtarin, ungjillin e Tij, rivendosjen e Kishës së Tij dhe Ringjalljen e Tij. Ne mund t'i zbatojmë urdhërimet e Tij.

Të gjitha këto zgjedhje e ftojnë Frymën e Shenjtë. Është Fryma e Shenjtë që mund të na ngushëllojë në mënyrën që i përshtatet nevojës sonë. Dhe me anë të frymëzimit të Shpirtit, ne mund të kemi një dëshmi për Ringjalljen dhe një pamje të qartë të bashkimit të lavdishëm që është përpara nesh. E ndjeva atë ngushëllim ndërsa vështroja gurin e varrit të dikujt që e njihja – të dikujt që e di se mund ta mbaj në krahët e mi në të ardhmen. Duke e

ditur këtë, jo vetëm që u çlirova nga brenga, por u mbusha gjithashtu me një pritshmëri të lumtur.

Nëse ajo vogëlushe do të jetonte deri në pjekuri, asaj do t'i nevojitej shpëtim nga një grup tjetër sprovash. Ajo do të ishte vënë në provë për t'i qëndruar besnike Perëndisë nëpërmjet sfidave fizike dhe shpirtërore që i vijnë gjithkujt. Megjithëse trupi është një krijim madhështor, mbajtja e tij në funksionim është një sfidë që na vë në provë të gjithëve. Gjithkush duhet të luftojë me sëmundjen dhe pasojat e plakjes.

“Ji i Përulur”

Fuqia për të na shpëtuar nga sprovat tona është aty. Ajo funksionon në të njëjtën mënyrë si shpëtimi nga sprova që vjen kur përballemi me vdekjen e një njeriu të dashur. Ashtu sikurse shpëtim nuk do të thotë gjithmonë që të kursehet jeta e një njeriu të dashur, shpëtimi nga sprovat e tjera mund të jetë që ato të mos hiqen.

*Ju mund të jeni të sigurt se
Shpëtimtari mund dhe do
t'i ndihmojë në mënyrën
më të mirë ata që brengosen
dhe ata përreth nesh.*

Zoti mund të mos japë lehtësim derisa ne të zhvillojmë besimin për të bërë zgjedhje që do ta vënë në veprim fuqinë e Shlyerjes në jetën tonë. Ai nuk e kërkon atë nga moskokëçarja, por nga dashuria për ne.

Një udhëzim për të marrë fuqinë shpëtuese të Zotit nga kundërshtia në jetë, iu dha Tomas B. Marshit, në atë kohë President i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve. Ai ishte në sprova të vështira dhe Zoti e dinte se do të përballej me shumë të tjera. Këtu është këshilla që iu dha atij, të cilën



unë e marr për veten time dhe jua ofroj juve: “Ji i përlurur; dhe Zoti, Perëndia yt, do të të udhëheqë përdore dhe do t’u japë përgjigje lutjeve të tua” (Doktrina e Besëlidhje 112:10).

Zoti gjithmonë dëshiron të na çojë drejt shpëtimit nëpërmjet bërjes sonë më të drejtë. Kjo kërkon pendim. Dhe kjo kërkon përlulësi. Pra, udha drejt shpëtimit kërkon gjithmonë përlulësi, me qëllim që Zoti të jetë në gjendje të na udhëheqë përdore atje ku Ai dëshiron të na çojë përmes shqetësimeve tona dhe drejt shenjtërimit.

Sprovat mund të prodhojnë pakënaqësi ose shkurajim. Përlulësia që na nevojitet mua dhe juve, në mënyrë që Zoti të na udhëheqë përdore, vjen nga besimi. Ajo vjen nga besimi se Perëndia me të vërtetë jeton, se Ai na do dhe se ajo që Ai dëshiron – ndonëse mund të jetë e vështirë – do të jetë gjithmonë më e mira për ne.

Shpëtimtari na e tregoi atë përlulësi. Ju keni lexuar se si Ai u lut në Kopshtin e Gjetsemanit ndërkohë që po vuante sprovën në emrin tonë, përtej aftësisë sonë për ta kuptuar ose për ta duruar, apo për mua edhe për ta përshkruar. Ju e mbani mend lutjen e Tij: “O Atë, po të duash, largoje këtë kupë nga unë! Megjithatë mos u bëftë vullneti im, por yti” (Lluka 22:42).

Ai e njihte dhe i mirëbesonte Atit të Tij Qiellor, Elohimin të madh. Ai e dinte se Ati i Tij ishte i gjithëfuqishëm dhe pafundësisht dashamirës. Biri i Dashur kërkoi me fjalë të përlulura – si ato të një fëmije të vogël – që fuqia shpëtuese ta ndihmonte Atë.

Merrni Zemër dhe Ngushëllonuni

Ati nuk e shpëtoi Birin duke ia hequr sprovën. Për hirin tonë Ai nuk e bëri këtë, por Ai e lejoi Shpëtimtarin ta përfundonte misionin që Ai erdhi për të kryer. Megjithatë, ne mund të marrim gjithmonë zemër dhe ngushëllim nga njohuria e ndihmës që Ati siguroi:

“Atëherë iu shfaq një engjëll nga qielli për t’i dhënë forcë.

Dhe ai, duke qenë në agoni, lutej edhe më fort; dhe djersa e tij po i bëhej si gjak i mpiksuar që bie për tokë.

Si u çua pastaj nga lutja, erdhi te dishepujt e vet dhe i gjeti që flinin nga trishtimi,

dhe u tha atyre: Pse po flini? Çohuni dhe lutuni që të mos hyni në tundim” (Lluka 22:43–46).

Shpëtimtari u lut për shpëtim. Ajo që iu dha Atij nuk ishte largim nga sprova, por mjaftueshëm ngushëllim sa ta kalonte atë lavdishëm.

Jezu Krishti e pagoi shpërbletën për të gjitha mëkatet tona dhe ato të të gjithë fëmijëve të Atit Qiellor, në mënyrë që ne të mund të shpëtojmë nga vdekja dhe mëkati.

Urdhri i Tij ndaj dishepujve të Vet, të cilët edhe vetë po provoheshin, është një udhërrëfyes për ne. Ne mund të vendosim ta ndjekim atë. Mund të vendosim që të çohemi dhe të lutemi me besim e përlulësi të madhe. Ne mund ta ndjekim urdhrin e shtuar në librin e Markut: “Çohuni, të shkojmë” (Marku 14:42).

Nga kjo, ju merrni këshillë se si t’i kaloni provat fizike dhe shpirtërore të jetës. Ju do të keni nevojë për ndihmën e Perëndisë pasi të keni bërë gjithçka që mundeni për veten tuaj. Pra, çohuni dhe shkoni, por merreni ndihmën e Tij sa më shpejt që të mundeni, duke mos pritur që kriza të kërkojë shpëtim.

Ju jap dëshminë time solemne se Perëndia, Ati, jeton dhe na do. Unë e di atë. Plani i Tij për ne është i përsosur dhe është një plan lumturie. Jezu Krishti u ringjall, ashtu siç do të ringjallemi ne. Ai vuajti që të mund të na ndihmonte në të gjitha sprovat tona. Ai e pagoi shpërbletën për të gjitha mëkatet tona dhe ato të të gjithë fëmijëve të Atit Qiellor, në mënyrë që ne të shpëtojmë nga vdekja dhe mëkati.

E di se në Kishën e Jezu Krishtit, Fryma e Shenjtë mund të vijë për të na ngushëlluar dhe për të na pastruar kur e ndjekim Mësuesin. Marrshit ngushëllimin dhe ndihmën e Tij në kohët tuaja të nevojës, gjatë gjithë provave dhe sprovave të jetës suaj. ■

Nga një bisedë në një takim shpirtëror, “The Power of Deliverance” [“Fuqia e Shpëtimit”], e mbajtur në Universitetin “Brigam Jang” më 15 janar 2008.

SHËNIM

1. “Drit’, më Drejto”, *Himne*, nr. 50.



DETAIL 'NGA' GIETSEMAN; 'NGA'; KIRK RICHARDS; DEGE ULLIRI PREJ GETTY IMAGES

Në një Kopsht, Vend i Shenjti

Plot mendim ♩ = 60-68

Fjalët dhe muzika nga Tammy Simister Robinson

1. Në një kopsht, vend i she - nji, Hi - ri Yt më shpe - ngo - i.
 2. Tru - pin Tënd me plag' e pash', Sim - bol të Sa - tes dhu - rat'.
 3. Me k'të kup' në buz' kur pi, Vër - tet do tre - goj nde - rim,

N'Gjet - se - man u përgj' - ro - ve, Shpë - tu's, për mua u lu - te.
 Dhe pse vuaj - te për të gjith', Shpë - tu's, për mua vdi - qe Ti.
 Për tru - pin q'o - fro - ve Ti. Për Ty do dë - shmoj ta - ni.

Shpë - tu's, për mua u lu - te. K'të ze - mër t'thy - er me - rre,
 Shpë - tu's, për mua vdi - qe Ti. K'të ze - mër t'thy - er me - rre,
 Për Ty do dë - shmoj ta - ni. K'të ze - mër t'thy - er me - rre,

Një me Të - nden Ti bë - je. N'Gjet - se - man u përgj' - ro - ve,
 Një me Të - nden Ti bë - je. Dhe pse vuaj - te për të gjith',
 Një me Të - nden Ti bë - je. Vuaj - tje mos past' më për Ty,

Shpë - tu's, për mua u lu - te. Shpë - tu's, për mua u lu - te.
 Shpë - tu's, për mua vdi - qe Ti. Shpë - tu's, për mua vdi - qe Ti.
 Shpë - tu's, do je - toj për Ty. Shpë - tu's, do je - toj për Ty.

© 2003 Tammy Simister Robinson. All rights reserved.

Kjo këngë mund të kopjohet për t'u përdorur me raste në Kishë ose në shtëpi, jo për tregti.

Ky shënim duhet të përfshihet në çdo kopje që bëhet.



Nga Brajën K. Ashton,
Këshilltar i Dytë në
Presidencën e Përgjithshme
të Shkollës të së Dielës

Tri Mësime mbi Dashurinë, Gëzimin dhe Paqen

Ndjekja e këtyre tri hapave mund të sjellë një ndryshim të madh në jetën tuaj dhe mund t'ju ndihmojë të ndieni frytet e Shpirtit.

Kur isha student kolegji, mendoja shumë për të ardhmen time. Sapo e nisa të ardhmen – që nënkupton jetën pas kolegjit – mësova tri mësimë vendimtare që sollën një ndryshim të madh në jetën time. Dua t'ia u tregoj këto mësimë juve me shpresën se nuk do t'ju duhet aq kohë sa mua për t'i mësuar. Ato mund t'ju ndihmojnë të gjeni gëzim më të madh në jetë – dhe përfundimisht të merrni ekzaltimin me Atin tuaj Qjellor.

1. Kërkoni Lumturi, Paqe dhe Frymën e Shenjtë

E takova bashkëshorten time, Melindën, gjatë vitit të dytë të kolegjit, rreth gjashtë muaj pasi isha kthyer nga misioni. E kuptova menjëherë se doja të martoheja me Melindën. Megjithatë, Melinda nuk pati të njëjtën përshtypje. Ndodhi vetëm pesë vjet më vonë, që ajo më në fund mori një përgjigje se do të ishte “mirë” nëse martohej me mua.



*Ndërsa bëni
gjëra të vogla
dhe mirëbesoni
në sakrificën e
Jezu Krishtit,
ju mund të
gjeni dashuri,
gëzim dhe paqe
pavarësisht nga
rrethanat tuaja.*

Gjatë atyre pesë viteve, unë pata një nga sprovat më të vështira të jetës sime. E dija se me kë duhej të martohesha dhe Shpirti më nxiti të vazhdoja të përpqesha të martohesha me të, por dukej se nuk po e arrija dot këtë qëllim.

Pak pasi u diplomova, Melinda vendosi të shkonte në mision – pjesërisht, jam i bindur, që të largohej prej meje. Ndërkohë që ajo ishte në mision, kishte raste kur ndihesha i mjeruar sepse u përqendrova tek ajo që nuk kisha. Megjithatë, po i studioja shkrimet e shenjta dhe po lutesha çdo ditë, po shërbeja në Kishë dhe po përpqesha fort të bëja gjërat që sillnin Frymën e Shenjtë në jetën time.

Një mëngjes herët, në një ditë të diele shumë të ftohtë, në Minneapolis, në Minesota të SHBA-së, ndërsa po ngisja makinën për të shkuar në një mbledhje të Kishës, mendova: “Tani duhet të jem me të vërtetë i mjeruar. Asgjë nuk duket se po shkon ashtu si dua. Por nuk jam i mjeruar. Çuditërisht ndihem i lumtur!”

Tani, si mund të isha i lumtur nëse po kaloja nëpër atë që, për mua, ishte një provë e vështirë?

Përgjigjja gjendet te Galatasve 5:22–23: “Fryti i Frymës është: dashuria, gëzimi, paqja, durimi, mirëdashja, mirësia, besimi, zemërbutësia, vetëkontrolli”.

Për shkak se po bëja gjërat që sillnin Shpirtin në jetën time, e ndjeva dashurinë e Perëndisë. Ndjeva gëzim dhe paqe. Mund të vuaja shumë dhe prapëseprapë të isha i lumtur.

Të pasurit e dashurisë, gëzimit dhe paqes në jetën tonë, në familjet tona dhe në martesat tona nuk vjen nga të pasurit e një shtëpie të madhe, e makinave të mira, e veshjeve të fundit, e suksesit në karrierë apo e ndonjë prej gjërave të tjera që

bota thotë se sjellin lumturi. Në fakt, për shkak se ndjenjat e dashurisë, gëzimit dhe paqes vijnë nga Shpirti, të ndjerit e tyre nuk ka pse të lidhet aspak me rrethanat tona të përkohshme.

Ju lutem, kuptojeni që nuk po them se ne gjithmonë do të jemi të lumtur apo që rrethanat tona të përkohshme nuk ndikojnë në kurrë në lumturinë tonë. Në fakt, nëse nuk e shijojmë të hidhurën, nuk mund ta njohim ëmbëlsinë (shih Doktrina e

Besëlidhje 29:39; shih edhe Moisiu 6:55).

Ndonjëherë ne duhet të hasim vështirësi. Për më tepër, disa kushte fizike dhe emocionale mund të na shkaktojnë vuajtje të mëdha dhe ta bëjnë shumë të vështirë që ne ta ndiejmë Shpirtin. Por në qoftë se po përpqemi fort ta kemi Shpirtin në jetën tonë dhe i mirëbesojmë Perëndisë, në përgjithësi, ne mund të jemi të lumtur.

Unë dëshmoj nga përvoja vetjake se kjo është e vërtetë. Që nga [ajo] përvojë ndërkohë që Melinda ishte në mision, kam vënë re që nëse po bëj gjërat që e sjellin Shpirtin në jetën time, përfshirë zgjedhjen për të besuar dhe pranuar se gjërat do të funksionojnë ashtu siç synon Perëndia, unë jam zakonisht i lumtur (shih Jakobi [LiM] 3:2).¹

2. Mos Bini Pre e Ndjenjave të Rreme

Satani ofron alternativa të rreme ndaj gjithçkaje që bën Perëndia, në përpjekje për të na pëshjtelluar e për të na mashtruar. Pavarësisht nga përpjekjet e Satanit për të na bindur për të kundërtën, Shpëtimtari na mëson se “një pemë e prishur [nuk mund] të japë frut të mirë” (3 Nefi 14:18). Për shkak se Satani është një pemë e prishur, ai nuk mund të na bëjë të ndiejmë “dashuri, gëzim, paq[e], durim, mirëdashj[e], mirësi, besim, zemërbutësi [dhe] vetëkontrolli” (Galatasve 5:22–23). Përkundrazi, Satani do që të na bëjë të mjeruar (shih 2 Nefi 2:27).

Pra, çfarë bën Satani? Ai përpqet të na mashtrrojë.

Një shoqja ime, një nga të zgjedhurat, u mashtrua. Shoqja ime shërbeu në një mision dhe ishte një misionare e dalluar. Kur u kthye në shtëpi nga misioni, ajo synonte të bënte të gjitha gjërat e vogla që kishin sjellë

*Satani ofron
alternativa të
rreme ndaj
gjithçkaje që
bën Perëndia,
në një orvatje
për të na
pështjelluar
e mashtruar.
Shpëtimtari
na mëson se
“një pemë
e prishur [nuk
mund] të japë
frut të mirë”*

(3 Nefi 14:18).

Shpirtin në jetën e saj dhe e kishin forcuar në misionin e saj. Dhe për njëfarë kohe, ajo e bëri këtë.

Megjithatë, ajo pa miq, shumë prej të cilëve ishin misionarë të kthyer, që vinin në kishë çdo të diel, por jashtë kishës jetonin ashtu siç jeton bota. Dukeshin të lumtur. Po bënin gjëra “argëtuese”. Dhe mënyra e tyre e jetesës nuk dukej se kërkonte aq punë sa e saja.

Dalëngadalë ajo ndaloi t’i bënte gjërat e vogla që i kishin sjellë forcë shpirtërore në misionin e saj. Ajo prapëseprapë kishte një dëshmi, por më tha se kishte arritur në përfundimin: “Nëse po merrja pjesë në mbledhjet e mia të Kishës, isha në rregull – isha në rrugë të mbarë”. Megjithatë, ajo tha: “Shpirtërisht, unë isha joaktive”². Ndërsa jetonte ashtu siç jeton bota, një zgjedhje e keqe çoi në një tjetër, dhe së shpejti ajo mbeti shtatzënë.

Zgjedhjet e saj të padrejta përfundimisht lanë pasoja. Ajo nuk ishte e lumtur dhe e dinte këtë. Për fat të mirë, shoqja ime e kuptoi se ishte mashtruar dhe u pendua.

Historia e saj thekson që edhe më të mirët prej nesh mund të mashtrohen. Për më tepër, historia e saj vë në dukje se ne duhet të ruhem vazhdimisht nga mashtrimi. Ne e kryejmë këtë duke bërë gjërat e vogla që sjellin Shpirtin në jetën tonë.

Jam i lumtur të raportoj se sot shoqja ime është e lumtur, po përpiket fort t’i mbajë urdhërimet dhe është fizikisht e shpirtërisht aktive në ungjill.

Mashtrimet e Satanit vijnë në shumë mënyra. Do të përmend vetëm disa.

Satani përpiket të na bindë që t’i japim përparësi gjërave të përkohshme më shumë se gjërave shpirtërore. Ne mund ta kuptojmë nëse përparësitë tona nuk janë në drejtimin e duhur duke vënë re se sa shpesh themi: “Jam shumë i zënë

ose shumë i lodhur tani _____”. Plotësojini vendet bosh: për të frekuentuar tempullin, për të dhënë shërbesë, për t’i studiuar dhe përsiatuar shkrimet e shenjta, për ta plotësuar thirrjen time ose madje për t’i bërë lutjet e mia.

Një arsye që ne ndihemi kaq të zënë me punë është se Satani punon shumë për të na shpërqendruar. Ai përdor telefonin inteligjent në dorën tonë, radion në makinën tonë, televizorët në shtëpinë tonë dhe një mori gjërash të tjera për të na mbajtur të shpërqendruar pothuajse gjatë gjithë kohës. Si rrjedhojë, ne ndihemi më të zënë sesa jemi në fakt.

Një rrjedhojë tjetër e këtij shpërqendrimi është se ne po përsiatim gjithnjë e më pak. Satani punon për të na shpërqendruar sepse ai e di që të

përsiaturit, veçanërisht i shkrimeve të shenjta, çon në një kthim më të madh në besim dhe në një zbulësë më të madhe.

Një mashtrim tjetër i Satanit vjen nëpërmjet idesë se veprimet tona të jashtme kanë më shumë rëndësi sesa shtysat tona të brendshme. Kur na mungon shtysa e duhur për të bërë gjëra shpirtërore, ne nuk arrijmë ta përjetojmë gëzimin e ungjillit. Si rrjedhojë, zbatimi i urdhërimeve fillon të ndihet si angari, dhe Satani e di që, nëse ai arrin të na bëjë të ndihemi kështu, ka të ngjarë të mos e bëjmë atë që e dimë se duhet ta bëjmë.

Satani gjithashtu na mashtron duke na bërë të besojmë se gëzimi dhe lumturia vijnë nga të pasurit e një jete të lehtë ose thjesht nga zbatimja gjatë gjithë kohës. Ato nuk vijnë kështu. E vërteta është se nuk ka gëzim apo lumturi pa u mposhtur diçka (shih 2 Nefi 2:11, 23).

Mashtrimi i fundit i Satanit që unë do të përmend, është se ai përpiket të na bindë se ligësia, me kënaqësitë e saj të përkohshme, në të vërtetë është lumturi. Satani e di që, të paktën në çast, disa ndjenja ose emocione mund 1) të na bëjnë të mendojmë se po i ndiejmë frytet e Shpirtit, 2) ta errësojnë



dëshirën tonë për ato fryte ose 3) të ndiejmë sikur janë zëvendësuese të pranueshme.

Për shembull, Satani mund të na tundojë të kërkojmë epsh në vend të dashurisë. Ai mund të na joshë me ngazëllim në vend të një gëzimi të qëndrueshëm. Ai përpiqet të na shpërqendrojë në vend që të na japë paqe. Ai do të na bëjë të vetëkënaqur, të zellshëm dhe politikisht të saktë, në vend që të jemi vetëmohues, vazhdimisht të bindur dhe të përqendruar shpirtërisht siç duhet. Tundimet e tij mund të na bëjnë që të jemi të pëshjtjelluar, gjë e cila më vonë na çon drejt mendimit se shkelja e urdhërimeve do të sjellë lumturi.

3. Bëni Gjërat e Vogla

Zakonisht janë gjëra të vogla që sjellin Shpirtin në jetën tonë, nuk na lënë të mashtrohemi dhe përfundimisht na ndihmojnë që të marrim forcën për t'i zbatuar urdhërimet dhe për të fituar jetën e përjetshme. Shpëtimtari ua mësoi këtë parim pleqve të Kishës në Kirtland të Ohajos: "Prandaj, mos u lodhni së bëri mirë, sepse ju po ngrini themelin e një vepre të madhe. Dhe nga gjëra të vogla vjen ajo që është e madhe" (Doktrina e Besëlidhje 64:33).

Përse janë gjërat e vogla kaq të rëndësishme? Në vargun e mëposhtëm, Shpëtimtari shpjegoi se "Zoti kërkon zemrën dhe një mendje të gatshme" (Doktrina e Besëlidhje 64:34). Përse e lidhi Shpëtimtari bërjen e gjërave të vogla me zemrën dhe një mendje të gatshme? Sepse duke bërë në vazhdimësi gjëra të vogla, ne ia japim zemrën dhe mendjen tonë Perëndisë, i cili na pastron dhe na shenjtëron (shih Helamani 3:35).

Ky pastrim dhe shenjtërim ndryshon vetë natyrën tonë, pak nga pak, që të bëhemi gjithnjë

e më shumë si Shpëtimtari. Kjo gjithashtu na bën që të jemi më pranues ndaj nxitjeve të Frymës së Shenjtë, të cilat na bëjnë të kemi më pak gjasa për t'u mashtruar.

Në vitin e fundit të shkollës së mesme, babai im më bëri seminar në shtëpi. Për shkak se tema atë vit ishte Librit i Mormonit, babai vendosi që ta lexonim së bashku, varg pas vargu dhe të diskutonim për atë që mësonim. Teksa lexonim, babai do të bënte pyetje që më bënin të mendohej rreth asaj që po lexonim dhe ai do të shpjegonte gjëra që nuk i kuptoja. Ende më kujtohet kur mësova për Shpëtimtarin dhe kuptova se Ai me të vërtetë i vizitoi nefitët dhe se unë me të vërtetë mund të falesha për mëkatet e mia për shkak të Shlyerjes së Tij.

Themelin tim te shkrimet e shenjta e formova në ato sesione që unë dhe babai bëme së bashku. Ndërsa lexonim, ndjeva diçka. Dhe ndoshta më e rëndësishmja, dëshirat, shtysat dhe veprimet e mia ndryshuan. Dëshiroja të isha më i mirë. Fillova të shihja se ku isha duke u mashtruar. Pendohesha më shpesh. Deri në fund të vitit të parë të kolegjit tim, unë i lexoja shkrimet e shenjta çdo ditë.

Rreth kësaj kohe, Presidenti Ezra Taft Benson (1899–1994), u kërkoi anëtarëve të Kishës ta lexonin Librin e Mormonit çdo ditë dhe ta zbatonin atë që mësonin.³ Pra, përveç gjërave të tjera që lexoja, të paktën lexoja diçka nga Libri i Mormonit.

Në misionin tim kam mësuar se si t'i studioj vërtet shkrimet e shenjta dhe të ushqehem me bollëk me to. Jo vetëm që e ndieja Frymën e Shenjtë teksa lexoja, por gjithashtu fillova të ndieja gëzim ndërsa i hulumtoja shkrimet e shenjta për të



*Ju premtoj
që në qoftë se
ju do të
ushqeheni me
bollëk me
shkrimet e
shenjta çdo
ditë, veçanërisht
Librin e
Mormonit,
ju do ta ftoni
Shpirtin në
jetën tuaj.*

gjetur përgjigje për problemet e mia dhe ato të kërkuesve të mi.

Pas misionit, vazhdova të ushqehesha me bollëk me shkrimet e shenjta çdo ditë. Për shkak se kjo praktikë e ftoi Frymën e Shenjtë në jetën time, mora udhëzimin e Tij për të më ndihmuar që ta shfrytëzoja kohën në mënyrë më të efektshme. Si rrjedhojë, isha më mirë në shkollë dhe, më vonë, në punë. U bë më e lehtë për të marrë vendime të mira. Lutesha më shumë dhe isha më i zellshëm në përmbushjen e thirrjeve të mia. Të ushqyerit me bollëk me shkrimet e shenjta çdo ditë nuk i zgjidhi të gjitha problemet e mia, por jeta ishte më e lehtë.

Në gusht 2005, Presidenti Gordon B. Hinckli (1910–2008) dha një sfidë për ta lexuar ose rilexuar Librin e Mormonit para fundit të vitit.⁴ Meqë po lexoja çdo ditë nga Libri i Mormonit, unë isha tashmë tek Ethëri ose Moroni. Rrjedhimisht, pasi e mbarova pas një apo dy javësh, arrita në përfundimin se e kisha përmbushur sfidën e Presidentit Hinckli.

Por pastaj një mësues besnik erdhi në shtëpi për të vizituar familjen tonë. Ai më pyeti se çfarë po bëja me ftesën e Presidentit Hinckli.

I thashë se pata fatin e mirë që e kisha filluar Librin e Mormonit përpara sfidës së Presidentit Hinckli. Pastaj, me një lloj vetëkënaqësie, e njoftova se e kisha përmbushur detyrën.

Për fat të mirë, mësuesi im i shtëpisë i pa gjërat ndryshe. Ndërsa më korrigjoi butësisht, Shpirti më pëshpëriti se mësuesi im i shtëpisë kishte të drejtë.

Tani më duhej të lexoja dy kapituj në ditë për ta përfunduar sërish deri në fund të vitit. Ndërsa e shtova sasinë e asaj që lexoja në Librin

e Mormonit, vura re që edhe më shumë fuqi erdhi në jetën time. Kisha më shumë gëzim. I shihja gjërat më qartë. Pendohesha edhe më shpesh. Doja të jepja shërbesë dhe të shpëtoja të tjerët. Isha më pak i prekshëm nga mashtrimet dhe tundimet e Satanit. E desha më shumë Shpëtimtarin.

Atë nëntor, unë u thirra të isha peshkopi i lagjes sonë. Përmbushja e sfidës së Presidentit Hinckli më përgatiti për atë thirrje. Që prej asaj kohe, kam vërejtur se sa më i zënë të jem në punë apo në kishë, aq më shumë duhet t'i studioj shkrimet e shenjta, veçanërisht Librin e Mormonit.

Ju mund të keni të njëjtat bekime dhe fuqi në jetën tuaj, në qoftë se edhe ju do të ushqeheni me bollëk me shkrimet e shenjta çdo ditë. Ju premtoj që në qoftë

se ju do të ushqeheni me bollëk me shkrimet e shenjta çdo ditë, veçanërisht me Librin e Mormonit, ju do ta ftoni Shpirtin në jetën tuaj dhe do të luteni natyrshëm çdo ditë, do të pendoheni më shpesh dhe do ta keni më të lehtë ta frekuentoni kishën dhe të merrni pjesë në sakrament çdo javë.

Dëshmoj që teksa i bëni gjërat e vogla dhe i mirëbesoni Zotit, ju mund të gjeni dashuri, gëzim, paqe dhe lumturi pavarësisht nga rrethanat tuaja. Gjithashtu dëshmoj se kjo është bërë e mundur për shkak të sakrificës së Jezu Krishtit. Të gjitha gjërat e mira vijnë për shkak të Tij (shih Moroni 7:22, 24). ■

Nga një fjalim në një takim shpirtëror, "Happiness, Deceit, and Small Things" ["Lumturia, Mashtrimi dhe Gjëra të Vogla"], dhënë në Universitetin "Brigham Jang", më 15 dhjetor 2017.

SHËNIME

1. Kur jemi të vendosur në besimin në Krisht, ne mund të ushqehemi me bollëk me dashurinë e Perëndisë pavarësisht nga rrethanat tona.
2. Shënimet dhe skenari i intervistës janë në pronësi të autorit.
3. Shih Ezra Taft Benson, "A Sacred

- Responsibility", *Ensign*, maj 1986, f. 77–78; shih edhe "The Book of Mormon – Keystone of Our Religion", *Ensign*, nëntor 1986, f. 4–7.
4. Shih Gordon B. Hinckley, "First Presidency Message: A Testimony Vibrant and True", *Ensign*, gusht 2005, f. 2–6.

As Uragani Nuk Mund të na Ndalte

Pak pasi u ktheva nga misioni, mora një ftesë për të shkuar në një vallëzim. Gjatë kërcimit, e humba telefonin dhe një i ri ofroi të më ndihmonte që ta gjeja. Teksa biseduam, zbuluam se që të dy ishim misionarë të kthyer dhe kishim shumë ide dhe synime.

Marrëdhënia jonë vazhdoi të zhvillohej dhe ne u fejuam. Ishte ëndrra jonë që të vuloseshim në Tempullin e Uashington D.K.-së para se të mbyllej për rimodelim në mars të vitit 2018. Por pasi e morëm atë vendim, ne u vumë në provë. Së pari, humba punën dhe nuk kisha mënyrë për të kursyer para për udhëtimin tonë për në tempull. Pastaj, një uragan po vinte për të goditur Porto-Rikon pak para datës sonë të dasmës.

Kur uragani Maria goditi, ai e shkatërroi ishullin tonë të bukur. Dyqanet u mbyllën. Ishim pa energji elektrike; uji, ushqimi dhe sende të tjera bazë

u bënë të vështira për t'u gjetur. Ne humbëm gjithçka që kishim planifikuar të përdornim në pritjen tonë. Na u desh ta anulonim pritjen dhe dukej se do të duhej ta anulonim edhe dasmën tonë. Udhëtimi brenda dhe jashtë Porto-Rikos ishte i kufizuar dhe askush nuk e dinte se për sa kohë. Fillova të ndihem e shkurajuar dhe u mbusha me dyshime e pështjellim.

Një natë, unë dhe i fejuari im folëm për gjendjen tonë. Udhëtimi ishte i pasigurt dhe ne nuk do të kishim as pritje as veshje dasme, por Shpirti na pohoi se duhej t'i mirëbesonim Zotit. Gjëja më e rëndësishme ishte të vuloseshim në tempull. Iu lutëm Atit Qjellor për ndihmë.

Pasi rifilluan fluturimet me avion nga Porto-Riko, na u desh të bënim plane të reja për fluturimin dhe të ndryshonim datën tonë të vulosjes. Ishim pa komunikim për javë të tëra

pas uraganit, por telefoni i një shoqeje funksiononte. Ajo na la ta përdornim atë për t'u lidhur me tempullin. Ne mundëm të riorganizonim gjithçka, që prapë të mund të vuloseshim! Pak javë përpara udhëtimit tonë, pjesëtarët e familjes dhe miqtë dhuruan këpucë dhe veshje, dhe na ndihmuan të merrnim shumë gjëra për dasmën tonë.

Kur më në fund hymë në tempull, ne i lamë të gjitha shqetësimet tona prapa. U kapëm për dore për të hyrë së bashku në të ardhmen tonë. Me të vërtetë mund të them se e ndjeva dorën e Zotit të na udhëzonte dhe të na siguronte sërish se, për aq kohë sa ne i mirëbesonim Atij, gjithçka do të shkonte mirë. Sot ne jemi bekuar me një djalë të hijshëm dhe jemi një familje e vulosur për gjithë përjetësinë. ■

Koraima Santiago de Jezus, San Huan, Porto-Riko

Pas uraganit Maria, u duk sikur do të na duhej ta anulonim dasmën tonë.





“Kjo Është!”

Një natë dimri mbërrita vonë në shtëpi, pas kryerjes së shumë intervistave si peshkop. Isha i sflitur. Puna kishte qenë stresuese për disa javë dhe familja dhe përgjegjësitë në Kishë më bënin të ndihesha i tendosur përtej kufijve të mi.

Atë mbrëmje, m'u desh të rregulloja makinën që të mund të shkoja në punë të nesërmen. Ndërsa vështa kominoshet, ndryshova rolet nga peshkop në mekanik. U shtriva në dyshemenë e ftohtë të garazhit nën makinë dhe fillova të punoja. Pse duhet të ngrija së ftohti, të isha i raskapitur dhe të vrisja kyçet e gishtave, pasi kisha punuar tashmë aq shumë atë ditë? Po humbisja durimin dhe fillova një lutje ankuese, përgjëruese ndaj Atit Qjellor.

“A është e mundur që Ti të më ndihmosh pak?” thashë unë. “Po jap më të mirën time për të qenë një baba, bashkëshort dhe peshkop i mirë dhe t’i jetoj urdhërimet. A nuk do të shërbeja më mirë po të mund të çlodhesha pak? Të

lutem, më ndihmo ta mbaroj këtë, që të mund të shkoj në shtrat.”

Papritmas, tri fjalë të qarta dhe të dallueshme erdhën guximshëm në mendjen time: “Kjo është!”

“Çfarë?” iu përgjigja.

Fjalët erdhën sërish: “Kjo është!”

Mendja dhe zemra ime filluan të mbusheshin me kuptim, kur fjalët erdhën për të tretën herë: “Kjo është!” Këto fjalë mbartnin një mesazh për shpirtin tim. “Kjo” ishte jeta në vdekshmëri, dhe unë po përjetoja një çast rritjeje, e caktuar për të më ndihmuar të bëhem çka Ati Qjellor dëshiron që unë të bëhem. Ishte sikur Shpirti të më thoshte: “A prisje që ky udhëtim tokësor të mos kishte vëshirësi?” Kur u ngrita nga ajo dyshe-me e ftohtë çimentoje, nuk isha më njësoj.

Në varësi të mënyrës se si u përgjigjemi sprovave, ato mund të shihen si dhurata nga një Atë i dashur në Qjell. Ai na jep mundësinë të përballemi

Isha duke punuar në makinën time kur një mesazh i qartë erdhi fuqishëm në mendjen time.

me sprova, që të mund të mësojmë t’i drejtohem Atij. Kur e bëjmë këtë, ne bekohemi me rritje nga pikëpamja e të nxëniet dhe ajo shpirtërore.

Dy fjalët që erdhën në mendjen time gjatë asaj nate të ftohtë në dyshemenë prej çimentoje të garazhit tim, më kanë bekuar për më shumë se 35 vjet. Përpiqem shumë që të shoh se asnjë sprovë nuk shkon kot. I shoh sprovat si mundësi për të mësuar gjëra që mund të mos i mësoj kurrë në ndonjë mënyrë tjetër. ■

Riçard J. Anderson, Jeta, SHBA

Ta Shikoja Babanë Duke Kënduar

Kisha qenë në misionin tim në Honolulu, Havai në SHBA, për vetëm katër muaj e gjysmë, kur pata një krizë të rëndë dhe më pas u diagnostikova me epilepsi. Muajt pasues sollën vizita në spital, analiza të panumërta dhe një ilaç të ri me efekte acaruese anësore.

Deri atëherë, kisha qenë aq e përqendruar në punën misionare, sa që nuk kisha përjetuar shumë mall për shtëpinë, por që nga çasti i krizës, më dhembte zemra. Më merrte malli për prindërit dhe ndihesha e vetmuar edhe pse isha e rrethuar nga njerëz të mrekullueshëm dhe plot përkujdesje. Nuk doja të shkoja në shtëpi, por doja të ndieja paqe.

Me lejen e presidentit të misionit, fola me prindërit e mi në telefon për ilaçet e mia. Babai im, i cili sapo kishte përbushur ëndrrën e tij të jetës për t'u

bashkuar me Korin e Tabernakullit në Sheshin e Tempullit, më siguroi se do të këndonte me gjithë zemër për mua në konferencën e përgjithshme, e cila fillonte të nesërmen.

Mëngjesin pasues, u luta me zell për paqen që më nevojitej kaq shumë. Kisha marrë përgjigje për pyetje specifike gjatë konferencës së përgjithshme më parë dhe besoja se mund të merrja përsëri udhërrëfim. Kur konferenca u hap, kori këndoi "F'mij' të Dashur, Pran' Ësht' Zoti" (*Himne*, nr. 49). Brenda minutës së parë, e pashë babanë tim në ekranin e televizorit. Kamera u përqendrua në fytyrën e tij për një kohë të gjatë.

Më dolën lot nga sytë teksa një ndjenjë e pamasë paqeje më pushtoi të tërën. E dija që Perëndia më donte. Ai e dinte saktësisht se për çfarë kisha

nevojë atë ditë – një siguri e thjeshtë se Ai ishte pranë dhe ishte në dijeni për mua. Ndjeva dashurinë e Perëndisë, dhe gjithashtu, dashurinë e familjes sime, të shoqeve të mia dhe të presidentit tim të misionit. Në vend që të ndihesha e munduar, tani pashë një mundësi për t'u afruar më shumë me Zotin.

Sfidat e mia shëndetësore nuk u zhdukën. Mbi të gjitha, m'u desh të largohesha nga misioni më herët, por e dija se Perëndia ishte atje dhe se Ai më donte. Kjo siguri më ka shoqëruar përmes shumë sprovave të tjera dhe më ka dhënë shpresë në orët e mia më të errëta. Të tjerë mund ta quajnë rastësi, por unë e di se duke e parë babanë tim të këndojë rreth dashurisë së Perëndisë, ishte një mrekulli e vogël në kohën time të nevojës. ■

Maria Oka, Kaliforni, SHBA



Më dolën lot kur e pashë babanë tim në ekranin e televizorit.

Një Ftesë për Rikardon


Kur dëgjoj për një veprimtari në Kishë, gjithmonë ftoj 10 njerëz që nuk janë anëtarë të Kishës që të marrin pjesë. E kam bërë këtë për vite me radhë. Bëj ftesa dhe e vendos secilën në një zarf të bardhë dhe lutem që Shpirti të më udhërrëfjë. Pastaj i dorëzoj ftesat. Rrallëherë ndodh që të 10 personat të marrin pjesë, por edhe nëse vetëm një merr pjesë, mendoj se kam qenë i suksesshëm.

Disa vite më parë, unë përgatita dhjetë ftesa për një mbrëmje rreth vatrës për çiftet e martuara. Ia dhashë ftesat nëntë njerëzve në punën time dhe më kishte ngelur edhe një. Nuk dija se kujt t'ia jepja. Disa minuta më vonë, Rikardo, një përfaqësues shitjesh, kaloi nga tryeza ime. U ndjeva i nxitur ta ftoja, edhe pse ai e kishte refuzuar një ftesë nga një koleg tjetër për të marrë pjesë në një ngjarje në kishën e tij. Nuk mendoja se Rikardo do të ishte i interesuar.

Por kur Rikardo kaloi përsëri nga tryeza ime, unë e ndjeva përsëri nxitjen. Megjithatë, ai u largua kaq shpejt sa që nuk kisha mundësi të flisja me të. U luta që Rikardo të kthehej nëse ishte e thënë që t'ia jepja ftesën.

Pasi kisha mbaruar së luturi, Rikardo u kthye për të më bërë një pyetje. Më pas, i thashë: “Rikardo, kisha ime ka një veprimtari për çiftet e martuara. Do të tregojmë përvoja se si të jetojmë të lumtur çdo ditë. Më pas do të ketë vallëzim. Nëse të ftoj, a do të vish?”

“Patjetër që po”, tha Rikardo, por përgjigjja e tij nuk më bindi.



Ia dhashë ftesat nëntë njerëzve në punën time dhe më kishte ngelur edhe një. Nuk dija se kujt t'ia jepja.

“Të paktën bëra pjesën time”, mendoja.

Unë dhe bashkëshortja ime mbërritëm në aktivitet më herët për të përshëndetur njerëzit teksa vinin. Papritmas pashë Rikardon me bashkëshorten e tij, Rexhinën. I njoha me bashkëshorten time dhe të tjerët që po merrnin pjesë. Gjatë gjithë mbrëmjes, Rikardo dhe Rexhina dukeshin sikur po kënaqeshin. U befasova kur thanë se do të vinin në kishë të dielën për të mësuar më shumë.

Rikardo, Rexhina dhe dy fëmijët e

tyre mësuan më shumë. Përfundimisht, ata u bashkuan me Kishën. Më vonë, ata u vulosën në tempull. Rikardo një herë më tha se ai dhe gruaja e tij kishin folur për një shkurorezim, por më pas Zoti e drejtoi Rikardon për në zyrën time.

Që prej asaj kohe unë i kam kërkuar Zotit të më falë që mendoja se Rikardo nuk do ta pranonte ftesën time. Kam mësuar se është e rëndësishme që t'i ftojme të gjithë. Ju kurrë nuk e dini se kush do të pranojë. ■

Martin Apolo Kordova, Paranja, Brazil

Biznesi po Lulëzon

Nga Xhoshua J. Perki

Revistat e Kishës

Falë asaj që mësoi në klasat e mbështetjes te vetja, kur një derë u mbyll për Tedi Rejesin, një tjetër shpejt u hap.

Është ora 04:00 në Santo Domingo, në Republikën Domenikane, dhe Tedi Rejesi është ngritur tashmë e po punon. Ai ka shumë punë për të bërë sot për ta mbajtur biznesin e tij të suksesshëm. Ai fillon të presë në feta domatet dhe bukën. Pastaj bën salcën e tij të veçantë.

Nga ora 06:00, dy punonjës vijnë për ta ndihmuar dhe përgatitjet përshejtohen. Deri në orën 08:00, kanë bërë 300 sanduiçe, mbështjellë secila me plastikë dhe futur në çanta. Gjashtë punonjës të tjerë shfaqen dhe i gjithë grupi shkon për t'i shitur.

Deri në orën 09:00, të gjitha sanduiçet përveç disave – tre ose katër që Tedi i ruajti për të ushqyer grupin e tij – janë shitur.

Biznesi po shkon mirë për Tedin. Por gjërat nuk kanë qenë gjithnjë të lehta. Në fakt, pesë vitet e fundit, ai nuk ka mundur të gjejë punë të qëndrueshme në profesionin e tij të zgjedhur – si avokat.

Pra, si e bëri Tedi kalimin nga këshillimi për klientët te shitja e sanduiçeve? Natyrisht, kërkoi shumë punë, por gjithashtu kërkoi një zbatim të kujdesshëm të parimeve që i mësoi në klasat e



ofruara nëpërmjet nismës së Shërbimeve të Mbështetjes te Vetja të Kishës.

Humbja e Punës së Tij

Pesë vjet më parë, jeta për Tedin dukej e mahnitshme. Ai kishte një punë të mirë si avokat, sapo ishte martuar dhe kishte pagëzuar bashkëshorten e tij. “Por patëm disa sfida”, thotë ai, “dhe e humba punën”.

Gjatë katër viteve pasuese, Tedi luftoi për të gjetur punë. “Mund të bëja shumë punë, por askush nuk donte të më paguante. U përpoqa të nisja vetë punë të ndryshme, por nuk funksionoi.”

Bashkëshortja e tij, Stefanija, kishte një punë të mirë, por vetëm paga e saj nuk mund t’i përballonte faturat. Shpejt çifti pati një fëmijë. Ata ishin të kënaqur, por financat e tyre u shtrënguan edhe më shumë. Ata e humbën shtëpinë e tyre, iu desh të shisnin makinën dhe t’i shfrytëzonin të gjitha kursimet e tyre. Përfundimisht atyre iu desh të zhvendoseshin në një shtëpi të vogël që zotërohej nga nëna e Stefanisë.

Por Tedi nuk u dorëzua. Shpejt iu paraqit një mundësi e papritur.

Fuqia e Mbështetjes te Vetja

Pas vitesh mundimi, Tedi e dinte se ishte koha për një ndryshim.

“Vendosa të bëja kurset e mbështetjes te vetja të Kishës”, thotë ai. “Kisha dëgjuar për to, por gjithmonë mendoja se nuk ishin për mua. Mendoja se ishin thjesht për t’i bërë gjërat individualisht. Klasat ishin të mrekullueshme.”

Së pari, Tedi iu bashkua grupit “Financat Vetjake”. Pastaj iu bashkua grupit “Nisja dhe Rritja e Biznesit Tim”. Klasat e grupit e ndihmuan Tedin për njohuritë e tij për biznes, por gjithashtu e ndihmuan që të zhvillohej shpirtërisht.

“Bërja e këtyre klasave ndryshoi gjithçka”, thotë ai. “Vendosa të bëja gjithçka që më mësonin. Dhe financat e mia ndryshuan menjëherë. Fillova të paguaja një të dhjetë të plotë, të lutesha çdo ditë, t’i studioja shkrimet e shenjta dhe të ushtrroja besim. Dhe gjërat ndryshuan – fillova të kurseja para dhe ta mbajta ditën e Shabatit të shenjtë. Çdo parim më bekoj.”

Në grupin e tij “Nisja dhe Rritja e Biznesit Tim”, Tedi mësoi se si të përcaktonte një produkt potencial që mund të ishte i dobishëm për klientët në vendin ku ai jetonte. Teksa përcaktoi se çfarë kërkonin njerëzit, frymëzimi filloi të vërshonte. Në zonën e tij, njerëzit i pëlqenin sanduiçet e freskëta, por gjithashtu u pëlqente që t’i porositnin – dhe t’ua çonin.

“Shumë restorante kanë një salcë të veçantë që e bën ushqimin e tyre të dallohet”, thotë Tedi. “Kështu që krijova salcën time të veçantë për sanduiçin!”

Rritja e Biznesit të Tij

Ditën kur e nisi biznesin e tij, Tedi bëri 30 sanduiçe.

“Tridhjetë minuta më vonë, u ktheva në shtëpi”, thotë ai. “Bashkëshortja ime u shqetësua kur më gjeti në divan. Ajo më pyeti se çfarë po bëja tashmë

në shtëpi – a nuk duhej të isha duke shitur sanduiçe? Tashmë i kisha shitur të gjitha!”

Gjatë javëve të ardhshme, Tedi kontaktoi me bizneset e zonës dhe shkollat. Shumë prej tyre mezi prisnin t’i blinin sanduiçet e tij, dhe biznesi i tij filloi të rritet. Shpejt mësoi se si të kujdesej për perimet e freskëta në mënyrë që ato të qëndronin më gjatë të freskëta. Ai gjithashtu e di saktësisht se sa kohë mban salca e tij e veçantë. Ai e porosit dhe e merr bukën çdo mbrëmje. Ai blen perime me çmime të ulura të shtunave, të cilat kushtojnë më pak, por do të jenë ende të mira të hënën.

Shpejt ai po merrte porosi për lloje të veçanta sanduiçesh, madje edhe në numër të madh për raste të veçanta. Ai kishte nevojë për ndihmë dhe filloi të punësonte njerëz.

Duke krijuar marrëdhënie pozitive me shkollat dhe bizneset e zonës, Tedi krijoi një klientelë aktive dhe të vazhdueshme. Brenda katër muajsh, ai kishte tetë punonjës dhe shiste 300 sanduiçe në ditë, pesë ditë në javë. Grupi i tij i shitjes ishte kaq i efektshëm sa që ata shisnin çdo sanduiç edhe gjatë verës kur shkollat ishin të mbyllura. Tani Tedi është gati të zgjerohet përsëri.

Për shkak se bëri klasat e mbështetjes te vetja, ai u frymëzua të vinte me idenë e biznesit të sanduiçeve. “Për shkak të këtij udhërrëfimi nga Kisha dhe të bekimeve që kam marrë”, thotë ai, “unë kam një dëshmi shumë të fortë për Kishën dhe Jezu Krishtin”. ■



Djali Ynë Është Bir i Atit Qiellor

Nga Xherlin Mërfi

Djali ynë i dashur, Hejdeni, erdhi në këtë botë me ngjyrë blu, duke mos marrë frymë dhe duke luftuar për jetën. Nuk qante. Nuk lëvizte.

Ndërsa mjekët dhe infermieret nxituan përreth dhomës së spitalit, e dija se diçka po shkonte tmerrsisht keq. Bashkëshorti im dhe babai im i dhanë me të shpejtë një bekim priftërie Hejdenit, dhe Hejdeni u çua me shpejtësi në kujdesin intensiv. Ai shpejt u diagnostikua me një keqfunksionim të rrallë të zemrës. Brenda disa ditësh iu nënshtrua disa operacioneve të zemrës.

Nëpërmjet fuqisë mrekullibërëse të bekimeve të priftërisë, agjërimit dhe lutjeve, Hejdeni i kaloi të gjitha pritshmëritë dhe mbijetoi. Ne ishim tepër të gëzuar që ta sillnim djalin tonë në shtëpi dhe të fillonim së bashku jetën tonë të re.

Hejdeni solli gëzim të pafund në jetën tonë. E donim fort dhe e adhuronim. Por me kalimin e kohës, fillova të shqetësohem se ai nuk po përparonte siç pritej. Megjithëse specialistët na siguruan se përfundimisht ai do të zhvillohej, ankthet shqetësuese vazhduan teksa luftoja për ta ndihmuar tim bir.

Unë dhe bashkëshorti im studiuam për të mësuar gjithçka që mundeshim për sëmundjen e Hejdenit. Bëmë gjithçka që mjekët na thanë të bënim. Prapëseprapë nuk po përparonte.

Fillova të lodhesha dhe të acarohesha. Iu përgjérova Atit tim në Qiell që të më ndihmonte të gjeja dikë që mund ta ndihmonte Hejdenin, por nuk gjeta asnjë ndihmë. Gjendja e Hejdenit u përkeqësua. Ai filloi të kishte

kriza. Ishim të frikësuar. Menduam se po e humbnim.

Një natë, isha zgjuar deri natën vonë në kërkim të përgjigjeve. I shkrova një letër Hejdenit. I tregova se sa shumë e doja dhe sa shumë po përpiqesha që ta bëja jetën e tij më të lehtë. I premtova se do ta kaloja pjesën tjetër të jetës sime duke u përpjekur që t'i jepja ndihmën që i nevojitej.

Acarimi dhe pasiguria momentalisht më mposhtën. U gjunjëzoja dhe e pyeta Atin tim në Qjell: "Pse?" Mendova se Ai e kishte dërguar Hejdenin tek unë, ngaqë Ai e dinte se unë kurrë nuk do të hiqja dorë nga përpjekja për ta ndihmuar tim bir. Pra, përse nuk mund të gjeja ndonjë përgjigje? Pse çdo mjek i ri dhe çdo trajtim i ri çonin drejt një pengese tjetër? A nuk e donte Ati Qjellor Hejdenin?

Nuk do ta harroj kurrë atë çast. Papritmas më rrethoi një ndjenjë drithëruese dashurie. Fjalë që nuk ishin të miat hynë në mendjen time: 'Xherlin, a mendon se e do atë më shumë sesa e dua unë?'

Ngriva. Koha ndaloj. Lotët rrodhën në fytyrë – jo nga acarimi si më parë, por nga shpresa, mirëkuptimi dhe dashuria.

Në atë çast, gjithçka ndryshoi. Zemra ime u zbut. Pyetjet e mia ndryshuan. Tani e kuptoj se Ati im në Qjell e do Hejdenin me një dashuri të përsosur. Hejdeni u dërgua këtu në një trup që

është i përshtatshëm për nevojat e tij dhe mundësitë e tij për rritje dhe mësim. Ai ka grupin e vet unik të aftësive dhe sfidave, ashtu si secili prej nesh. Kam arritur të kuptoj se fëmijët me aftësi të kufizuar janë fëmijë të çmuar dhe të dashur për Atin Qjellor, të cilët kanë një mision të veçantë këtu në këtë tokë.

Unë dhe bashkëshorti im vazhdimisht marrim përgjigje dhe bekime, por ato vijnë në kohën e Zotit, jo në kohën tonë. Jemi drejtuar për te librat, terapitë, shkollat dhe mësuesit e duhur për ta ndihmuar Hejdenin që t'ia dalë mbanë në jetën e tij në vdekshmëri. Ne përpiqemi fort të kërkojmë shtegun që Ati ynë në Qjell ka caktuar për Hejdenin, në vend të shtegut që ne donim që ai të merrte. Ne po bëjmë gjithçka që mundemi për ta ndihmuar Hejdenin të arrijë potencialin e tij hyjnor dhe të jetojë jetën që Ati i tij Qjellor ka caktuar për të. Të kuptuarit nga ana jonë e planit të Atit Qjellor ka qenë shumë më i qartë tani që ne e kuptojmë se Hejdeni ishte i Tiji përpara se Hejdeni të ishte yni. ■

Autorja jeton në Arizonë, SHBA.

Fjalë që nuk ishin të miat hynë në mendjen time: "A mendon se e do atë më shumë sesa e dua unë?"



TRUPI: NJË DHURATË E PAÇMUESHME

"Për arsye zakonisht të panjohura, disa njerëz lindin me kufizime fizike. Pjesë të caktuara të trupit mund të mos jenë normale. Sistemet biologjike mund të mos funksionojnë siç duhet. Dhe të gjithë trupat tanë mund të sëmuren dhe do të vdesin. Prapëseprapë, dhurata e një trupi fizik është e paçmueshme. Pa të, ne nuk mund të marrim plotësi gëzimi.

Nuk është e detyrueshme të kemi trupa të përsosur që të arrijmë një fat hyjnor. Në fakt, disa nga shpirtat më të ëmbël strehohen në trupa të brishtë. Shpesh, nga njerëzit me sfida fizike zhvillohet forcë e madhe shpirtërore, pikërisht ngaqë ata janë të sfiduar. Individë të tillë kanë të drejtë për të gjitha bekimet që Perëndia ka në ruajtje për fëmijët e Tij besnikë dhe të bindur." ■

Presidenti Rasëll M. Nelson, "We Are Children of God", *Ensign*, nëntor 1998, f. 86-87.

Përballja me Tragjedinë

Herët ose vonë, fëmijët do të ndeshen me tragjedinë, qoftë pranë apo larg shtëpisë. Por “edhe kur bota është në trazirë kudo rreth nesh, ne mund të marrim bekimin e paqes së brendshme”¹. Ja ku janë disa gjëra që mund të bëni për t’i ndihmuar fëmijët ta ndiejnë atë paqe.



Stabilitet

Kur ndodh diçka tragjike, fëmijët mund të ndihen sikur bota e tyre nuk është e drejtpeshuar. Jini një shembull qëndrueshmërie për ta. Flisni me qetësi e me besim rreth çështjes. Mbani vijueshmëri sa më shumë që mundeni. Bëni gjithçka që mundeni që të vazhdoni të bëni mbrëmje familjare, studim të shkrimeve të shenjta, lutje dhe zakone të tjera familjare. Me kalimin e kohës, fëmijët mund të mësojnë që edhe kur bota e tyre tronditet, ungjilli sjell ardhmëri dhe jeta vazhdon.

Respekt

Tregoni respekt për emocionet e fëmijëve. Dëgjojini fëmijët dhe njihuni me mënyrën se si ndihen ata. Tregojuni se jeni duke i marrë seriozisht shqetësimet e tyre. Jepuni hapësirë nëse u nevojitet, por bëjuni të ditur se jeni në dispozicion kur ata të jenë gati për të folur. Përgjigjuni me sinqeritet pyetjeve që lindin, në një mënyrë të përshtatshme për moshën. Bëjuni të ditur fëmijëve tuaj se ata gjithmonë mund të flasin me ju për frikën dhe shqetësimet e tyre.



Udhërrëfim

Fëmijët tuaj mund të pyesin: “Pse Perëndia lejon që të ndodhin gjëra të këqija?” Shpjegoni se të dyja, si kohët e mira dhe kohët e këqija, janë pjesë e jetës dhe pjesë e planit të përjetshëm të Perëndisë. Ai e lejon çdo person që të bëjë zgjedhjet e veta dhe ndonjëherë njerëzit bëjnë zgjedhje të këqija që shkaktojnë vuajtje. Herë të tjera, tragjeditë nuk janë faji i askujt, por janë thjesht pjesë e natyrës. Pavarësisht nga kjo, Ati Qiellor është atje për ne. Me ndihmën e Tij, ne mund të mësojmë dhe të rritemi, madje edhe nga përvoja të dhimbshme. Ne mund t’i drejtohemi Atij për të gjetur paqe.

Fuqizim

Tregojuni fëmijëve se ata kanë fuqinë për të bërë një ndryshim duke u dhënë atyre një mënyrë për të ndihmuar. Për shembull, ata mund të ndihmojnë në mbledhjen e dhurimeve për viktimat nga fatkeqësitë, të vizitojnë një shok të sëmurë ose të lënduar në spital, t'ia ngrenë moralin dikujt që po përballet me një humbje familjare ose të lutën për ata që po hasin vështirësi. Ne nuk mund të ndreqim gjithçka, por kemi aftësinë për të bërë shumë të mira dhe ne “punojmë për paqe sa herë që ndihmojmë në lehtësimin e vuajtjeve të një tjetri”².



Ngushëllim

Kujtojeni fëmijëve tuaj se Perëndia i do ata dhe se ju i doni ata. Mos jepni premtime të rreme se asgjë e keqe nuk do t'u ndodhë ndonjëherë, por sigurojini se janë të sigurt pikërisht tani dhe se do të bëni gjithçka që mundeni për t'i mbrojtur ata. Sigurojini se Ati Qjellor do t'i ndihmojë të kalojnë çdo sprovë që hasin në udhën e tyre.

Kur e shikoni veten të zhgënjyer nga fatkeqësitë, mbani mend se në fund, e mira do të triumfojë mbi të keqen. “Ne po luftojmë kundra mëkatit, . . . por nuk duhet të dëshpërohemi”, dha mësim Presidenti Tomas S. Monson (1927–2018). “Është një luftë të cilën mundemi dhe do ta fitojmë. Ati ynë në Qjell na ka dhënë mjetet që na nevojiten për ta bërë këtë. Ai është në timon. Nuk kemi pse të frikësohemi”.³ ■

SHËNIME

1. “Peace”, Gospel Topics, topics.lds.org.
2. “Peace”, Gospel Topics.
3. Shih Tomas S. Monson, “Shohim Pas dhe Ecim Përpara”, *Liahona*, maj 2008, f. 90.

PËR FËMIJËT

Në revistën *Miku* të këtij muaji:

- “Unë do ta Shoh Atë Përsëri” (faqja M20)
- “Karta Ngushëlluese” (faqja M21)

Për burime të tjera, vizitoni [lessonhelps.lds.org](https://www.lessonhelps.lds.org) dhe klikoni te “Lesson Helps by Topic” [“Ndhimma Mësimore sipas Temës”].



PËR ADOLESHENTËT

Në këtë botim:

- “Gjetja e Paqes për Vetën dhe të Tjerët në Kohë të Vështira” (faqet 52–53).

Për burime të tjera, vizitoni [youth.lds.org](https://www.youth.lds.org).



A Po Më Udhëheq Perëndia?

Jeta jonë është e mbushur me zgjedhje të mëdha: cilën rrugë karriere të marrim, me kë të martohemi, në cilën shkollë të shkojmë etj. Jeta jonë është gjithashtu e mbushur me shqetësime të përditshme: zgjedhja e përdorimit më të mirë të kohës, përpjekja për të kuptuar doktrinën dhe gjetja e paqes mes sprova. Në tërësi, **ne kemi nevojë për zbulesë vetjake**. Por, ndonjëherë mund të jetë e vështirë të dimë se si ta marrim atë dhe si ta dallojmë kur e marrim. Kur nuk po i marrim ose nuk po i dallojmë përgjigjet, ne mund ta pyetim veten: “A ishte Shpirti apo thjesht ideja ime?” “Pse u ndjeva i frymëzuar për ta bërë këtë dhe më pas dështova?” “Pse më duket sikur Perëndia nuk u përgjigjet lutjeve të mia?”

Fatmirësisht, tek artikulli “Marrja e Vendimeve: Liria e Zgjedhjes kundrejt Zbulesës” (faqe 44), Erini tregon historinë e saj rreth zbulesës vetjake, kur asaj i duhej të merrte një vendim që do t'i ndryshonte jetën. Ndërkohë që **Perëndia dëshiron të na udhërrëfjë**, Ai gjithashtu dëshiron të na ndihmojë që të mësojmë të mbështetemi në lirinë tonë të zgjedhjes për të bërë zgjedhje të mira.

Të mësosh se si Fryma e Shenjtë të flet personalisht është një pjesë tjetër jetike e marrjes dhe dallimit të zbulesës. Mund të jetë e ndryshme për secilin prej nesh. Në faqen 48, **shumë të rinj në moshë madhore tregojnë se si marrin zbulesë**.

Në një artikull vetëm në formatin elektronik, Aspeni shpjegon se zbulesa vetjake kërkon të bëhet “Ushtrimi i Muskujve Tuaj Shpirtërorë”.

Të mendosh për të ardhmen mund të jetë tronditëse, madje e frikshme. Veçanërisht kur je i ri në moshë madhore. Por, kur kujtoj se si **Perëndia e ka udhëhequr jetën time** në të kaluarën, më jep guxim të shkoj përpara dhe të veproj, duke mirëbesuar se **Ai do të vazhdojë të më japë udhërrëfimin që më nevojitet** përgjatë udhës.

Sinqerisht,

Kejti Su Embli

Kejti Sue



TË RINJTË NË MOSHË MADHORE

KËSHILLA MË E MIRË . . .

Të rinjtë në moshë madhore ndajnë këshillat më të mira që kanë marrë ndonjëherë për marrjen e zbulësës vetjake:

"Këshilltari im në FSY njëherë më tha: 'Zhvilloje marrëdhënien tënde me Perëndinë si me Atin tënd të drejt-përdrejtë shpirtëror. Sa më e fortë të jetë marrëdhënia jote me Të, aq më shumë do të kuptosh dhe do të udhëzohesh.' Kjo ka sjellë një ndryshim të madh në lutjet e mia".

- **Gretn Gulsbi, Kaliforni, SHBA**

"Patriarku i kunjit tonë i ka bërë të gjithë të mësojnë përmendsh një frazë të vetme: 'për të marrë zbulësë, lexoni zbulësë'. Kjo më ka ndihmuar kaq shumë kur i kam lexuar shkrimet e shenjta."

- **Shellbi Tipets, Misuri, SHBA**

"Gjeni kohë për të përsiatuar. Jozef Smithi e përsiati Jakobin [Bibla] 1:5 para se të zgjidhte të vepronte. Ndonjëherë, Ati Qiellor dëshiron që ne të investojmë në lutje dhe të studiojmë përpara se Ai të na japë përgjigje. Ne mësojmë më shumë në këtë mënyrë."

- **Natasha Herbst, Juta, SHBA**

"Dëgjoni me zemër, jo me veshë."

- **Sai Tua, Samoa Amerikane**

Cila është këshilla më e mirë që keni marrë ndonjëherë mbi pendimin? Dërgojeni përgjigjen tuaj te liahona.lds.org brenda datës 30 prill 2019.

RRETH AUTORËVE TË RUBRIKËS PËR TË RINJTË NË MOSHË MADHORE

Erin Rajdëri është avokate dhe bashkëdrejtuese e një emisioni që transmetohet në internet. Ajo sapo vrapoi për herë të parë në një gjysmë maratonë. Në kohën e saj të lirë asaj i pëlqen leximi, ecja në natyrë, uejbordingu (rrëshqitje mbi ujë të tërhequr nga motobarka), dhe koha me familjen e miqtë.



Aspen Standeri është shkrimtare dhe redaktore nga Juta në SHBA. Asaj i pëlqen ecja në natyrë, udhëtimi, leximi dhe të luajturit në piano.




Kejti Su Embli mendon se bota është plot me njerëz të bukur, historitë e të cilëve duhet të tregohen. Ajo studion gazetari dhe spanjisht, me qëllimin për të #sharegoodness (shpërndarë mirësi).



NË KËTË SEKSION

44 Marrja e Vendimeve: Liria e Zgjedhjes kundrejt Zbulësës
Nga Erin Rajdër

48 Zbulësë Vetjake e Përshtatur Enkas Për Ju



Gjeni këto artikuj dhe më shumë:

- Te liahona.lds.org
- Tek **E Përvajshmja për TRMM-të** (nën pjesën "Të Rinjtë në Moshë Madhore" te Gospel Library [Biblioteka e Ungjillit])
- Te [facebook.com/liahona](https://www.facebook.com/liahona)

VETËM NË FORMAT ELEKTRONIK

Ushtrimi i Muskujve Tuaj Shpirtërorë

Nga Aspen Stander

TREGONI HISTORINË TUAJ

A keni ndonjë histori mbresëlënëse për të treguar? Apo, a dëshironi të shihni artikuj mbi tema të caktuara? Nëse po, dëshirojmë të dëgjojmë nga ju! Ju mund t'i dorëzojini artikujt tuaj ose përshtypjet tuaja te liahona.lds.org.



Kur bëhet fjalë për vendime të mëdha, sa duhet të mbështetemi te Perëndia për të na treguar se çfarë duhet të bëjmë?

Marrja e Vendimeve: Liria e Zgjedhjes kundrejt Zbulesës

Nga Erin Rajdër

Çdo ditë secili prej nesh përballet me shumë vendime. Disa janë më të zakonshme, si: “Çfarë të vesh?” “Çfarë të ha për drekë?” “A është koha për të blerë një makinë të re apo mund ta mbaj të vjetrën pak më gjatë?” Por shpesh ne ndeshemi me një vendim të madh – “A duhet të kthehem në shkollë?” “A duhet ta pranoj këtë punë?” “A duhet të shpërngulem në një qytet të ri?” “A duhet të blej një shtëpi?” “A duhet të dal në takime me këtë person?” “A duhet të martohem me këtë person?” e kështu me radhë.

Kur ballafaqohemi me vendime të mëdha, ne priremi – me vend – të duam pak më shumë kohë për të bërë një zgjedhje. Ne e ndjekim këshillën që iu dha Oliver Kaudërit te Doktrina e Besëlidhje 9:8-9, ku Zoti thotë:

“Por, vër re, unë të them se ti duhet ta studiosh atë tërësisht në mendjen tënde; më pas ti duhet të më pyesësh nëse është e drejtë dhe nëse është e drejtë, unë do të bëj që kraharori yt do të digjet përbrenda; si rrjedhim, do ta ndiesh që është e drejtë. Por nëse nuk është e drejtë, ti nuk do të kesh ndjenja të tilla, por do të kesh një mpirje të mendimit që do të të bëjë ta

harrosh gjënë që është e gabuar”.

Megjithëse kjo me siguri është një këshillë e mirë, kur bëhet fjalë për vendime të mëdha, nganjëherë ne mbështetemi pak si shumë te pjesa ku Perëndia na tregon se çfarë është e drejtë dhe jo mjaftueshëm te pjesa ku Ai na thotë ta studiojmë në mendjen tonë. Ne shqetësohemi kaq shumë duke pritur që Perëndia t’i miratojë vendimet tona, sa që ne lëmë të kalojnë mundësi të jashtëzakonshme. Ne madje mund ta pranojmë edhe rolin e lirisë së zgjedhjes, por tmerrohemi nga marrja e një vendimi që mund të na largojë nga “plani” ynë i paracaktuar dhe të përfundojmë duke hamendësuar se çdo gjë përveç djegies në kraharor ose një zë nga qielli nënkupton se vendimi ynë është i gabuar. Për shumë prej nesh, ky tension i pashprehur ndërmjet lirisë së zgjedhjes dhe zbulesës vetjake çon në një pyetje domethënëse: Cili është roli i Perëndisë për të na ndihmuar të marrim vendime?

Roli i Perëndisë në Vendim-marrjen Tonë

Ndoshta kjo pyetje trajtohet më së miri nëpërmjet historisë së vëllait të



Jaredit. Ekziston një model interesant i rritjes në këtë histori që na mëson për mënyrën se si pret Perëndia që ne të marrim vendime. Pasi në Kullën e Babelit u ngatërruan gjuhët, Jaredi i kërkon vëllait të tij që ta pyetë Zotin a duhet të largohen nga vendi dhe nëse po, ku duhet të shkojnë (shih Ethëri 1:36–43). Vëllai i Jaredit pyet, dhe Zoti i udhëheq drejt bregut të detit. Ndërsa udhëtojnë, Zoti u flet atyre në një re dhe drejton çdo hap të udhëtimit të tyre. Përfundimisht ata mbërrijnë në breg të detit, ku qëndrojnë për katër vjet.

Në fund të katër viteve, Perëndia i thotë vëllait të Jaredit të ndërtojnë maune dhe të përgatiten që të kalojnë oqeanin. Kur vëllai i Jaredit e kupton se anijet nuk do të kenë ajër, ai ndjek të njëjtin model të njohur duke shkuar te Perëndia për ta pyetur se çfarë duhet të bëjë. Siç pritej, Zoti i përgjigjet duke i dhënë udhëzime të hollësishme për të bërë vrima në majat dhe fundet e anijeve. Vëreni modelin e zbulësës deri më tani: Perëndia u jep atyre një plan, ata bëjnë pyetje rreth mënyrës se si ta përbushin planin dhe Perëndia u përgjigjet me përgjigje të hollësishme e përfundimtare.

Por pasi bën vrimat në anije, vëllai i Jaredit kupton se anijet nuk do të kenë dritë. E pyet edhe një herë Perëndinë se çfarë duhet të bëjë. Megjithatë, në vend që të përgjigjet, Perëndia pyet: “Ç’do që të bëj që të keni dritë në barkat tuaja?” (Ethëri 2:23). Në vend që të jepte udhëzime të hollësishme siç kishte bërë më parë, këtë herë Zoti pret që vëllai i Jaredit të vendosë se çfarë të bëjë.

Kjo lloj përgjigjeje nga Zoti është ndoshta më e vështira për t'u kuptuar kur përpiqesh të marrësh një vendim. Neve na është mësuar të lutemi dhe të presim për një përgjigje, kështu që natyrisht shqetësohemi kur nuk dëgjojmë asgjë në përgjigje. Shpesh pyetim a cilësohet mungesa e një përgjigjeje të qartë si "mpirje [e] mendimit" që tregon se zgjedhja jonë është e gabuar. Herë të tjera pyetim veten a do të thotë kjo se nuk jemi mjaftueshëm të drejtë sa ta dëgjojmë përgjigjen, apo që nuk po kërkojmë me "qëllim të vërtetë" (shih Moroni 10:4). Por ka një mundësi të tretë, që nganjëherë ne nuk e marrim parasysh – ndoshta, ashtu si me vëllanë e Jaredit, Perëndia po pret që ne ta marrim vetë vendimin tonë.

Marrja e një Vendimi

Kohët e fundit u ndesha me një situatë që e sfidoi mënyrën se si mendoja për lirinë e zgjedhjes dhe zbulësën vetjake. Ndërsa po i afrohesha fundit të shkollës

pasuniversitare, pata disa oferta të ndryshme pune në qytete të ndryshme dhe nuk mund të vendosja se cilën të zgjidhja. Ashtu si vëllai i Jaredit, unë kisha përjetuar shumë çaste kur isha lutur për një vendim të madh dhe Perëndia u përgjigj me një përgjigje mjaft të qartë. Duke u mbështetur në ato përvoja të mëparshme, fillova të lutesha dhe t'i kërkoja Perëndisë që të më ndihmonte të vendosja se cilën punë duhet të pranoja. Gjithashtu po bëja pjesën time duke mësuar rreth mundësive të secilës punë dhe duke u këshilluar me shumë njerëz. Por pavarësisht nga sa u luta ose agjërova, qiejt qëndruan të heshtur dhe nuk mora asnjë përgjigje.

Afati i fundit për marrjen e një vendimi po afrohej dhe fillova të isha në panik. Sigurisht ky ishte lloji i vendimit që Zotit duhet t'i interesojë, prandaj pse nuk po përgjigjej Ai? Ndoshta Atij nuk i interesonte se cilën punë zgjidhja, por Atij duhet t'i interesonte se në cilin qytet vendosjesha,

pasi pa dyshim do të kishte ndikim në jetën time. Zotit përherë i kishin interesuar vendimet e mia në të shkuarën, pra përse nuk do t'i interesonte edhe kjo?

Megjithatë, pa marrë parasysh sa shumë u përpoqa, nuk erdhi asnjë përgjigje. Fillova ta pyesja veten a isha larguar nga Perëndia aq shumë sa që nuk mund ta dëgjoja përgjigjen e Tij. Gjithashtu pyesja veten a mos ndoshta nuk po dëgjoja ngaqë, nënvetëdijshëm, nuk *doja* ta dëgjoja përgjigjen. Më në fund, ditën para afatit të fundit, e dija se duhej të bëja një zgjedhje, kështu që përdora gjykimin tim dhe mora një vendim. Atë natë thjesht u luta, duke i kërkuar që Ai të më tregonte nëse përgjigja ime ishte e gabuar. Prapë nuk erdhi asnjë përgjigje kështu që vazhdova dhe e pranova punën.

Disa muaj më vonë, ende po e vija në diskutim vendimin tim, prandaj kërkoja një bekim priftërie për të fituar siguri. Në bekim m'u tha se nuk mora një përgjigje për lutjen time ngaqë Zoti ishte i lumtur



çfarëdo vendimi të merrja. Ky bekim e përforcoi këshillën e dhënë më parë nga presidenti im i misionit, i cili më tha se shpeshherë nuk ka rëndësi se çfarë vendimi marrim. Perëndia dëshiron që ne të mësojmë se si të qëndrojmë në këmbët tona dhe të vendosim se si ta jetojmë jetën tonë. Presidenti im i misionit më kujtoi gjithashtu se Perëndia, si Ati ynë Qiellor, nuk do të na dënojë dhe nuk do t'i largojë mundësitë e premtuara nëse përpiqemi sinqerisht të kuptojmë se çfarë duhet të bëjmë.

Vëllai i Jaredit me gjasë mund të kishte sugjeruar pothuajse çdo zgjidhje për t'i ndriçuar maunet, dhe Zoti do të ishte i kënaqur nga kjo. Qëllimi i përvojës nuk ishte vetëm që vëllai i Jaredit ta forconte besimin e tij, por gjithashtu të mësonte se si të merrte një vendim.

Ushtrimi i Lirisë së Zgjedhjes

Nga një këndvështrim i përjetshëm, ushtrimi i lirisë së zgjedhjes është një përbërës i domosdoshëm i rritjes vetjake. Pa

të, ne nuk mund të marrim ato lloj vendimesh që do të na ndihmojnë të arrijmë potencialin tonë të plotë. Rritja, ashtu si çdo gjë tjetër në ungjill, vjen "rresht pas rreshti, parim pas parimi" (2 Nefi 28:30). Perëndia dëshiron që ne të jemi një popull i përgatitur, jo një popull i paralizuar, dhe Ai pret që ne ta përdorim lirinë tonë të zgjedhjes për ta jetuar jetën tonë sa më mirë që mundemi.

Sapo të mësojmë të gjejmë ekuilibër midis lirisë së zgjedhjes dhe zbulësës, ne mund të përjetojmë një rritje të vërtetë shpirtërore. Kjo është ajo që i ndodhi vëllait të Jaredit. Pasi e mendoi mirë, ai punoi për të shkruar 16 gurë nga një shkëmb dhe i kërkoi Perëndisë t'i prekte dhe t'i bënte të shkëlqenin (shih Ethëri 3:1-5). Këtë herë, kur Perëndia u përgjigj, gjithçka ndryshoi. Në vend që ta dëgjonte zërin e Perëndisë në një re, vëllai i Jaredit në të vërtetë *pa* Zotin, i cili jo vetëm që u shfaq personalisht, por gjithashtu i tregoi vëllait të Jaredit vegime

të jashtëzakonshme për botën dhe çdo gjë që do të vinte (shih Ethëri 3: 6-26). Ka mundësi që vëllai i Jaredit nuk do të kishte qenë i përgatitur shpirtërisht për ta marrë atë vegim nëse ai nuk do ta kishte përjetuar më parë rritjen vetjake që erdhi nga marrja e vendimit të tij.

Ndërsa marrim vendime, ne sigurisht që duhet ta ndjekim këshillën e Almës që të "këshilloh[emi] me Zotin për të gjitha veprimet [tona]" (Alma 37:37). Kur Zoti ka nevojë që ne të marrim një vendim të posaçëm, Ai do të na e bëjë të ditur dhe do të na ndihmojë që të mos shkojmë në udhë të gabuar. Por edhe ne duhet të jemi të përgatitur që të ngrihemi dhe të ecim përpara në besim, pavarësisht nëse vjen apo jo një përgjigje. Për sa kohë i mbajmë besëlidhjet tona dhe qëndrojmë të vërtetë ndaj ungjillit të Jezu Krishtit, ne mund të ndiejmë vetëbesim në vendimet tona të drejta dhe paqe se Zoti është i kënaqur me përpjekjet tona. ■

Autorja jeton në Juta, SHBA.



Si e bëni dallimin
midis zbulesës
dhe vetë mendi-
meve tuaja?



Zbulesë Vetjake e **PËRSHTATUR** **ENKAS PËR JU**

Ne jetojmë në një botë me mundësi të shumta. Kemi lirinë për të zgjedhur karrierën tonë, shkollën, bashkëshortin/en, vendin ku duam të jetojmë dhe shumë më tepër. Është me të vërtetë një bekim i brezit tonë. Por, nga ana tjetër, kjo i bën të gjitha këto zgjedhje më të vështira, sepse është e vështirë të marrësh vendime kur ka kaq shumë shtigje dhe mundësi që do të na çojnë në gjëra të mira. Si e zgjedhim të duhurën kur ekzistojnë kaq shumë mundësi që janë të mira? Kur ndiheni të humbur e të pështjelluar në këtë stuhi vendimmarrjesh, dijeni se Ati Qiellor dëshiron t'ju udhërrëfejë. Ju mund të zgjidhni shtegun e duhur dhe të merrni përgjigjet që po kërkoni nëse e ndiqni zërin e Tij. Dallojeni mënyrën se si Ai ju flet, mirëbesojini Atij, ndiqni profetin, jini të duruar, jini më optimist dhe kini besim, dhe përfundimisht do të udhëhiqeni për në drejtimin e duhur.
– *Vira Vashçenko, Kiev, Ukrainë*

Gjatë gjithë jetës kam parë se si Zoti më ka udhëhequr, dhe e kuptoj se gjithçka që kam arritur është falë Tij dhe udhërrëfimit të Tij. Edhe në çastet kur mendoj se eci vetëm, në fund, Ai më bën të ditur se ka qenë gjithnjë me mua dhe unë e ndiej këtë. Kjo është arsyeja pse kam marrë vendimin për të vazhduar gjithmonë përpara me besim, madje edhe kur mendoj se jam vetëm. Për mua, ka raste kur shtegu nuk është gjithmonë i qartë dhe nuk mund ta shoh gjithnjë se çfarë më pret në të ardhmen, por unë gjithnjë ndërmarr hapa besimi dhe pastaj filloj ta shoh dritën dhe ta dalloj dorën e Perëndisë në jetën time. E di se Ati ynë Qiellor dhe Biri i Tij, Jezu Krishti, na duan dhe se Ata janë të gatshëm të na udhërrëfejën, por Ata gjithashtu presin që ne ta vëmë besimin tonë tek Ata dhe të veprojmë kur marrim nxitje nga Shpirti.
– *Indhira Meja, Republika Domenikane*



Mendoj se një nga teknikat më të mahnitshme që duhet të zotërojmë është aftësia për t'i dalluar pëshpëritjet e buta të Frymës së Shenjtë. Studimi i zellshëm i shkrimeve të shenjta më ka shtyrë më tej për ta zotëruar atë. Kam besuar gjithmonë se ai që kërkon me zell do të gjejë; dhe misteret e Perëndisë do të shpalosen përpara tij me anë të fuqisë së Frymës së Shenjtë (shih 1 Nefi 10:19). Me fjalë të tjera, nëse dua ta dalloj Shpirtin, nuk mund t'ia lejoj vetes që të futem në mendime të padobishme ose në shqetësimet e jetës së përditshme, por në vend të kësaj unë duhet t'i futem punës dhe ta harroj veten. Ky është çasti kur unë do të jem më në gjendje ta dalloj Shpirtin, pasi jam gati për të! Ashtu sikurse një anije nuk mund të udhëtojë me lehtësi përmes një stuhie, ne nuk mund ta dëgjojmë Shpirtin nëse na marrin me vete shqetësimet e jetës që janë jashtë kontrollit tonë.

– *Emanuel Borngreat Dogbi, Akra, Gana*

Teksa rritesha, më është dashur të mësoj gjuhën e Shpirtit. Shpirti flet me mua nëpërmjet mendimeve të thjeshta. Më është dashur praktikë që të mësohem me këtë, por zakonisht Shpirti vjen tek unë në vende të qeta, si për shembull kur ngas makinën për të shkuar në punë. E di që nuk janë mendimet e mia, sepse Shpirti shpesh ndërhyr kur nuk po mendoja fare për temën.

– *Klarisa Mej Tejlör, Juta, SHBA*

Në familjen tonë të vogël, ne e dallojmë Shpirtin për shkak të paqes që ndiejmë, sidomos unë dhe bashkëshorti im së bashku si çift. Kur janë vetë mendimet tona, nuk ndiejmë kurrë se kjo është padyshim gjëja e duhur – gjithmonë ka një dyshim apo frikë të nënkuptuar. Por, kur është zbuluesë, ne gjithmonë ndiejmë paqe, edhe nëse përpiqemi të arsyetojmë dhe gjërat nuk duket se kanë shumë kuptim fillimisht. Kur e ndjekim atë dhe ia dalim mbanë, gjithmonë shohim se gjërat zënë vendin e vet dhe gjithçka funksionon. Kjo ndodh kur ne shohim njëri-tjetrin dhe themi, “Ou, tani ka kuptim!”

– *Mariana Rajt, Juta, SHBA*



Megjithëse të gjithë ne mund të marrim zbuluesë vetjake në mënyra të ndryshme, një gjë padyshim është e vërtetë: Perëndia na flet shpesh. Ne thjesht duhet të jemi të gatshëm që të bëjmë përpjekje për ta rritur aftësinë tonë për ta dalluar dhe dëgjuar zërin e Tij. Siç këshilloi Presidenti Rasëll M. Nelson: “Lutuni në emrin e Jezu Krishtit për shqetësimet tuaja, frikën tuaj, dobësitë tuaja – po, pikërisht dëshirat e zemrës suaj. Dhe më pas dëgjoni! Shkruajini mendimet që ju vijnë në mendje. Shënojini ndjenjat dhe pasojini me veprime që nxiteni të bëni. Kur e përsëritni këtë proces ditë pas dite, muaj pas muaji, vit pas viti, ju do të ‘rriteni drejt parimit të zbuluesës’” (“Zbuluesë për Kishën, Zbuluesë për Jetën Tonë”, *Liahona*, maj 2018, f. 95). ■



NË KËTË SEKSION



52 Gjetja e Paqes për Vetën dhe të Tjerët në Kohë të Vështira

Nga Aleks Hëgi dhe Aspen Stendëri

54 Jeta Është një Maratonë

Nga Salli Xhonson Odëkirku

60 Pyetje dhe Përgjigje: Si mund të më ndihmojë bekimi im patriarkal që të marr vendime?

62 Provoni Disa Tradita të Reja Pashke

Nga Dejvid Diksoni

64 Fjala e Fundit: Shprehja më e Madhe e Dashurisë së Perëndisë

Nga Presidenti M. Rasëll Ballard



Kur shkova

për herë të parë në shkollë të mesme, pata vështirësi me një gjë: kur u paraqit një temë e re, e kisha të vështirë ta kuptoja. Një mbrëmje iu luta Atit Qiellor që të më ndihmonte ta kuptoja dhe ta kapërceja atë sfidë. Pata besim dhe isha në gjendje ta kuptoja më mirë. Që nga ajo kohë, lutja dhe besimi kanë qenë në listën time të gjërave që duhen bërë në shkollë dhe kudo që shkoj.

Të jesh në një shkollë vetëm me djem është sfiduese për shkak të disa prej gjërave të pamoralshme që bëjnë studentët. Kur ajo ndodh, më vijnë ndër mend fjalët e prindërve të mi: "Mos bëj kurrfarë gjëje që do të ta largojë Frymën e Shenjtë". I jam mirënjohës mamasë sime e cila më kujton përherë që ta dëgjoj Frymën e Shenjtë. Kur bëjmë atë që është e drejtë, Perëndia na bekon.

Niami S., moshë 16 vjeç, Gana

Ndonjëherë jeta ka uljet dhe ngritjet e veta. Ju mund të merakoseni për probleme familjare, probleme shëndetësore, probleme në shkollë ose shumë ngjarje të tjera shqetësuese në botë sot. Si mund të gjejmë paqe vetjake në një botë të vështirë? Qoftë nëse mungesa e paqes vjen nga ngjarje që nuk janë nën kontrollin tuaj ose nga gjëra tek të cilat mund të ndikoni dhe t'i ndryshoni, këtu janë disa ide për t'ju ndihmuar të gjeni paqe të brendshme nëpërmjet Jezu Krishtit.

GJETJA E PAQES

4 MËNYRA PËR TË GJETUR PAQE PËR VETEN

1. Përqendrohuni tek e përjetshmja

Është e vështirë të ndihesh në paqe kur je i përqendruar vetëm te shqetësimet afatshkurtra. Por nëse përqendrohuni tek e gjithë panorama, plani i Perëndisë për lumturinë, ju mund të gjeni paqe te njohuria se ajo që të lëndon pikërisht tani nuk do të zgjatë përjetë. Për shembull, tempulli na ndihmon të përqendrohemi tek e përjetshmja. Presidenti Gordon B. Hinkli (1910–2008) tha se në tempull “ju do të dalloni një paqe që nuk do ta gjeni tjetërkund”¹.

2. Hiqni dorë nga ajo që nuk mund ta kontrolloni

Kur diçka që nuk e keni nën kontroll e largon paqen nga ju, është tunduese të ndihesh i pashpresë ose i zemëruar. Por nuk është e dobishme të përqendrohuni te gjëra që nuk mund t'i ndryshoni. Në vend të kësaj, afrohuni te Shpëtimtari për të gjetur paqe të brendshme edhe kur jeta ju jep një dorë të keqe letrash. Ai ka premtuar që t'ju dërgojë Ngushëlluesin, Frymën e Shenjtë (shih Gjoni 14:26–27).

3. Falini të tjerët

Shpesh gjëja më e vështirë nga e cila të hiqni dorë është negativiteti që ndieni kur dikush ju bën padrejtësi. Por Plaku Diter F. Uhtdorf, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, ka dhënë mësim: “Ne do të kemi gëzimin e faljes në jetën tonë kur dëshirojmë që ta shtrijmë këtë gëzim lirisht tek të tjerët. . . . Si rrjedhim, Shpirti i Zotit do të mbushë shpirtrat tanë me gëzimin që shoqëron qetësinë hyjnore të vetëdijes (shih Mosia 4:2–3).”² Kthimi te Shpëtimtari mund t'ju ndihmojë të çlirohuni nga barrët emocionale dhe të mbusheni me paqe.

4. Pendohuni dhe mbështetuni te Krishti

Pavarësisht nga gjërat e tjera që po shkojnë mirë në jetën tuaj, mbajtja e barrës së mëkatit përherë do t'ju rrëmbejë paqen. Ndonjëherë kemi nevojë për peshkopin tonë që të na ndihmojë të pendohe mi plotësisht. Por ne të gjithë kemi nevojë të pendohe mi rregullisht dhe nëpërmjet Shlyerjes së Jezu Krishtit, të bëhemi të pastër nga çdo gjë që na pengon për t'u bërë më shumë si Ai.





për Vetën dhe të Tjerët në Kohë të Vështira

Nga Aleks Hëgi dhe Aspen Stendëri
Revistat e Kishës

*Ja tek janë tetë mënyra për ta ndihmuar
veten dhe të tjerët të ndiejnë paqe kur
jeta bëhet e vështirë.*



4 MËNYRA PËR T'Ë NDIHMUAR TË TJERËT TË GJEJNË PAQE

1. Shpërndajeni ungjillin e Jezu Krishtit

Ashtu siç mund të gjejmë paqe për veten tonë duke u përqendruar te Shpëtimtari, ne mund t'i drejtojmë të tjerët tek Ai si "themeluesi i paqes" (Mosia 15:18). Për shembull, përpiquni të jepni një shkrim të shenjtë ose një citim nga konferenca e përgjithshme që ju ndihmoi të mësonit më shumë rreth Jezu Krishtit.

2. Jini një paqebërës

Ndihmohuni shokët ose shoqet apo motrat ose vëllezërit tuaj që t'i zgjidhin konfliktet. Ashtu si anti-nefi-lehitët në librin e Almës, ne mund t'v varrosim armët tona të luftës – armë si bërja e thashethemeve, kërkimi i hakmarrjes ose të qenit egoist – dhe t'i shkëmbejmë ato me mjetet e paqes: të folurit me mirësi, bindjen ndaj urdhërimeve të Perëndisë dhe faljen e të tjerëve (shih Alma 24:19).

3. Jini një dëgjues i mirë

Ndonjëherë, njerëzit e munduar kanë nevojë që të flasin hapur për mendimet dhe ndjenjat e tyre në vend që t'i mbajnë përbrenda. Nuk duhet t'i zgjidhim ne problemet e tyre por thjesht mund t'i dëgjojmë shqetësimet e tyre dhe t'u japim përkrahje, duke treguar dashuri dhe mirëkuptim si të Krishtit.

4. Jepuni shërbesë njerëzve në lagjen dhe komunitetin tuaj

Ju mund të dilni vullnetar në një strehë për të pastrehët, të shërbeni si mbikëqyrës i një bashkëmoshatare ose t'i çoni gostitje një familjeje të re në lagjen tuaj. Ndihmohuni njerëzit të gjejnë paqe te gjërat e vogla. Pasja e një vendi të qëndrueshëm për të ngrënë dhe fjetur, një mbikëqyrës të besueshëm ose një sigurie të vogël që dikush interesohet për ty, mund të ketë një ndikim të fortë.

Jezusi u tha këto fjalë ngushëllimi të gjithë atyre që patën vështirësi për të gjetur paqe: "Unë po ju lë paqen, po ju jap paqen time: unë po ua jap, po jo si e jep bota; zemra juaj mos u tronditë dhe mos u frikësoftë" (Gjoni 14:27). Nëse shkojmë vetë dhe i sjellim të tjerët më afër Jezu Krishtit, ne mund të gjejmë paqe edhe kur jeta bëhet e vështirë. ■

SHËNIME

1. Gordon B. Hinckley, në "Rejoice in the Blessings of the Temple", *Liahona*, dhjetor 2002, f. 33.
2. Diter F. Uhtdorf, "Pikë Kthimi të Sigurt", *Liahona*, maj 2007, f. 101; *Konferenca e Përgjithshme*, prill 2007, f. 126.



JETA ËSHTË NJË **M**



ARATONË

Këta shenjtorë të rinj të ditëve të mëvonshme jetojnë sot atje ku Apostulli Pal jetoi gjatë kohës së Dhiatës së Re. Dhe ata jetojnë sipas fjalëve të tij.

Nga Salli Xhonson Odëkirku

Revistat e Kishës

Disa muaj më parë, një klasë seminari u takua në Areopag, afër Athinës në Greqi, ku Apostulli Pal një herë dha një predikim të fuqishëm (shih Veprat e Apostujve 17:22-34). Nxënësit folën për ndikimin e seminarit në jetën e tyre, përfshirë mësimet e Palit.

“Të jetuarit në Greqi e bën të gjallë kohën e Dhiatës së Re”, thotë Aleksis H., mosha 18 vjeçe. “Babait tim i pëlqen të shkojë në rrënoja të ndryshme ku Pali dha mësim dhe do të na japë një shkrim të shenjtë ose do të na tregojë një histori rreth vendin ku ndodhi ngjarja.”

Ashtu si Pali hasi sfida në kohën e tij, të rinjtë në Greqi gjithashtu përballen me probleme shoqërore, politike dhe ekonomike. Konferencat e Të Rinjve dhe kampi i Të Rejave janë ngjarje të rralla në Greqi dhe madje marrja pjesë në seminar mund të jetë e vështirë. Përveç këtyre dhe sfidave të tjera, të rinjtë në Greqi e vënë në zbatim nxitjen nga Pali për të “qëndr[uar] fort në një frymë të përbashkët, duke luftuar bashkë me një shpirt për besimin e ungjillit” (Filipianëve 1:27).

Të jetosh në Greqi do të thotë që këta anëtarë të rinj shijojnë klimën e ngrohtë, plazhet, ushqimin dhe kërcimin. Ata gjithashtu e shijojnë vërtet kohën kur mbledhen me njëri-tjetrin. Ndërsa takohen në seminar dhe veprimtaritë e degës, ata janë bërë më të fortë në besim dhe shoqëri.

Seminari në Areopag

Kur seminari filloi në Greqi disa vite më parë, ishin vetëm pesë nxënës. Ata takohen tri herë në javë në



"Kam mësuar se ungjilli është i njëjtë kudo. Nga të jetuarit jashtë shtetit kam mësuar të përqendrohem tek të vërtetat e ungjillit dhe ta ndiej Shpirtin në vend që të shpërqendrohem nga kultura."

- Briana W., 15 vjeçe



"E shkrova fjalën kujto në pasqyrën time për të kujtuar gjithçka që ka ndodhur këtë vit: FSY, kampi i Të Rejave, seminari. Më ndihmon të kujtoj se nga kam ardhur."

- Maria H., moshë 17 vjeçe



"E di se kur shkoj në seminar unë mund të ndiej kënaqësi nga njohuria se po bëj atë që kam nevojë të bëj dhe e di se gjithçka do të jetë në rregull."

- Lizi T., moshë 17 vjeçe



Lukia C., moshë 15 vjeçe, e dha dëshminë e saj për herë të parë në kampin e Të Rejave dhe më vonë u pagëzua.



Grupi i seminarit përballë shtëpisë së mbledhjeve në Athinë.

mëngjes, me disa të tjerë që bashkohen nëpërmjet videokonferencës në internet. Ata gjithashtu takohen të mërkurave pasdite për seminar, që pasohet nga një veprimtari. Ata janë afruar më pranë njëri-tjetrit dhe janë bërë një dritë për miqtë e tyre, të cilëve iu bie në sy shembulli i tyre. Kur shokët ose shoqet e tyre bëjnë pyetje, të rinjtë i sjellin ata në seminar dhe veprimtaritë e përbashkëta.

Një i ri, Pavlos K., moshë 15 vjeçe, thotë: "Vajtja në seminar është një mënyrë e mirë për ta filluar ditën dhe më ndihmon të qëndroj i fortë. Ai i drejton mendimet e mia tek të qenit një shembull për të tjerët. Ndihmon që ta filloj ditën duke menduar rreth Jezu Krishtit."

Ndërsa të rinjtë rriten në forcë dhe unitet, vijnë bekimet dhe mundësitë. Për shembull, në vitin 2017 ata u bekuan për të marrë pjesë në konferencën "For the Strength of Youth" ["Për Forcën e Rinisë"] (FSY), një konferencë krahinore e madhe për rininë. Të rejtat gjithashtu morën pjesë në kampin e parë fare të Të Rejave në Greqi. Si rrjedhojë, ato janë afruar edhe më shumë si grup dhe dy të reja iu bashkuan Kishës.

Konferenca Ndërkombëtare e FSY-së

Konferenca, e mbajtur në Gjermani, i bashkoi shenjtoret e rinj të ditëve të mëvonshme nga e gjithë Europa. Të rinjtë nga Greqia dhe Qipro erdhën nga qindra kilometra larg dhe përvoja e konferencës pati një ndikim të thellë tek ta. Për Maksimosin A., moshë 14 vjeçe, "gjëja më e paharruar në FSY ishte koha kur dhamë dëshmitë tona. Gjithsecili e ndjeu Shpirtin dhe kjo më frymëzoi për ta zhvilluar vetë dëshminë time."

"Në fillim do të shkonin vetëm katër të rinj", shton Lukia C., moshë 15 vjeçe, "por në fund kishim 15 pjesëmarrës – një rekord për Greqinë – duke përfshirë 3 miq joanëtarë."

"Ishte kaq bukur që ishim së bashku diku ku ke të njëjtin ungjill dhe nuk je i pangjashëm. Ne ishim të gjithë së bashku dhe po ndienim të njëjtin Shpirt. Këto gjëra më ndihmojnë."

"Babai im nuk është anëtar dhe nuk do të më lejonte që të shkoja në FSY ose të pagëzohesha", thotë Xhesiana, moshë 16 vjeçe. "Por pastaj anëtarët e degës agjëruan për mua dhe gjyshja ime foli me babanë. Pas kësaj ai tha se mund të shkoja!"

Në FSY, ajo provoi shumë gjëra për herë të parë, të tilla si “pjesëmarrja në mësimet e vepërimitari dhe dhënia e dëshmisë sime më ndihmoi të kuptoja se si është në të vërtetë të ndiesh Frymën e Shenjtë. Nuk e kam ndier Shpirtin kurrë më parë në atë mënyrë, dhe isha shumë e lumtur dhe e emocionuar. Dhashë dëshminë time për herë të parë.”

Përveç të ushqyerit shpirtërisht, të rinjtë ishin në gjendje të çlodheshin dhe të argëtoheshin së bashku në konferencë. Heixh T., moshë 14 vjeç, erdhi në konferencë nga Qipro. “Mësova të jem më i shoqërueshëm, të kem miqësi të vërteta dhe të argëtohem, edhe në kohë të vështira.”

Kampi i Të Rejave


Kampi i Të Rejave pati një efekt të ngjashëm. Dymbëdhjetë të reja u takuan me udhëheqëset e tyre afër vendbetejës së lashtë të Maratonës. Ato kaluan tri ditë së bashku, duke mësuar që të mbështeten te njëra-tjetra për forcë dhe nxitje.

“Kur isha 12 vjeçe”, thotë Lukia, “shkova në kishë për herë të parë dhe isha shumë e lumtur, por pastaj e kuptova se isha e vetmja në atë moshë. Tani, dy vjet më vonë, ne kemi kaq shumë të reja që për herë të parë ishim në gjendje të kishin kampin e Të Rejave.” Ndërsa u takuan së bashku, ajo tha: “E kuptova se çdo të thotë të jesh një shenjtorë e ditëve të mëvonshme. Kur e jetojmë ungjillin, na rrethon një dritë.”



“Pjesa ime e parapëlqyer e FSY-së ishin sportet, kërcimi dhe mbledhjet si grup, që ishin takime shpirtërore dhe rishikime në mëngjes. Kjo më ndihmoi të jem më i gjindshëm e i duruar dhe t’i vlerësoj shkrimet e shenjta më shumë.”

– Heixh T., moshë 14 vjeç




Rrugës për në FSY në Shtuttgart, Gjermani.




Në konferencën e FSY-së, duke shqiptuar fjalën “Kërko” nga Jakobi [Bibël] 1:5.

“Qëndroni fort në një frymë të përbashkët.”

Filipianëve 1:27




Irini S. interpreton në FSY.



“Në FSY, ne filluam të ishim një grup dhe ajo na forcoi. Ai ndihmoi në formimin dhe ndikimin në programin e të rinjve në Greqi sepse tani ne e njohim shumë më mirë njëri-tjetrin.”

– Aleksis H., moshë 18 vjeç



“Të kënduarit në skenë në FSY ishte një nga gjërat më të guximshme që kam bërë ndonjëherë dhe një nga çastet më të magjishme që kam pasur ndonjëherë. Në atë çast mësova se sa të rëndësishëm jemi në këtë botë të bukur.”

– Irini S., moshë 17 vjeç



"Në kampin e Të Rejave mësova se jeta është si një maratonë. Kjo më ndihmoi ta rrit besimin tim, duke e ditur se ne duhet të vazhdojmë në shtegun e drejtë, njëlloj sikur po vrapojmë në një maratonë. Ajo përvojë më ndihmon ta rrit dëshminë time dhe të vazhdoj të kem besim e të qëndroj në shtegun e drejtë."
- Uinifred K., moshë 14 vjeçe

"Jeta është një maratonë, jo një vrap i shpejtë."

Tema e kampit të Të Rejave



Të rejat në Maratonë, Greqi.



"Ne të gjithë jemi unik, ashtu si guralecët në plazh që janë secili unik." - Briana W.



"Të parit e lindjes së diellit solli një shpirt qetësues dhe të bukur." - Lizi T.

Për Brianën W., moshë 15 vjeçe, FSJ-ja dhe kampi i Të Rejave e ndihmuan atë të hapej dhe të fliste me të tjerët. "Familja ime shpërngulet shpesh dhe e kisha të vështirë të lidhesha me të tjerët sepse isha e ndrojtur", thotë ajo. "Por për shkak se u afrova me grupin tonë në FSJ, bëra disa miq vërtet të mirë. Gjatë mbledhjes së dëshmimeve, ne folëm për ndjenjat tona dhe e kuptova se të tjerët u ndien në të njëjtën mënyrë siç u ndjeva unë."

Maria H., moshë 17 vjeçe, kujton temën e kampit: "Jeta është një maratonë, jo një vrap i shpejtë". "Të rejat dhe udhëheqëset e tyre diskutuan për rëndësinë e durimit dhe përfundimit të garës", thotë ajo. "Kjo më kujtoi se unë mund të duroj, ta ruaj ritmin dhe të qëndroj e përqendruar te vija e përfundimit. Pastaj mund të përmbush gjërat që Ati Qiellor ka nevojë që unë të bëj."

Një nga kulmet e kampit ishte një takim shpirtëror në agim në plazh mëngjesin e tyre të fundit. Lizi T., moshë 17 vjeçe, thotë: "Ne i morëm me vete shkrimet tona të shenjta, patëm takim tonë shpirtëror dhe pamë lindjen e diellit. Ne të gjithë e ndiem dashurinë e Perëndisë. Ishte një mbyllje e mrekullueshme e kohës që kaluam me njëra-tjetrën."

Përballimi i të Ardhmes pa Frikë

"Nga FSJ-ja dhe kampi i Të Rejave, unë mësova shumë gjëra për ungjillin dhe se si ai mund të më ndihmojë në jetën time", thotë Irini S., moshë 17 vjeçe. "Bëra shumë miq dhe mësova se sa e rëndësishme është që t'i shpreh mendimet dhe ndjenjat e mia. E ndjeva Frymën e Shenjtë shumë thellë dhe dashurinë e Shpëtimtarit tonë, Jezu Krishtit."

Të qenit përreth të rinjve të tjerë shenjtorë të ditëve të mëvonshme, thotë ajo, e forcoi vetëbesimin e saj. "Përpara FSJ-së




Kampi i Të Rejave, 2017 – i pari fare në Greqi.

nuk mund t'i shihja gjërat e mira dhe të bukura që Perëndia bëri për ne dhe planet që Ai ende po bën për ne."

"Ne nuk duhet të ndikohemi nga asnjë ose asgjë tjetër rreth nesh që do të përpiqet të na largojë nga të jetuarit e ungjillit", thotë Manasehi

A., moshë 17 vjeç. "Ungjilli është i njëjtë kudo dhe ne duhet të qëndrojmë gjithmonë në shtegun e drejtë."


Dhe qoftë nëse është në Greqi ose gjithkund tjetër në botë, bërija e atij shtegu së bashku na lejon të jemi një në shpirt. ■



"Vërtet më pëlqeu të shihja se si është të jesh përreth të rinjve që kanë të njëjtat bindje. Ndjeva se të gjithë ishim të lidhur në një mënyrë të veçantë, më shumë se thjesht duke ditur emrat e njëri-tjetrit."
- Pavlos K., moshë 15 vjeç



"Jam i lumtur që pata mundësinë të kaloj në të rinj të tjerë që kalojnë të njëjtat gjëra që unë kaloj çdo ditë."
- Xhoshua K., moshë 17 vjeç



"FSY-ja dhe kampi i Të Rejave përçojnë të njëjtën ndjenjë pavarësisht se ku shkon në botë. Lu bashkova kampit më të vogël të Të Rejave sepse ishte më e lehtë për t'u lidhur me njëra-tjetrën."
- Olivia H., moshë 15 vjeç



"Nuk jam anëtare e Kishës por vij çdo javë që mundem. E adhuroj atë që të rejat përfaqësojnë."
- Irena C., moshë 14 vjeç

Kisha në Greqi



Në fillim të viteve 1900, Rigas Pofantisi, një tipograf nga Athina, u dërgoi një kërkesë udhëheqësve të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme për informacion. Presidenti i misionit të Kishës në Turqi i dha mesim Pofantisit, i cili u pagëzua në tetor të 1905-ës.



Kisha përjetoi pak rritje në Greqi deri në vitet 1950, kur anëtarët greko-amerikanë të Kishës në Solt-Lejks-Siti të Jutës, SHBA, organizuan Hellenic Latter-Day Saint Society [Shoqatën Helenike të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme] për të ruajtur trashëgiminë e tyre dhe për të mbajtur lidhjet me vendet e tyre të lindjes.



Udhëheqësit e Kishës organizuan një bashkësi të vogël në Athinë në 1965-ën dhe e riorganizuar atë në 1967-ën. Ata themeluan Misionin e Greqisë, Athinë në korrik të 1990-ës dhe përfunduan ndërtime e shtëpisë së parë të mbledhjeve në Greqi në maj të 1999-ës.



Athinë, Greqi, shtëpi mbledhesh në Halandri



Anëtarësia e Kishës: 802
Bashkësi: 3

“Si mund të më ndihmojë bekimi im patriarkal që të marr vendime?”

“Një bekim patriarkal është një zbulësë për marrësin, madje një vijë e bardhë në mes të rrugës për të mbrojtur, frymëzuar dhe nxitur gjallëri dhe drejtësi. Një bekim patriarkal fjalë për fjalë përmban kapituj nga libri juaj i mundësive të përjetshme. . . .

“ . . . Është një Liahonë drite për t’ju udhëhequr të sigurt në shtëpinë tuaj qiellore.”

President Thomas S. Monson (1927–2018), “Your Patriarchal Blessing: A Liahona of Light”, *Ensign*, nëntor 1986, f. 65, 67.



Liahona Jonë Vetjake

Bekimet patriarkale janë një mënyrë që Ati Qiellor na ndihmon ta dimë identitetin tonë para lindjes, në vdekshmëri dhe të përjetshëm.

Duke i ditur këto tri të vërteta të veçanta rreth vetes, ai na ndihmon të ndjekim planin që Perëndia ka për ne. Ne e dimë se cilët jemi, përse jemi këtu dhe ku mund të jemi. Ndërsa Liahona punoi sipas besimit dhe zellit të Nefit dhe familjes së tij për ta ndjekur këshillën e saj (shih 1 Nefi 16:28), edhe ne mund të jemi besnikë dhe të zellshëm për ta ndjekur vetë Liahonën tonë dhe këshillën e saj, e cila do të na udhëheqë drejt potencialit tonë hyjnor.

Plaku Utai, moshë 20 vjeç, Misioni i Argentinës, Salta



Një Këndvështrim i Përjetshëm

Sa herë që ndihem e paqartë për të marrë vendime, i kthehem bekimit tim patriarkal dhe e përsiat zbulësën e tij hyjnore.

Dhe pastaj marrja e vendimit bëhet e lehtë. Ai nuk më ndihmon vetëm që të duroj në jetën time tokësore dhe të korr bekimet e premtuara, por ai gjithashtu më kujton ta përgatit veten për të hyrë e denjë në mbretërinë e Zotit një ditë. Ai vazhdimisht më ndihmon të rritem në besim, t’i mirëbesoj vullnetit të Zotit dhe të jetoj me një këndvështrim të përjetshëm.

Abigail F., moshë 18 vjeçe, Lugina Kagajan, Filipine



Këshillë Qiellorë

Bekimi im patriarkal më jep këshillë nga Ati im Qiellor. Nëse e ndjek atë këshillë, unë e di se do të marr zbuluesë mbi

vendimet që kam nevojë të marr. Ai u përgjigjet disa prej pyetjeve të mia madje përpara se unë t'i bëj ato.

Kemi H., moshë 16 vjeçe, Jutë, SHBA

Dëgjoheni Shpirtin

Nëse po kërkon ngushëllim dhe drejtim ose një përgjigje për një pyetje të ngutshme, ju mund të luteni me sinqeritet për të dhe të lexoni bekimin tuaj patriarkal me qëllim të vërtetë në zemër ndërsa jeni duke dëgjuar Shpirtin. Edhe hetimi i shkrimeve të shenjta ndihmon. Besoj se nëse ju e bëni këtë me besim të vërtetë, Zoti do t'ju përgjigjet, në kohën e Tij, në mënyrën më të mirë.

Kezia B., moshë 15 vjeçe, Havai, SHBA

Bekimet e Premtuara

Bekimet patriarkale na tregojnë se me çfarë dëshiron të na bekojë Perëndia. Ai na jep paralajmërim dhe shpjegon se si ne mund të bëhemi më shumë si Ai. Kur e dimë se çfarë ka në ruajtje Ati Qiellor për ne dhe se si ta marrim atë, ne do të zgjedhim dhe veprojmë në përputhje me të që ta marrim atë.

Hanter H., moshë 18 vjeçe, Jutë, SHBA

Përgjigjet synojnë të japin ndihmë dhe këndvështrim, nuk jepen si deklarime zyrtare të doktrinës së Kishës.



Si e re, a duhet të jem më e përqendruar tek arsimimi dhe karriera apo tek bërja një bashkëshorte dhe nënë?

Ne e dimë se “familja është thelbësore në planin e Krijuesit” dhe se “nënat janë kryesisht përgjegjëse për edukimin e fëmijëve të tyre”¹. Dhe ne gjithashtu e dimë se, për një mori arsyesh të mira, si burrat edhe gratë janë këshilluar nga profetët për t'u arsimuar.² Përveç këtyre, ne e dimë se shumë gra ose do të kenë nevojë ose do të duan të ndjekin një karrierë.

Presidenti Dallin H. Ouks, Këshilltar i Parë në Presidencën e Parë, ka thënë se për gratë, zgjedhja nuk është midis familjes ose arsimimit dhe karrierës. “Koha është ajo që ne duhet të zgjedhim”, tha ai. “Dhe ne kërkojmë frymëzimin e Zotit dhe mësimet nga shërbëtorët e Tij për ta bërë atë.”³

Planifikoni për t'u arsimuar dhe planifikoni për të pasur familje. Ju gjithashtu mund të planifikoni për të pasur një karrierë. Në të gjithë këtë, përqendrimi juaj duhet të jetë te ndjekja e planit të Atit Qiellor dhe kërkimi i vullnetit të Tij.

SHËNIME

1. “Familja: Një Proklamim drejtuar Botës”, familyproclamation.lds.org.
2. Shih *Për Forcën e Rinisë* (2011), f. 9.
3. Dallin H. Ouks, ngjarje Ballë për Ballë me Plakun Ouks dhe Plakun Ballard (ngjarje ndërkom-bëtare për të rinjtë në moshë madhore beqarë, 19 nëntor 2017), broadcasts.lds.org.

Te [lds.org/go/41961](https://www.lds.org/go/41961) një e re në moshë madhore tregon historinë e saj që nuk ishte e sigurt a duhej të përqendrohej te karriera e saj apo te familja e saj. Shihni se çfarë i tha asaj Presidenti Rasëll M. Nelson.

Çfarë Mendon Ti?

“Çfarë thua ti kur shokët ose shoqet nuk e besojnë se mund të ndodhin gjëra të tilla si Vegimi i Parë?”

Dërgojeni përgjigjen tuaj dhe, nëse dëshironi, një fotografi me rezolucion të lartë deri më 15 maj 2019 në [liahona.lds.org](https://www.lds.org) (klikoni te “Submit an Article or Feedback” [“Dorëzo një Artikull ose Përshtypje”]). Ose dërgojeni me mesazh elektronik përgjigjen dhe fotografinë tuaj në liahona@ldschurch.org. Përfshini emrin tuaj të plotë dhe emrat e lagjes dhe kunjit tuaj (ose degën dhe distriktin).

Përgjigjet mund të redaktohen për nga gjatësia ose qartësia.




Nga Dejvid Diksoni
Revistat e Kishës

Krishtlindja zakonisht merr vëmendjen më të madhe kur bëhet fjalë për festat. Prapëseprapë pa ngjarjet e shumë kohëve më parë që kremtojmë në çdo festë Pashke, Krishtlindja nuk do të ekzistonte.

Presidenti Gordon B. Hinckli (1910–2008) një herë dha mësim: “Nuk do të kishte Krishtlindje në qoftë se nuk do të kishte patur Pashkë. Foshnja Jezus nga Bethlehemi do të ishte veçse një foshnjë tjetër pa Krishtin shëlbues të Gjetsemanit e Kalvarit dhe faktin ngadhënjimtar të Ringjalljes.”¹

Këtu janë disa tradita që ju mund t’i merrni parasysh për t’ia shtuar kremtimeve tuaja të përvitshme.



1

Shkoni Këndoni Këngë Pashke

Duke lënë mënjanë variantet gazmore rreth renës dhe kuku-dhëve, këngët për Krishtlindje janë të gjitha për Jezu Krishtin. Pashka është koha e përsosur për muzikë rreth Shpëtimtarit, dhe po, madje edhe kur këndohet në dyert kryesore të fqinjëve tuaj.

Nëse nuk jeni të sigurt për ide, kontrollojeni për këngë pjesën “temat” e librit të himneve poshtë nënndarjeve “Pashka” dhe “Shlyerja”. Çdo këngë që kremton Jezu Krishtin është një përputhje me këngët për Pashkë.



2

Falni Dikë

Sa shpesh keni qenë mirënjohës për dhuratën e pendimit? Pashka ofron një mundësi për të menduar më shumë për mënyrën se si ne ua zgjatim po atë frymë faljeje tek të tjerët.

Jezusi dha mësim: “Prandaj, unë ju them se ju duhet ta falni njëri-tjetrin. . . .

Unë, Zoti, do të fal kë do të fal, por nga ju kërkohet t’i falni të gjithë njerëzit” (Doktrina e Besëlidhje 64:9–10).

Pyeteni veten: “Ndaj kujt po ushqeni ndjenja të këqija?” Lutuni për forcë për ta falur atë person dhe lejojeni Shpëtimtarin që të ndihmojë për t’i zhdukur ato ndjenja të dhimbshme.



3

Bëni një Shfaqje, një Skeç ose një Paraqitje Tjetër

Ju mund të organizoni një paraqitje për Pashkën. Një shembull i thjeshtë mund të jetë leximi nga shkrimet e shenjta për një mbrëmje familjare ose një koncert i këndshëm si komunitet.

Provoni Disa Tradita të Reja Pashke



4

Vizitoni Varret e të Dashurve

Për shkak të Jezu Krishtit, vdekja e ka humbur gjembin e saj (shih 1 Korintasve 15:55). Kaloni kohë duke vizituar varret e të dashurve për ta përsiatur këtë lajm të mirë.

Ju madje mund të lexoni me zë të lartë disa shkrime të shenjta të parapëlqyera që kanë të bëjnë me Ringjalljen ndërsa i vizitoni këto varre. Disa (nga shumë) shkrime të shenjta për t'u marrë parasysh për këtë janë: 1 Korintasve 15:20–22; Alma 11:42–44 dhe Doktrina e Besëlidhje 88:14–16.



5

Jini Pak më të Mirë

Pashka i nderon ngjarjet në Gjetseman, atë që ndodhi në kryq, Shpëtimtarin duke u ngritur nga vdekja të tretën ditë dhe më pas shërbesën e Tij për 40 ditë përpara se të ngjitej në qiell.

Përveç këtyre, jo shumë kohë pas ngjitjes në qiell, Jezu Krishti iu shfaq nefitëve dhe u shërbeu atyre (shih 3 Nefi 11–28). Ka shumë për të kremtuar!

Përse të mos e zgjeroni periudhën tuaj të Pashkës? Le të kënaqet shpirti juaj më gjatë për mrekullitë e Pashkës. Bëni një përpjekje të vetëdijshme për të qenë më shumë si Krishti gjatë 40 ditëve pas Pashkës. Për

frymëzim, merreni parasysh ftesën në vijim nga Presidenti Rasëll M. Nelson: “Shenjtëro[hëni] një pjesë të kohës suaj çdo javë për të studiuar *gjithçka* që tha dhe bëri Jezu siç u mbajt shënim në Dhiatën e Vjetër, sepse Ai është Jehova i Dhiatës së Vjetër. Studiojini ligjet e Tij siç u mbajtën shënim në Dhiatën e Re, sepse Ai është Krishti i saj. Studiojeni doktrinën e Tij siç u mbajt shënim në Librin e Mormonit, sepse nuk ka asnjë libër shkrimi të shenjtë në të cilin zbulohen më qartë misioni i Tij dhe shërbesa e Tij. Dhe studiojini fjalët e Tij siç u mbajtën shënim te Doktrina e Besëlidhje, sepse Ai vazhdon t'i japë mësim popullit të Tij në këtë periudhë ungujlore.”²

Traditat Tuaja po ju Presin

Plaku Diter F. Uhtdorf, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, dha mësim: “Për ta gjetur ditën më të rëndësishme në histori, ne duhet të kthehemi në atë mbrëmje gati 2000 vjet më parë në Kopshtin e Gjetsemanit kur Jezu Krishti ra në gjunjë në lutje të thellë dhe e ofroi veten e Tij si shpengim për mëkatet tona”³.

Për ngjarjet më të rëndësishme në histori ia vlen të gjesh kohë për t'i përsiatur çdo vit. Traditat na ndihmojnë ta bëjmë atë, qoftë këto nga kjo listë ose cilëndo nga ato që zgjidhni vetë.

Çfarë do të shtoni në listën tuaj këtë vit? ■

Këtë Pashkë, kaloni pak më shumë kohë duke kujtuar dhuratën më të madhe që ju është dhënë ndonjëherë.

SHËNIME

1. Gordon B. Hinckley, “The Wondrous and True Story of Christmas”, *Ensign*, dhjetor 2000, f. 5.
2. Rasëll M. Nelson, “Profetët, Udhëheqja dhe Ligji Hyjnor” (takim shpirtëror mbarëbotëror për të rinjtë në moshë madhore, 8 janar 2017), broadcasts.lds.org.
3. Diter F. Uhtdorf, “Shiheni Njeriun!” *Liahona*, maj 2018, f. 108.

Shprehja më e Madhe e Dashurisë së Perëndisë

Nga Presidenti M. Rasëll Ballard,
President Veprues i Kuorunit të Dymbëdhjetë Apostujve

Perëndia e shpreh dashurinë e Tij për ne duke ofruar udhërrëfimin për të cilin kemi nevojë që të përparojmë dhe të arrijmë potencialin tonë. Ai që di më shumë rreth nesh, potencialit tonë dhe mundësive tona të përjetshme, na ka dhënë këshillë hyjnore dhe urdhërime të manualet e Tij udhëzuese – shkrimet e shenjta. Kur ne i kuptojmë dhe i ndjekim këto udhëzime, jeta jonë ka qëllim dhe kuptim. Ne mësojmë se Krijuesi ynë na do dhe dëshiron lumturinë tonë. Si një shfaqje e pakrahasueshme e kësaj dashurie hyjnore për ne, Ai dërgoi Birin e Tij të Vetëmlindur, Jezu Krishtin.

“Sepse Perëndia e deshi aq botën, sa dha Birin e tij të vetëmlindurin, që, kushdo që beson në të, të mos humbasë, por të ketë jetë të përjetshme.

Sepse Perëndia nuk e dërgoi Birin e vet në botë që ta dënojë botën, por që bota të shpëtohet prej tij” (Gjoni 3:16–17).

Jezusi lindi në vdekshmëri. Ai jetoi një jetë të përkryer dhe, duke bërë këtë, shënoi shtegun që ne duhet të ndjekim. Ai u mësoi dishepujve të Tij: “Unë jam drita e botës; kush më ndjek nuk do të ecë në errësirë, por do të ketë dritën e jetës” (Gjoni 8:12).

Ne mund të fillojmë ta kuptojmë intensitetin e dashurisë së Krishtit për ne kur marrim parasysh se Ai ishte i gatshëm të shlyente dhe të vuante dhembjen për mëkatet tona, “vuajtje që [e] bëri [atë], madje Perëndi, më [të] madhi[n e] të gjithëve, të dridhe[t] për shkak të dhembjes e [t’i] dalë gjak nga çdo por dhe të vuaj[ë] si në trup e në shpirt” (Doktrina e Besëlidhje 19:18).

Këtë Pashkë, le t’i japim një falënderim të veçantë Perëndisë për Shlyerjen dhe Ringjalljen e Birit të Tij të dashur, Jezu Krishtit. Sepse në Të, nga Ai dhe nëpërmjet Tij, kjo gjendje e përkohshme në vdekshmëri mund të kthehet në ekzistencë të përhershme e të përsosur, për të cilën nuk ka fjalë për ta shprehur gëzimin tonë.

Të gjitha mrekullitë e natyrës janë paraqitje e pjesshme e fuqisë së Tij hyjnore dhe shprehje e dashurisë së Tij. Dhe akoma na pret mrekullia më e madhe nga të gjitha mrekullitë. Ajo do të ndodhë kur, nëpërmjet fuqisë së Tij, ne do të ngrihemi nga vdekja dhe varri për një botë të re që nuk do të vdesë, ku, nëse jemi të denjë, ne do të jemi me Të dhe me Atin tonë në Qiell përherë e përgjithmonë. ■

Nga një bisedë e konferencës së përgjithshme të prillit 1988.

Punoi në **firmën për tregtimin e makinave** të babait të tij në fillim të viteve 1950 dhe ishte **personi me më shumë shitje.**



U lind më 8 tetor 1928, në **Solt-Lejksiti, Jutë.**



Ai frekuentoi **Universitetin e Jutës.**

Presidenti

M. RASËLL BALLARD



Shërbeu në një mision kohëplotë në **Angli.**



Shërbeu si **president misioni** në Misionin e Kanadasë, Toronto nga viti 1974 deri në vitin 1977.



E takoi bashkëshorten e tij, Barbara Bouenin, në **“Hello Day Dance”** [“Dita e Vallëzimit për t’u Njohur”] në Universitetin e Jutës.




U martua me **Barbara Bouenin** në Tempullin e Solt-Lejkut më 28 gusht 1951.



Ka **7** fëmijë, **43** nipër e mbesa, **91** stërnipër dhe stërmbesa.

Mban një **biskotë Oreo** të futur në kuti në tavolinën e tij si një kujtues i një djali që kishte bërë një udhëtim të gjatë në një kamp refugjatësh, i cili mori një kuti me biskota dhe ia dha të parën Presidentit Ballard.



Gjyshi nga babai: Plaku Melvin J. Ballard, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve



Gjyshi nga nëna: Plaku Hajrëm Mek Smithi, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve



U mbështet në **Kuorumin e Dymbëdhjetë Apostujve** më 6 tetor 1985.




Veçohet si **President Veprues** i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve më 14 janar 2018.

Pas konferencës së përgjithshme të tetorit 1980, ai shkroi më shumë se **600 letra** nxitëse për anëtarët që po hasnin vështirësi me dëshmitë e tyre.

MË SHUMË FAQE PËR FËMIJËT

Përdoreni mirë fashikullin e ri *Miku*. Nëse nuk keni fëmijë në shtëpinë tuaj, ju mund:

- T'ia tregoni fashikullin *Miku* një familjeje e cila nuk e merr revistën *Liahona*.
- T'ia jepni atë një miku ose fqinji.
- T'ia kaloni atë një udhëheqëseje ose mësuesi/eje të Fillores.



TË RINJTË NË MOSHË
MADHORE
**A KENI NEVOJË PËR
NDIHMË PËR TË
MARRË VENDIME
TË RËNDËSISHME?**

42

RINIA
**GJETJA E PAQES PËR
VETEN DHE TË TJERËT**

52

PASHKA
TRADITA TË REJA

62

KISHA E
JEZU KRISHTIT
E SHENJTORËVE TË
DITËVE TË MËVONSHME



Prill 2019

Pjesa për fëmijë të revista *Liahona* botuar nga Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme

Miku



Historia e
PASHKËS

Shih faqet M4-M6



Nga Presidenti
Rasëll M. Nelson

DHURATA e Madhe e Perëndisë



Një ditë, unë dhe Motra Nelson pamë disa peshq tropikalë në një akvarium. Peshqit me ngjyra të ndezura dhe forma e përmasa të ndryshme turrshin si shigjetë prapa dhe para. E pyeta një punëtore aty pranë: “Kush i ushqen këta peshq të bukur?”

Ajo u përgjigj: “Unë”.

Më pas e pyeta: “A të kanë falënderuar ndonjëherë peshqit?”

Ajo u përgjigj: “Ende jo!”

Disa njerëz janë si ata peshq. Ata nuk kanë njohuri për Perëndinë dhe mirësinë e Tij ndaj tyre. Sa mirë do të ishte nëse ne do të mund të kishim më shumë njohuri për dashurinë e Perëndisë dhe do t'i shprehnim mirënjohje Atij.

Mirënjohës për Jezu Krishtin

Perëndia e dërgoi Birin e Tij, Jezu Krishtin, për të na ndihmuar. Ai e bëri atë sepse na do shumë.

Jezusi erdhi për të na **shëlbuar**.

Për shkak të **Shlyerjes** së Tij, ne mund të ringjallemi pasi të vdesim.

Për shkak të Shlyerjes së Tij, ne mund të kthehemi për të jetuar me Atin Qiellor përgjithmonë.

Jezusi shpjegoi:

“Unë jam ringjallja dhe jeta; ai që beson në mua, edhe sikur të duhej të vdesë do të jetojë. Dhe ai që jeton e beson në mua, nuk do të vdesë kurrë përjetë” (Gjoni 11:25–26).

Ky është mesazhi i mrekullueshëm i Pashkës. ●



shëlbeu:

pagoi për mëkatet tona në mënyrë që të mund të kthehemi te Perëndia

Shlyerja:

kur Jezusi vuajti për mëkatet tona në Kopshin e Gjetsemanit dhe vdiq në kryq në Kalvari

Nga “Falë i Qoftë Perëndisë”, Liahona,
maj 2012, f. 77–80.

Jezusi Është Shpëtimtari Im

Jezusi u ringjall mëngjesin e Pashkës. Lexoji fjalitë për të zbuluar se çfarë ka bërë Ai për ne. Ngjyros një rreze dielli pasi ta lexosh çdo fjali. Pastaj ngjyros pjesën tjetër të figurës.

Jezusi vuajti në Gjetseman dhe në kryq për të na shpëtuar nga mëkatet tona.

Jezusi vdiq dhe u ringjall për të na shpëtuar nga vdekja.


Jezusi na dha sakramentin për të na ndihmuar që ta kujtojmë Atë.

Jezusi na mësoi që t'i falim të tjerët.

Jezusi na tregoi se si të jemi të sjellshëm.

Për shkak të Jezusit, ne të gjithë do të ringjallemi pasi të vdesim.

Historia e Pashkës



Jezusi i donte miqtë e Tij. Ai iu lau këmbët. Pastaj iu dha sakramentin. Ai iu tha atyre ta kujtojnë Atë. Ai iu tha atyre ta duan njëri-tjetrin.




Më pas, Jezusi shkoi në një kopsht. Ai u lut për të gjithë ne. Ai e ndjeu dhembjen e sëmundjeve tona. Ai e ndjeu dhembjen e mëkateve tona.

Disa njerëz të zemëruar e morën Jezusin. Ata e lënduan Atë. Ai vdiq në kryq për ne. Miqtë e Tij e vendosën trupin e Tij në një varr.



Tri ditë më vonë, miqtë e Tij u kthyen përsëri. Varrin qe bosh!
Engjëjt u thanë atyre: “Ai është ngritur”. Jezusi ishte përsëri i gjallë! Për shkak të Jezusit, ne të gjithë do të jetojmë përsëri pasi të vdesim.



Jezusi më do. Unë mund ta bëj Pashkën të veçantë duke e kujtuar Atë. ●

Lexo për mëngjesin e Pashkës te Mateu 28.

Kur t'Kthehem tek Ai

Me gëzim ♩ = 90-96

Fjalët dhe muzika nga Sally DeFord

F C Dm B^b C F

1. Ba - riu i do qe - ngjat e Tij, Kur rru - gën hu - mbin, shpejt Del
 2. Shpë - tu' - si vog' - lu - shët i do Dhe po t'i - ki prej Tij, Del
 3. Shpë - tu' - si shte - gun më shë - non; Si t'je - toj m'thot' A - i. Po

C⁷ Am Dm Gm C⁷

i kër - kon kur en - den; Se - ci - lin n'e - mër th'rret. Zën'
 më kër - kon kur en - dem, Në t'err - tën nat' a dit'. Kur
 t'hu - mbas a - po t'en - dem, Do të më fal', e di. Zën'

F Dm Gm C⁷ A A⁷ Dm

e Ba - riut a - ta dë - gjojn'; Vra - pojn' për tek A - i, Kra -
 th'rret Shpë - tu' - si e dë - gjoj; Do të shkoj tek A - i, Krah'
 e Shpë - tu' - sit do dë - gjoj; Larg m'ka - tit un' do rri, Ze -

B^b C⁷ F Dm B^b C⁷ F

hë ha - pur i për - qa - fon Kur kthe - hen tek A - i.
 ha - pur do më për - qa - foj' Kur t'kthe - hem tek A - i.
 mrën do ma mbush' me gë - zim Kur t'kthe - hem tek A - i.

© 2019 nga Sally DeFord. All rights reserved.

Kjo këngë mund të kopjohet për t'u përdorur me raste në Kishë dhe në shtëpi, jo për tregti.

Ky shënim duhet të përfshihet në çdo kopje që bëhet.

Nga Xhejn Mek-Brajdi

Bazuar në një ngjarje të vërtetë

“Bëni atë që është e [ndershme]” (2 Korintasve 13:7).

“Kam nevojë që ti të kujdesesh për vëllanë”, tha Mami. “Unë dhe babi do të shkojmë të ndihmojmë dikë që është i sëmurë.”

Ngrita sytë lart ndërsa po laja dyshemenë e shtëpisë sonë të vogël dhe tunda kokën. Mami ishte presidente e Shoqatës së Ndihmës dhe ajo shpesh shkonte për të vizituar motrat në lagjen tonë.

“Faleminderit, Arlin”, tha Mami, duke më puthur në majë të kokës. “Xhoni është në gjumë. Dhe ka brumë buke që po vjen në banak. Të lutem mos e prek.”

Pashë përmes hapësirës së derës ndërsa ajo dhe Babi i hipën automjetit në rrugën e pluhurosur. U ndjeva kre-nare që Mami më mirëbesoi.

Ndërsa lava kuzhinën, u ndala për t'i hedhur një sy brumit të bukës. Mezi po prisja që Mami ta piqte son-te. Zakonisht e hanim bukën e freskët me reçel të bërë vetë. Por nuk kishim reçel prej tre muajsh.

Reçel! Mendimi më shtiu nepsin për diçka të ëmbël. Pashë kavanozin e sheqerit lart në raft. E dija se Mami po e ruante që të bënte më shumë reçel.

Por sa më shumë që mendoja për sheqerin, më shumë më shtojë nepsi. Më në fund, tërhoqa një karrige deri te banaku dhe e arrita. Gishtat e mia mezi e prekën kavanozin e sheqerit. E tërhoqa më afër cepit të raftit. . . .

Dhe më pas kavanozi rrëshqiti nga rafti. U përpoqa ta kapja por ai ra me një zhurmë të madhe pikërisht në mes të brumit të bukës. Sheqeri u përhap në të gjithë brumin, në banak dhe në dysheme.

“O, jo!” bërtita. Kjo e zgjoi nga gjumi vëllaçkon. Ai filloi të qante. Edhe unë doja të qaja. Çfarë do të thoshte Mami për këtë rrëmuje?



Ndershmëria e Ëmbël



Pasi e qetësova Xhonin, bëra më të mirën për ta pas-truar sheqerin. E nxora kavanozin nga brumi dhe e lava. E fshiva sheqerin nga banaku dhe dyshemeja. Por nuk kishte asgjë që mund të bëja për ta hequr sheqerin nga brumi.

Mendova që ta vendos kavanozin sërish në raft. Ndosh-ta Mami nuk do ta vinte re që ishte bosh. Por e dija se nuk ishte e drejtë. Ndaj e vendosa kavanozin mbi tavolinë dhe prita Mamin dhe Babin që të vinin në shtëpi.

Kur arritën në shtëpi, Mami e vuri re menjëherë kava-nozin e sheqerit.

Mora frymë thellë. “Thjesht doja ta provoja pak sheqe-rin. Por e hodha kavanozin nga rafti. U përpoqa ta pas-troja por nuk mund ta nxirrja nga brumi i bukës.” Fjalët dolën rrufeshëm ndërsa pashë në dysheme.

Mami ishte e qetë për një çast.

“Më fal”, pëshpërita.

Mami nxori një psherëtimë. “Epo, ma merr mendja se buka do të jetë shumë po shumë e ëmbël sonte”, tha ajo. Ngrita sytë. Ajo buzëqeshi pak. “Faleminderit që na tregove se çfarë ndodhi.”

Ndërsa e hëngrëm bukën e sheqerosur atë natë, unë, Mami dhe Babi folëm për ndershmërinë.

“Ne të gjithë bëjmë shumë gabime në jetë”, tha Babi. “Por kur jemi të ndershëm dhe përpiqemi të pendohemi, Ati Qiellor dhe Jezusi janë të lumtur. Ne gjithmonë do të bekohemi për faktin që jemi të ndershëm – edhe nëse në fillim duket më e vështirë.”

Isha ende e trishtuar që e kisha derdhur sheqerin. E dija që ndoshta nuk do të kishim dhe aq shumë reçel këtë vit për shkak të gabimit tim. Por isha e lumtur që kisha thënë të vërtetën. Ajo ishte një ndjenjë e ëmbël që nuk mund të ta japë asnjë dozë sheqeri. ●

Autorja jeton në Kolorado, SHBA.



“Mbajtja e urdhërimeve hyjnore sjell bekime, çdo herë! Shkelja e urdhërimeve hyjnore sjell humbje të bekimeve, çdo herë!”

Presidenti Rasëll M. Nelson, “Lëreni Besimin Tuaj të Dalë në Pah”, *Liahona*, maj 2014, f. 30.

Plaku Bednar Viziton Indinë

Plaku Dejvid A. Bednar udhëtoi me bashkëshorten e tij, Suzana Bednarin, për t'i dhënë dëshminë e tij për Jezun Krishtin anëtarëve të Kishës në Indi. India është një nga vendet më të mëdha në botë. Dhe shpejt ai do të ketë tempullin e tij të parë!



Plaku dhe Motra Bednar shkuan në qytetin e Rajahmundrisë. Një Apostull nuk kishte qenë kurrë më parë atje.



Fëmijët arritën t'i shtrëngonin dorën Plakut Bednar.



Në një mbledhje në qytetin e Hideradabit, kjo vajzë arriti t'i bënte një pyetje Plakut Bednar.



“Sa më shumë që udhëtoj nëpër botë, sa më shumë kombe vizitoj, sa më shumë bekohej që të marr mësim nga shumë njerëz, aq më shumë zbuloj se në të gjithë botën njerëzit janë në thelb të njëjtë.”





Çdokush ishte i lumtur që dëgjonte dëshminë e një Apostulli të Perëndisë!



LIDH ELEFANTËT

India ka rreth 30000 elefantë. Sa dyshe që ngajnë me njëra-tjetrën mund të gesh më poshtë?
Cilët janë disa nga kafshët e tua të parapëlqyera që krijoi Ati Qiellor dhe Jezu Krishti?





PROFETIËT dhe APOSTUJT Tanë

Jezu Krishit e drejton Kishën e Jezu Krishitit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme nëpërmjet profetëve dhe apostujve. Lexo për ta më poshtë. Pastaj **prrij fotografi në faqen M23** dhe ngjiti ato te vendi i duhur në skicë. Vendos ngjites në majë të çdo fotografie në mënyrë që të mund t'i ngresh për të lexuar faktet poshtë!

- Pastroi një dyaqan për riparimin e radiove si punën e tij të parë
- U bë avokat dhe gjykatës në Gjykatën e Lartë të Jutës
- Ishte president i Universitetit "Brigam Jang"



- Ishte një kirurg zemre
- Studioi disa gjuhë, përfshirë gjuhën mandarine
- Ka 10 fëmijë: 9 vajza dhe 1 djalë



- Luajti basketboll në shkollë të mesme
- E mësoi fizikën nga babai i tij në dërrasën e zezë të familjes së tyre
- Ishte president i Kolegjit Riiks, që tani është UBJ – Ajdaho



Presidenti Dallin H. Ouks,

Këshilltar i Parë në Presidencën e Parë

- Iu vu nofka "peshkopi" në koleji për shkak të standardeve të tij të larta
- Kishite në pronësi një firmë për tregitim makinash
- Shërbeu si misionar në Angli dhe si president misioni në Toronto, Kanada



- Ishte shok misioni me Plakun Kuk në Angli
- Punoi për Sistemin Arsimor të Kishës
- Ishte president i UBJ-së



Presidenti Rasëll M. Nelson,

Presidenti i 17-të i Kishës së Jezu Krishit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme

- Ishte refugjat dy herë kur ishte fëmijë
- Ishte kapiten aeroplanësh
- I pëlqen të bëj ski me fëmijët dhe nipërit e mbesat e tij



Presidenti Henri B. Ajring,

Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë

- Ishte mesfushor në ekipin e futbollit të shkollës së tij të mesme
- Pasi shërbeu në një mision në Gjermani, pagëzoi të atin si anëtar të Kishës
- Ishte president i Kolegjit Riiks kur u bë UBJ – Ajdaho



Presidenti M. Rasëll Ballard,

President Veprues i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Plaku Xhefri R. Holland,

i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Plaku Diter F. Uhtdorf,

i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Plaku Dejvid A. Bednar,

i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

- Mori një dëshmi pasi studioi shkrimet e shenjta dhe u lut me vëllanë e tij më të madh
- E pa bashkëshorten e tij të ardhshme në një shfaqje talentesh në shkollën e mesme
- Shërbeu si udhëheqës i Kishës në Filipine dhe Ishujt e Paqësorit



Plaku Kuentin L. Kuk,

i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

- Poqi bukë të bërë në shtëpi për familjen e tij ndërsa rritej
- Mori pjesë në Hill Cumorah Pageant (Shfaqjen "Kodra Kumorah") në Nju-Jork kur ishte adoleshent
- Punoi si avokat përpara se të thirrej si një Apostull



Plaku D. Tod Kristoferson,

i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

- Shërbeu si misionar dhe më vonë si president misioni në Japoni
- Nisi një biznes për krijimin dhe shitjen e pajisjeve sportive
- Shërbeu si peshkop në të gjithë Kishën



Plaku Geri E. Stivenson,

i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

- U rrit në një fermë bulmeti në Ajdaho, SHBA
- Shërbeu si misionar dhe president misioni në Francë
- Flet frëngjisht, portugalisht, spanjisht dhe anglisht



Plaku Nil L. Andersen,

i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

- I pëlqen kafshët, përfshirë pinguinët
- I pëlqen shumë të takoj njerëz në çdo vend
- Ka dokumente të historisë familjare që datojnë që nga Dragoi i Parë Gong në vitin 837 ps.K.



Plaku Gerit W. Gong,

i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

- Ishte president misioni në Nju-Jork-Siti, SHBA
- Motoja e tij është: "Janë një-rëzit ata që kanë më shumë rëndësi"
- Përkushtoi ndërtesën e parë të shenjtorëve të diëve të mëvonshme në Republikën Çeke



Plaku Ronald A. Rasband,

i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

- Është nga Brazili dhe shërbeu si misionar atje dhe si president misioni në Portugali
- Mësoi për Kishën me familjen e tij kur ishte një djalë i vogël
- Filloi të përgatitej për mision kur ishte 12 vjeç



Plaku Ulises Soares,

i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Kontrolloji përgjigjet e tua në [lds.org/prophets-and-apostles](https://www.lds.org/prophets-and-apostles).



PALLTOJA E HUMBUR

Nga Shilla Kindredi

Bazuar në një ngjarje të vërtetë

“Unë, Zoti, do të fal kë do të fal, por nga ju kërkohet t'i falni të gjithë njerëzit” (Doktrina e Besëlidhje 64:10).

“Ma, palltoja ime nuk është më këtu!” tha Bredi. Ishte koha për të shkuar në shtëpi pas kishe, por Bredi nuk mund ta gjente pallton e tij te varësja e rrobave.

“A je i sigurt se e vare këtu?” pyeti Mamaja.

“Po. Ishte pikërisht këtu.” Palltoja e Bredit ishte blu dhe e kuqe e ndezur. Ishte e vështirë të mos e shihje.

“Ndoshta e kanë lëvizur. Le të shohim përreth ndërtesës”, tha Babai.

Mami, Babi dhe Bredi u ndanë për të kontrolluar në dhoma të ndryshme. Ata panë te kutia e gjërave të humbura dhe të gjetura, te godina kishtare, te klasa e Shkollës të së Dielës së Bredit, te klasa e Fillores dhe në çdo varëse palltosh. Madje panë edhe në tualete, por nuk e gjetën atë.

“Dikush ndoshta e mori atë padashje. Jam i sigurt se do të ta kthejnë javën tjetër sapo ta kuptojnë se nuk është e tyrja”, tha Babai.

“Ndërkohë mund të veshësh pallton tënde të vjetër”, tha Mamaja.

Bredi rrudhi vetullat. Atij nuk i pëlqente palltoja e vjetër. Ishte e hollë, i kishte dalë boja dhe ishte shumë e vogël për të. Atij i pëlqente shumë se si palltoja e re e kuqe dhe blu e bënte të dukej si një superhero.



“Dikush ndoshta e pa se sa e bukur ishte palltoja ime dhe e vodhi”, mendoi Bredi. Si mund të ndodhë kjo në kishë? Çdonjëri atje supozohet të jetë i ndershëm. Bredi nuk do ta lejonte atë hajdut të largohej me pallton. Ai kishte një plan. Të dielën tjetër, ai do të kontrollonte me kujdes për të parë se kush po e mbante veshur pallton e tij. Pastaj ai do ta rrokte sërish dhe do të bërtiste: “Ndalo, hajdut!” Atyre do t’u vinte keq që e morën me të parën.

Bredi mezi po e priste të dielën për ta përmbushur planin e tij. Por e diela e ardhshme ishte shumë e nxehtë për të veshur pallto dhe ashtu ishte edhe e diela tjetër.

Pas dy të dielash, Bredi i vështroi i dyshimtë në Fillore të gjithë djemtë, duke vrarë mendjen se kush ia vodhi pallton. Mos ishte ai djali i gjatë? Ose ndoshta ishte vajzë. Ndiante se nuk mund t’i besonte askujt. Bredit nuk i pëlqente ajo lloj ndjenje.

Pas kishë Bredi shpejtoi rreth ndërtesës duke parë familjet që vishnin palltot e tyre. Por nuk e pa pallton e tij asgjekundi. Ai madje e kontrollloi sërish kutinë me

gjëra të humbura dhe të gjetura . . . por nuk kishte asnjë pallto. Ku mund të ishte vallë?

Rrugës për në shtëpi, Bredi mendoi një plan të ri. Ai do të lutej. Ai e dinte se Ati Qiellor mund t’i gjente gjërat e humbura. Atë natë Bredi u lut dhe tha: “Atë Qiellor, të lutem më thuaj se kush ma mori pallton. E dua mbrapsht.”

Bredi priti që t’i vinte ndërmend emri ose fytyra e hajdutit. Por përkundrazi ai filloi të mendonte për shokun e tij, Karlin. Bredi zakonisht ulej afër Karlit në Fillore. Ata bënin shaka dhe qeshnin shumë së bashku. Por Karli nuk kishte qenë në kishë prej pak javësh. Bredin e kishte marrë malli për të.

Po sikur *Karli* t’ia kishte marrë pallton? Ndoshta Karli tani kishte frikë që të vinte në kishë sepse mendonte se Bredi nuk do të ishte më shoku i tij. Bredi donte që Karli të vinte përsëri në Kishë. Nëse Karli do ta kishte marrë pallton e tij, Bredi vendosi se nuk do t’i bërtiste atij. Ai do ta falte atë.

Bredi hipi në krevat duke u ndier më mirë.

Të dielën tjetër në Fillore, Karli nuk ishte atje por ishte një djalë i ri. Ai kishte veshur një kollare me viza të kuqe dhe blu.

“E bukur kollarja”, tha Bredi, duke u ulur afër djalit të ri. “Të bën të dukesh si një superhero.”

Djali buzëqeshi.

Edhe Bredi buzëqeshi. Ai nuk po kërkonte më për hajdutë. Ai po kërkonte miq. ●

Autorja jeton në Ajoua, SHBA.

Përshëndetje nga Estonia!



Ne jemi Margo dhe Paolo. Këtë vit po udhëtojmë nëpër botë për të mësuar rreth fëmijëve të Perëndisë. Bashkohu me ne teksa vizitojmë Estoninë!



Ky është Talini, kryeqyteti i Estonisë. Ka rreth 800 vjet si qytet! Estonia ka shumë vende të egra, si pyje dhe moçale. Në fakt, më shumë se gjysma e Estonisë mbulohet nga pyjet. Shumë njerëzve në Estoni iu pëlqen ta kalojnë kohën në natyrë.

Ja se si të thuash "përshëndetje" në estonisht:

Tere!

Dhe ja se si ta thuash emrin e Kishës:

Viimse Aja Pühade Jeesuse Kristuse Kirik

Estonia është në Europën veriore. Ajo ka më shumë se 2 000 ishuj. Në Estoni jetojnë rreth 1,3 milion njerëz.





Çfarë ka për darkë në Estoni? Ndoshta mish derri ose peshk të kripur me patate, lakër, salcë kosi dhe bukë të zezë. Ky quhet sanduic me korrobace.



Kisha në Estoni është e vogël por e fortë. Ka rreth një mijë anëtarë të Kishës. Tempulli i tyre më i afërt është në Helsinki, Finlandë.



A të pëlqen të këndosh në Fillore? Çdo pesë vjet, estonezët mblidhen në një koncert të madh për të festuar në vendin e tyre duke kënduar dhe duke kërcyer.

**A je nga Estonia? Na shkruaj!
Do të na pëlqente shumë të
dëgjonim prej teje!**

Faleminderit që
eksplorove Estoninë
me ne. Shihemi
herën tjetër!



Takoni dy motrat nga Estonia!



Një natë kur doja të shkoja në shirat, nuk e kisha ariun tim prej pelushi. Kërkova për të por nuk munda ta gjeja. U luta. Më pas e gjeta ariun tim prej pelushi dhe pashë ëndrra të bukura.


Bianka J., moshë 7 vjeçe



Familjes sonë i pëlqen t'u shërbejë të tjerëve. Shërbimi na ndihmon ta ndiejmë Frymën e Shenjtë, e cila na jep një ndjenjë të ngrohtë paqeje. Unë dhe motrat e mia bëjmë dhurata për të tjerët sepse duam që ata të ndiejnë se të tjerët i duan.

Pibe J., moshë 10 vjeçe

Të Ndihesh I RI



Nga Xhesika Larsen

Bazuar në një ngjarje të vërtetë

Estonia

“Kam një surprizë!” tha *Em*a (Mamaja) kur mori Rasmusin nga shkolla. Ata ecën së bashku në rrugët e ngushta të mbushura me ndërtesa shumëngjyrëshe.

“Rosolje për darkë?” hamendësoi tërë shpresë Rasmusi. Ata kishin ngrënë rosolje pikërisht javën e kaluar për shtatëvjetorin e tij. Por ai mund të hante gjithmonë më shumë sallatë me panxhar dhe patate me harenjë të kriposur!

*Em*a tundi kokën me buzëqeshje në buzë. “Takova dy vajza të reja në autobusë këtë mëngjes. Misionare. Ato do të na vizitojnë sonte për të folur për kishën e tyre.”

Rasmusi ngriti sytë me kureshtje. Ai nuk kishte takuar kurrë më parë misionare.

Ai ishte në dhomën e tij të gjumit duke luajtur me makinën e zjarrfikësit kur erdhën misionaret. “Tere! Tere! Ç’kemi!” e përshëndetën ato *Em*ën ndërsa u futën në

apartament. Ato i hoqën çizmet e tyre të rënda dhe veshëm pantoflat që *Em*a i mbante për vizitorët. *Em*a i drejtoi ato te divani portokalli. Por Rasmusi qëndroi te dera.

Vajza më e gjatë e vuri re atë dhe buzëqeshi. Etiketa e zezë e emrit thoshte Õde Craig (Motra Kreig). “Mamaja jote na tha se sapo kishe ditëlindjen”, tha ajo. “Të sollëm diçka.” Ajo mbante një kartë të vogël. Rasmusi e pa nga afër.

Ishte figura e një burri. Ai mbante të veshur një rrobë të bardhë dhe dora e tij ishte e shtrirë.

“A e di se kush është ky?” pyeti Õde Craig.

Rasmusi nuk e dinte emrin e burrit. Ai nuk e kish-te parë këtë fotografi kurrë më parë. Por burri dukej i mirë dhe i fuqishëm. “Mendoj se është një mbret!” tha Rasmusi.

Të dyja misionaret buzëqeshën. “Po, Ai është mbret!” Ai është Mbreti i mbretërve! Emri i Tij është Jezu Krisht.”

Ëde Craig nxori një libër me kapak blu. “Dhe ky është një libër që na mëson rreth Tij, *Mormoni Raamat*. Libri i Mormonit.”

Ai dhe *Ema* filluan ta lexojnë Librin e Mormonit çdo ditë përpara se ai të shkonte në shkollë. Gjatë shkollës, Rasmusi dhe klasa e tij bënin ecje në natyrë dhe më pas dremitinin. Pas shkolle, ai dhe *Ema* takoheshin shpesh me misionaret. Ata flisnin me misionaret rreth asaj që ata kishin lexuar në Librin e Mormonit. Ndonjëherë *Ema* iu jepte të gjithëve *kringel*, bukë e bërë me kanellë. Fundjavave ai dhe *Ema* ngitnin biçikletat ose bënin piknik në plazh. Ndonjëherë bënin ecje të gjata në pyll ose përgjatë lumit të tyre të parapëlqyer.

Në një nga ato ecje në pyll *Ema* i tha atij se ajo dëshironte të pagëzohej. Rasmusi buzëqeshi fort. Misionaret i kishin kërkuar *Emës* të lutej nëse do të pagëzohej apo jo. U duk sikur ajo e kishte marrë përgjigjen e saj.

“Dhe tani e di se ku do të pagëzohem”, i tha ajo atij duke buzëqeshur. “A e merr dot me mend?”

Rasmusi mendoi rreth mësimin të misionareve mbi pagëzimin. Ato kishin mbajtur një figurë që tregonte Jezusin me Gjon Pagëzorin në një lum. . . .



“Lumi!”, bërtiti ai. “Lumi ynë i parapëlqyer.”

Një javë më vonë, Rasmusi qëndroi në shtratin e lumit me misionaret dhe disa njerëz të tjerë nga kisha. *Ema* ishte gati që të pagëzohej. Ajo u zhyt e tëra në ujë pikërisht siç bëri Jezusi. Kur doli nga uji, ajo po buzëqeshte. Rasmusi donte ta kujtonte këtë çast përjetë – ujin blu, lulet e bardha dhe të egra në barin e gjelbër dhe buzëqeshjen e mamasë së tij.

“Si është të pagëzohesh?” pyeti ai më vonë, kur të gjithë po hanin ëmbëlsirat që kishin sjellë misionaret.

“E mrekullueshme”, i tha ajo atij. “Doja të qëndroja përgjithmonë brenda lumit. Ndihej kaq e re!” Ajo e përqafoi atë fort.

“Në ditëlindjen time të ardhshme, unë dua të pagëzohem ashtu si ti dhe Jezusi”, i tha ai asaj. “Edhe unë dua të ndihem i ri!” ●

Autorja jeton në Teksas, SHBA.





Nga Reina I. Aburto,

Këshilltare e Dytë në
Presidencën e Përgjithshme
të Shoqatës së Ndihmës

Unë do ta Shoh Atë Përsëri



Unë u rrita në Nikaragua. Kur isha e vogël, çdo gjë e bëja me vëllanë më të madh. Shkonim në shkollë bashkë. Shkonim në dyqan bashkë. Kalluam gjithfarë aventurash në oborrin tonë. Ishim të lumtur.

Më pas, kur isha nëntë vjeçe, ndodhi diçka shumë e trishtuar. Vëllai im vdiq nga një tërmet. Në fillim fakti që ai nuk ishte më nuk dukej i vërtetë. Përfytyroja sikur ai do t'i binte derës kryesore. Do të na thoshte se thjesht kishte qenë diku larg. Vështroja ngultas derën, duke dëshiruar që ajo të ndodhte. Doja kaq shumë që ta shihja atë sërish.

Me kalimin e kohës, kjo gjë u bë më e lehtë. Ende më merrte malli për tim vëlla, por munda të ndihesha sërish e lumtur.

Në atë kohë nuk isha anëtare e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Por kur u rrita, mësova rreth Kishës dhe u pagëzova. Një ditë po laja enët. Ishte kohë Pashke. Po mendoja për Ringjalljen dhe mendova për tim vëlla.

Papritmas më përshkoi një ndjenjë. M'u kujtua ëndrra me sy hapur që kisha për vëllanë. E kuptova se nuk ishte aspak budallallëk! Ajo erdhi nga Fryma e Shenjtë për të më ngushëlluar dhe për të më udhëhequr. Një ditë vëllai im me të vërtetë do të ringjallet. Dhe njëmend do ta shohë atë sërish.

Nëse dikush të cilin e do ka vdekur, është normale të të marrë malli dhe të ndiesh i trishtuar. Fol me familjen tënde ose me një të rritur kur të ndihesh gati. Lutju Atit Qiellor për mënyrën se si ndihesh. Ai mund të të ndihmojë të ndiesh sërish paqe.

Pavarësisht nga gjithçka, kujto se Jezu Krishti të do. Gjatë Pashkës ne kujtojmë sakrificën e Tij për ne. Për shkak të Tij, ne të gjithë do të ringjallemi dhe ne mund të jetojmë me familjet tona përgjithmonë. ●

Karta Ngushëlluese

Priti këto karta. Mund t'i palosësh më dysh ose t'i përdorësh si libërshenjuesa. Mbajti te shkrimet e tua të shenjta ose në një vend tjetër për t'i parë kur ndihesh i trishtuar, i vetmuar ose i frikësuar.



“Nuk do t’ju lë bonjakë, do të kthehem te ju.”

Gjoni 14:18



“Dhe Perëndia do të thajë çdo lot nga sytë e tyre.”

Zbulesa 21:4



“Prandaj, merrni zemër dhe mos u frikësoni, sepse unë, Zoti, jam me ju dhe do t’ju qëndroj përkrah.”

Doktrina e Besëlidhje 68:6



Trego dhe Thuaj

Më pëlqen shumë që ta shoh tempullin.

Rebeka C., moshë 9 vjeçe, Aragua, Venezuelë



Një ditë kur hipëm në makinë, ajo nuk po ndizej. E kontrolluam motorin, por nuk ndodhi asgjë. Ndjeva se duhej të lutesha, ndaj e bëra. Pak minuta më vonë, makina u ndez. Jam shumë e lumtur që Ati Qiellor mundet gjithnjë të më ndihmojë.

Broklin B. moshë 9 vjeçe, Ketsaltenango, Guatemalë



Dy vite më parë klasës sonë në shkollë iu bashkua një djalë i ri. Ai nuk ishte i sjellshëm me të tjerët. Të gjithë filluan të mos e pëlqenin dhe të ishin të pasjellshëm me të. Kjo dukej se e trisatoi atë ndaj nuk bëra atë që bënë të tjerët. Disa nga miqtë e mi e vunë re këtë dhe ndoqën shembullin tim. Unë besoj se nëse bëj atë që Perëndia do që unë të bëj, do të jem më e lumtur dhe më e sigurt. Unë besoj se, nëse kam kurajë dhe shprehem sinqerisht, do të gjej miq që do më pëlqejnë kështu siç jam.





Vestina K., moshë 11 vjeçe, Vilnius, Lituani



Më pëlqen të luaj futboll me fëmijë më të vegjël dhe t'u mësoj atyre taktika të reja. Është një mënyrë se si më pëlqen të shërbej.

Sasha K., moshë 11 vjeç, Moskë, Rusi

Përdori këto
fotografi për të
mbushur skicën
te faqet M12–M13.



Të dashur Prindër,

Këtë muaj fashikulli *Miku* ka histori dhe veprimtari për ta ndihmuar familjen tuaj të kremtojë Pashkën [e Krishterë]. Ne shpresojmë që familja juaj do të kënaqet duke menduar për Pashkën [e Krishterë] gjatë gjithë muajit!

- “Dhurata e Madhe e Perëndisë” (M2) – Një mesazh Pashke nga Presidenti Rasëll M. Nelson
- “Jezusi Është Shpëtimtari Im” (M3) – Një veprimtari për ngjyrosje rreth Shlyerjes dhe Ringjalljes së Jezusit
- “Historia e Pashkës” (M4–M6) – Një histori e ilustruar nga shkrimet e shenjta
- “Kur t’Kthehem tek Ai” (M7) – Një këngë e re dhe e bukur rreth pendimit
- “Të Ndiheh i Ri” (M18) – Një histori rreth një djali nga Estonia i cili mëson për Jezusin
- “Unë do ta Shoh Atë Përsëri” (M20) – Dëshmia e Motrës Reina I. Aburto për Ringjalljen

Ju lutemi, na shkruani për të na informuar se si familja juaj i përdori këto histori dhe veprimtari.

Paçi një Pashkë të bekuar!

Miku

New Friend

50 E. North Temple Street,
Room 2393
Salt Lake City, UT 84105 USA
liahona@ldschurch.org



**Gjejeni Liahonën e fshehur
brenda revistës!**

PËRMBAJTJA

- M2** Nga Presidenca e Parë: Dhurata e Madhe e Perëndisë
- M4** Historitë nga Shkrimet e Shenjta: Historia e Pashkës [së Krishterë]
- M7** Muzikë: Kur t’Kthehem tek Ai
- M8** Ndershmëria e Ëmbël
- M10** Apostujt nëpër Botë: Plaku Bednar Viziton Indinë
- M12** Profetët dhe Apostujt Tanë
- M14** Palltoja e Humbur
- M16** Përshëndetje nga Estonia!
- M18** Të Ndiheh i Ri
- M20** Unë do ta Shoh Atë Përsëri
- M22** Trego dhe Thuaj
- M23** Fotografi të Apostujve dhe Profetëve